



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Nr. 50/40 Prot.

Tiranë më, 17/10/2024

V E N D I M

Nr. 47, datë 17.10.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Bora Vrenjo **Kryesuese**
Henri Naqellari **Relator**
Loreta Hanxhari **Anëtare**

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, Znj. Lediana Azemaj, në orën 10:00, datë 17.10.2024, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Z. Xhavit Fetah Shala, me funksion Drejtor, në Qendrën e Kërkimeve Shkencore dhe Projekteve, në Akademinë e Sigurisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, (këtu e në vijim Ligji nr. 12/2018, i ndryshuar).

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi relatimin e relatorit të çështjes Henri Naqellari, dëgjoi subjektin e vlerësimit Z. Xhavit Fetah Shala, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 03.10.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi, duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të nenit 2, nenit 4 dhe nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, Z. Xhavit Shala është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 04.07.2023, si Drejtor, në Qendrën e Kërkimeve Shkencore dhe Projekteve, në Akademinë e Sigurisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
3. Subjekti i vlerësimit, Z. Xhavit Shala, i’u nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr. 01, datë 02.08.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit, të përbërë nga: Z. Henri Naqellari Relator, Znj. Bora Vrenjo Kryesuese dhe Znj. Loreta Hanxhari Anëtare.
5. Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”, me vendimin nr. 01, datë 02.08.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Xhavit Shala.
6. Relatori i çështjes, Z. Henri Naqellari, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar, datë 03.08.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, i ka bërë të njohur përbërjen e Trupës së Vlerësimit, si dhe i ka kërkuar të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e Trupës së Vlerësimit.

7. Subjekti i vlerësimit, ka dorëzuar deklaratën e konfliktit të interesit më datë 06.09.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
8. Relatori i çështjes, në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
10. Bazuar në nenin 34, nenin 42 dhe nenin 46, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar, janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, (këtu në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Këto raporte janë administruar nga relatori, me fillimin e hetimit administrativ.
11. Në përputhje me nenin 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ILDKPKI, me shkresë nr. ***, prot., datë 14.02.2024, (protokolluar me tonën nr. ***, prot., datë 21.02.2024), dërgoi raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të vlerësimit Z. Xhavit Shala. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI, për secilën pasuri është konstatuar se:
 - Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
 - Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - Nuk është kryer fshehje e pasurisë;
 - Nuk është kryer deklaram i rremë;
 - Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.
12. Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i vlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 42, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit, me shkresë nr. ***, prot., datë 22.12.2023, ka dërguar raportin e saj për subjektin e vlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar se për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur, nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, për përfshirje ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë se kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
13. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke analizuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i vlerësimit, gjatë periudhës


objekt vlerësimi, të dhënat e mbledhura në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të nenit 46, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, me shkresë nr. ***, prot., datë 01.09.2023, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e vlerësimit, në përfundim të të cilit ka konkluduar se:


- Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;
- Ka aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës;
- Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.

14. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi tre kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

15. Trupa e vlerësimit, më datë 11.12.2023, pasi dëgjoji relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Xhavit Shala, me Vendimin nr. 04, datë 23.09.2024, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Xhavit Shala;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:

 *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*

 *Rezultatet e hetimit, të pasqyruara në relacionin paraprak, për të tre komponentët, të vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional.*

- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

16. Subjekti i vlerësimit nuk e ka shfrytëzuar të drejtën për të dhënë shpjegime të tjera me shkrim dhe për tu njohur me dosjen.

17. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5, i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike", si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Subjekti i vlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike, me njoftimin e bërë elektronikisht me email, në datën 03.10.2024.

19. Seanca dëgjimore me subjektin e vlerësimit, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në datën 03.10.2024, ora 10:30, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, Tiranë, në prani të sekretariatit teknik.

20. Gjatë seancës dëgjimore, anëtarja dhe kryesuesja e Trupës së Vlerësimit i janë drejtuar me nga një pyetje subjektit të vlerësimit, trajtuar dhe pasqyruar në vendim.
21. Subjekti i vlerësimit Z. Xhavit Shala, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur opinionin individual në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij, duke konfirmuar gjetjet në relacionin paraprak.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

22. Subjekti i vlerësimit Z. Xhavit Shala, ka qenë bashkëpunues në procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.
23. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

PROCESI I VLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

24. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve, bazuar në nenin 4, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - Vlerësimin e pasurisë;
 - Kontrollin e figurës;
 - Vlerësimin e aftësive profesionale.
25. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar;
 - Ligjin nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
 - Ligjin nr. 40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”;
 - Ligjin nr. 49/2012, “Për Gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”;
 - Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
 - Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”;
 - Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”;
 - Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar;
 - Provat dhe shpjegimet e subjektit të vlerësimit;
 - Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit;
 - Raportin e dorëzuar nga ILDKPKI;

- Raportin e dorëzuar nga Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- Raportin e dorëzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Deklarata e Pasurisë;
- Deklarata për Kontrollin e Figurës;
- Formulari i Vlerësimit Profesional;
- Dokumentacionin bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet.

A. VLERËSIMI I PASURISË

- 26.** Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31, të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit, deklaratimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
- 27.** Në zbatim të nenit 32, pika 2, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit **Z. Xhavit Shala**, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë, brenda afateve të përcaktuara dhe mban nr. index 02, viti 2023.
- 28.** Procedurat e deklaratimit të pasurisë, kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe nenit 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga Trupa e Vlerësimit, kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- 29.** Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
- 30.** Gjithashtu Trupa e Vlerësimit, ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti, për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, në zbatim të nenit 33/1 dhe nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare, ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

Trupa e Vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private, në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- Dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si dhe përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ Verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve, në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ Verifikimin e burimit të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara, si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme, si edhe rasteve të konfliktit të interesit.

Deklarimi i pasurisë

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/a, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite, deri në datën e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, në pronësi, në posedim, në përdorim, ose të tjetërsuara nga subjekti i vlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose me persona të tjerë si më poshtë:

- Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- Pasuritë e luajtshme të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to;
- Sendet me vlerë të veçantë mbi 300, 000 lekë;
- Vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- Vlerën e likuiditeteve, gjendje në kesh jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari, në huadhënie, apo mjete të tjera financiare, në lekë ose në valutë të huaj;

Në deklaratën Veting, të dorëzuar në strukturat përgjegjëse, subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë pasuritë si në vijim:

1. Apartament banimi me sipërfaqe ndërtimi 114 m², i cili përbëhet nga 99.13 m² sipërfaqe shfrytëzimi si dhe 4.2 m² sipërfaqe në pjesë të përbashkëta të shkallëve, sipërfaqe trualli që i takon 25.17 m², në adresën Njësia Administrative nr. 9, rr. “****”, pallati ***, shkalla ***, ap.***, kati 4. Vlera 1, 503, 436 lekë.

Burimi i krijimit: Apartamenti është ndërtuar nga Enti i Banesave dhe është marrë me kredi nga ata në vitin 1999, me afat pagese 25 vjet. Nuk është hipotekuar, pasi vazhdon pagesa e kredisë. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje me kusht datë 23.07.2001. Palë shitëse Enti Kombëtar i Banesave dhe palë blerëse Xhavit Shala. Objekti i kontratës: Apartament me sip. ndërtimi 114 m² e cila përbëhet nga 99.13 m² sipërfaqe shfrytëzimi, si dhe nga 4.2 m² sipërfaqe në pjesën e përbashkët, sipërfaqe trualli 25.17 m², e ndodhur në katin e 4, shkalla nr. ***, banesa ***, rr. “****”, Tiranë. Vlera 1, 503, 436 lekë. Blerësi ka paguar shumën 86, 517 lekë dhe për shlyerje mbetet shuma 1, 416, 919 lekë. Bashkëlidhur Planimetria e apartamentit dhe Genplani i ndërtimit.

- Kontratë shitje me kusht nr. ***, rep., nr. *** kol, datë 26.07.2001. Palë shitëse Enti Kombëtar i Banesave dhe palë blerëse Xhavit Shala, Aida Shala, Fetah Shala, Rabije Shala. Apartament me sip. ndërtimi 114 m², e cila përbëhet nga 99.13 m² sipërfaqe shfrytëzimi, si dhe nga 4.2 m² sipërfaqe në pjesën e përbashkët, sipërfaqe trualli 25.17 m². Vlera 1, 503, 436 lekë. Blerësi ka paguar shumën 86, 517 lekë dhe për shlyerje mbetet shuma 1, 416, 919 lekë, në përputhje me kushtet dhe afatet e kredisë së dhënë nga shteti. Apartamenti ndodhet në qytetin e Tiranës, në rr. “****”, pallati ***, shkalla ***, apartamenti ***, kati i katërt.
- Librezë për kthim kredie nga Enti Kombëtar i Banesave, në emër të Xhavit Shala. Çmimi i apartamentit 1, 503, 436 lekë, kësti i paguar 86, 517 lekë, kredia e mbetur 1, 416, 919 lekë. Paguesa fillon nga muaji gusht 2001. Kësti i llogaritur 4, 730 lekë. Bashkëlidhur faturë pagese në Credins Bank e shumës 28, 380 lekë, në datë 05.12.2017, për këst kredie janar - qershor 2018, nga Xhavit Shala.
- Deklaratë Noteriale nr. ***, rep., nr. kol., ***, datë 22.09.2021, nga Saimir Shala dhe Fetah Shala, të cilët kanë deklaruar se janë trashëgimtarë ligjor të të ndjerës Rabije Shala, dhe heqin dorë nga pjesa e pronës që ju takon si bashkëpronarë dhe trashëgimtarë, sipas kontratës së shitjes me kusht më datë 26.07.2001, me nr. *** rep., nr. *** kol dhe janë plotësisht dakord që ky apartament të kalojë vetëm te Xhavit Shala dhe Aida Shala, sepse ky ka qenë edhe amaneti dhe dëshira e të ndjerës Rabije Shala dhe nuk kanë asnjë lloj pretendimi për këtë pronë.

Procedura e vlerësimit:

ASHK Tiranë, Drejtoritë Vendore Tirana Veri, Zonat e Stimuluara, Tirana Jug, Tirana Rurale 1, Kamëz, Vorë, Tiranë Rurale 2, me shkresat nr. *** prot., datë 23.10.2023; datë 26.10.2023, dhe datë 30.10.2023, nuk konfirmojnë pasurinë e deklaruar në emër të subjektit Xhavit Shala dhe personave të lidhur.

Me e-mailin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se nuk ka shpenzuar për mobilimin e apartamentit në rr. “****”, pasi e ka transferuar atë nga shtëpia e Elbasanit dhe më pas në shtëpinë ku banon sot në rr. “****”, nr. 2, Tiranë. Janë blerë vetëm një palë kolltuqe në vitin 2000, në vlerën 50, 000 lekë. Shtëpia është dhënë me qira dhe aktualisht është mobiluar pjesërisht nga qiraxhiu. Paraqiti:

- Librezë për kthim kredie nga Enti Kombëtar i Banesave, në emër të Xhavit Shala, nga verifikimi i të cilës konfirmohet detyrimi i shlyer për periudhën 2001 – 31.12.2022, në shumën 1, 246, 346 lekë.
- Foto të arredimit të brendshëm të apartamentit në rr. “****”, Tiranë.

Në procesverbalin e datës 26.01.2024, subjekti ka sqaruar se statusin e të pastrehut e ka përfituar në kohën kur ka ardhur nga Elbasani në Tiranë, si Drejtor i Policisë Kriminale në Policinë e Rendit Publik, në qershor të vitit 1999. Pallati i Entit të Banesave ishte në ndërtim e sipër dhe nga fundi i vitit 2000, u bë e mundur hyrja për banim.

Në lidhje me faktin se janë dy kontrata shitje për apartamentin nga Enti i Banesave, ka sqaruar se kontrata e datës 23.07.2001 ka qenë si formular paraprak i kontratës së blerjes dhe është aneks i kontratës së datës 26.07.2001. Pra të dyja kontratat janë një e vetme dhe janë trajtuar si një e tillë.

Gjatë asaj periudhe prindërit e tij vendosën të vinin me të në Tiranë, për të qëndruar me fëmijët e tij për këtë arsye kanë bërë edhe kontratën e blerjes së shtëpisë me Entin e Banesave së bashku. Më pas, prindërit kanë shkuar dhe kanë jetuar me vëllain e vogël, me të cilin jetojnë edhe sot. Shtëpinë e parë të përfutur nga privatizimi e kishte shitur në vitin 1994 dhe me pas u bë shtesa së bashku me vjehrrin. Në pallatin në rr. “****” ka hyrë në nëntor - dhjetor të vitit 2000, pavarësisht se kontrata me Entin e Banesave u bë në vitin 2001 dhe në atë periudhë u blenë paraprakisht një palë kolltuqe para se të futeshin në shtëpinë e re. Në shtëpinë në rr. “****”, ka filluar jetesën në vitin 2007, kur ka filluar dhe arredimi me pajisje shtëpiake të Tiranës dhe Elbasanit, siç dhe e ka deklaruar më parë.

Në procesverbalin e datës 02.02.2024, subjekti ka dorëzuar:

- Urdhër nr. ***, datë 23.06.1999, nga Kryeministri Pandeli Majko, për lirim dhe emërim në detyrë, të z. Xhavit Shala, si Drejtor, i Drejtorisë së Policisë Kriminale në Ministrinë e Rendit Publik.
- Shkresë nr. ***, datë 07.09.1999 të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për vënie banesash në dispozicion të Këshillit të Ministrave. Konfirmohet se për nevoja të Këshillit të Ministrave, nga fondi i banesave të Entit Kombëtar të Banesave, janë vënë në dispozicion 10 apartamente nga pallati i ndërtuar në adresën rr. “****”, seksioni 16. Në listën e 10 personave të paraqitur nga Këshilli i Ministrave është edhe Xhavit Shala.
- Autorizim i Bashkisë Tiranë, nr. *** prot., datë 07.12.1999, për dhënie banese për Xhavit Shala në rr. “****”.
- Certifikatë familjare e shtetasit Xhavit Shala, ku tregohet gjendja familjare e datës 31.12.1999, lëshuar nga Njësia Administrative Elbasan. Konfirmohet përbërja familjare nga Xhavit Shala kryefamiljar, bashkëshortja Aida Shala me dy fëmijët Astrit dhe Eros Shala.

Konkluzion:

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- *Apartamenti me sip. 114 m², në rr. “****”, Tiranë, në zotërim 100% të subjektit është përfutur në vitin 2001 nga Enti i Banesave, me kontratë shitje me kusht të datës 23.07.2001 dhe kontratë të datës 26.07.2001, me burim kredi nga Enti i Banesave në shumën 1, 503, 436 lekë dhe afat shlyerje 25 vjet.*
- *Pas çeljes së Dëshmisë së Trashëgimisë ligjore të vitit 2013, bashkëpronarët Saimir Shala dhe Fetah Shala, me deklaratë noteriale të vitit 2021, kanë hequr dorë nga pjesa e tyre takuese.*
- *ASHK nuk e konfirmon pasurinë e regjistruar, pasi subjekti ka detyrime të pa shlyera për kredinë e marrë nga Enti Kombëtar i Banesave.*
- *Detyrimi i shlyer për periudhën 2001 – 31.12.2022, është në shumën 1, 246, 346 lekë.*
- *Subjekti ka paraqitur dokumentacion dhe ka dhënë shpjegime lidhur me përfitimimin e statusit të të pastrehut.*
- *Shuma e shpenzuar për mobilim apartamenti ka qenë 50, 000 lekë, në vitin 2000.*
- *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur.*

2. Apartament banimi ndërtuar në vitin 1993, si shtesë në banesën private të vjehrrit Qazim Kuqashi dhe në truallin e tij, Lagja “****”, rr. “****”, nr. 16, Elbasan. Me sipërfaqe trualli 49.2 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 3 x 34 = 102 m². Regjistruar në ZRPP Elbasan, Zk. ***, nr. pasurie ***, vol. 29, fq. 84. Vlera 1, 200, 000 lekë.

Burimi i krijimit: Të ardhurat nga shitja e apartamentit të privatizuar nga shteti 550, 000 lekë, si dhe kursimet e mia dhe vjehrrit Qazim Kuqashi. Zotëron 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim pronësie nga Zyra e Hipotekës Elbasan nr. ***, datë 27.08.1993, ku konfirmohet se në radhorin e pronësisë nr. 10 me nr. rendor 372, datë 27.08.1993, figurojnë pronarët e quajtur Xhavit dhe Aida Shala, të cilët në lagjen “****” kanë në pronësi një hyrje në pallatin nr. ***, apartament nr. 8, me një dhomë e një kuzhinë.
- Kontratë shitje nr. ***, rep., nr. *** kol., datë 07.12.1994, me palë shitëse Xhevit Shalla dhe Aida Shalla, një hyrje në lagjen “****” të Elbasanit, në pallatin ***, ap.8, në bazë të vërtetimit të pronësisë me nr. radhori 10, me nr. rendor 372, datë 27.08.1993. Këtë shtëpi shitësit e shesin në shumën 550, 000 lekë, të cilat i kanë marrë të gjitha jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë dhurimi nr. ***, rep., nr. *** kol., datë 24.07.1995, dhurues Qazim Kuqashi dhe pranues i dhurimit Aida Kuqashi dhe Xhavit Shala. Dhuruesi Qazim Kuqashi është pronar i një shtëpie në lagjen “****”, Elbasan, dhe një pjesë të kësaj shtëpie, pikërisht pjesën 3 katëshe me gjithë truallin ku është ndërtuar, ja dhuron pa shpërblim vajzës së tij Aida Kuqashi dhe dhëndrit Xhavit Shala. Bashkëlidhur planimetria e shtëpisë së Qazim Kuqashi.
- Vërtetim pronësie nga Zyra e Hipotekës Elbasan nr. 526 “A”, datë 24.07.1995, ku konfirmohet se figuron e regjistruar në pronësinë e Aida Kuqashit dhe dhëndrit Xhavit Shala, të cilët e kanë marrë me dhurim nga shtëpia e Qazim Kuqashit në lagjen “****”, pikërisht pjesën tre katëshe me gjithë truallin ku është ndërtuar.
- Certifikatë për vërtetim pronësie, për pasurinë nr. ***, vol, 29, fq. 84, Zk. ***, Elbasan, truall me sip. 49.2 m² nga e cila 34 m² ndërtesa në emër të Aida Kuqashi dhe Xhavit Shala, lëshuar në datë 06.02.2008. Bashkëlidhur Harta treguese e regjistrimit.

Procedura e vlerësimit:

ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 13.11.2023, konfirmon në emër të Xhavit Shala dhe Aida Shala, pasuritë si më poshtë:

- Nr. *** e llojit “Truall” me sip. 49.2 m² nga ku ndërtesë 34 m² e ndodhur në lagjen “****”, Zk. ***, Elbasan, e regjistruar në vol. 29, fq.84, e përfituar me kontratë dhurimi nr. 2918/1241, datë 24.07.1995. Bashkëlidhur Kartela e pasurisë së paluajtshme me nr. ***, në emër të Aida Kuqashi dhe Xhavit Shala. Kontratë dhurimi nr. 2918, rep, nr. 1242 kol, datë 24.07.1995 (pasqyruar më sipër);
- Nr. *** e llojit “Apartament” me sip. 54 m² ndodhur në lagjen “****”, Zk. ***, Elbasan, e regjistruar në vol. 5, fq. 227, përfituar me kontratë privatizimi të NK Banesave Elbasan nr. 8592/7393, datë 27.08.1993. Bashkëlidhur: Kartela e pasurisë së paluajtshme me nr. ***, në emër të Xhavit Shala dhe Aida Shala; Kontratë për privatizimin e banesës datë 26.08.1993, nga NK Banesa dhe Xhavit Shala; Kontratë shitje banese nr. 8592/7393, datë

27.08.1993. Palë shitëse NK Banesa dhe palë blerëse Xhavit Shala. Apartament 1+1 në lagjen “***”, pallati ***, ap.8, në shumën 11, 480 lekë.

Me e-mailin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se apartamenti është në lagjen “****” me certifikatë pronësie. Kjo është quajtur dhe lagje “****”. Vlera e deklaruar 1, 200, 000 lekë, është shuma totale e ndërtimit e investuar nga ana e tij dhe e vjehrrit. Pjesa e investuar nga ana e tij është 600, 000 lekë. Po kaq është edhe pjesa e vjehrrit Qazim Kuqashi. Nuk disponon dokumentacion justifikues në lidhje me burimin financiar të vjehrrit të tij në atë periudhë. Nuk disponon as situacion preventiv të punimeve.

Në lidhje me mobilimin e këtij apartamenti ka deklaruar se nuk ka bërë investim të ri për mobilimin e tij.

Ka sqaruar se në kontratën e shitjes së apartamentit të tij, të përfituar nga privatizimi, në lagjen “****” është shënuar pala shitëse Xhevit Shalla dhe Aida Shalla, por këtu bëhet fjalë për Xhavit Shala dhe Aida Shala. Po në atë kontratë thuhet se Xhevit Shalla, i biri i Fetahut dhe i Rabijës, dhe Aida Shalla, e bija e Qazimit dhe Hatixhesë, që janë gjeneralitetet e tij dhe të bashkëshortes.

Kjo provohet gjithashtu dhe nga noterja M. L, me vërtetimin e njësimi me origjinalin nr. 634, rep., datë 12.04.2018, të kërkuar nga Xhavit Shala.

Ka deklaruar gjithashtu se shtëpia e Elbasanit i është lënë në ruajtje një personi i cili ka bërë një mobilim modest për nevojat e tij. Paraqiti foto të objektit, ku janë shënuar nga subjekti pjesa e vjetër e ndërtimit dhe shtesa e bërë.

Në procesverbalin e datës 02.02.2024, subjekti ka sqaruar se sipas VKM nr. 815, datë 09.12.1996, lidhur me çmimin e referencës për metër katror për vitin 1995, banesa sipas aktit të dhurimit dhe skicës përkatëse për qytetin e Elbasanit, është e barabartë me 1, 188, 940. 2 lekë.

Bashkëlidhur ka dorëzuar:

- Leje ndërtimi nr. 916, e vitit 1995 nga Këshilli i Rrethit Elbasan, dhënë firmës “****”, sipas kërkesës së tyre të bërë në muajin mars 1994, për ndërtim shtëpie mbi themelet ekzistuese. Financues Qazim Kuqashi.
- Situacion punimesh nga administratori i shoqërisë “****” sh.p.k, Ing. F. S, për objektin e ndërtuar në Elbasan në vitin 1995, me pronar Qazim Kuqashi, në shumën 1, 119, 500 lekë.
- Udhëzim për koston mesatare të ndërtimit për vitin 1995, për Entin Kombëtar të Banesave, ku konfirmohet se për qytetin e Elbasanit, çmimi për sipërfaqen e ndërtimit ka qenë 10, 716 lekë /m².
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 09.12.1996, për miratimin e vleftave mesatare vjetore të apartamenteve tip në tregun e lirë dhe vleftës së koeficientit “K”.
- Kontratë Dhurimi nr. 2918, rep, nr. 1242 kol, datë 24.07.1995.

Konkluzion:

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- ***Ndërtesa me sipërfaqe trualli 49.2 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 102 m², në Lagjen “****”, rr. “****” Elbasan, është ndërtuar gjatë viteve 1993 - 1995 dhe i është dhuruar subjektit***

nga Qazim Kuqashi (vjehtëri), në vitin 1995 me kontratë dhurimi. Vlera totale e investimit ka qenë rreth 1, 200, 000 lekë, ku pjesa e investuar nga subjekti është 1/2 e saj (rreth 600, 000 lekë), me burim shitjen e apartamentit të përfutur nga privatizimi i banesave, në vitin 1994, në shumën 550, 000 lekë dhe kursime nga të ardhurat familjare. Subjekti nuk ka kryer shpenzime mobilimi.

- *Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues, lidhur me ndërtesën si dhe për burimin financiar të përdorur nga ana e tij për ndërtimin.*
 - *Konfirmohet nga ASHK, pronësia e subjektit dhe bashkëshortes së tij në këtë apartament.*
 - *Lidhur me pasurinë e trajtuar më sipër, krijuar në vitin 1993, ndodhemi në kushtet e nenit 32, pika 1.1, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.*
3. Autoveturë Mercedes, tip E-220, me targë AA *** BI, në vlerën 2, 500 euro. Burimi i krijimit: Blerë në datë 15.10.2011 nga kursimet familjare. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje automjeti nr. 392, rep., nr. 21/2 kol, datë 15.10.2011, Mercedes, tip E-220, nr. shasje WDD***679(01), me targë IB***04, në shumën 2, 500 euro. Palë blerëse Xhavit Shala. Bashkëlidhur faturë derdhje në Raiffeisen Bank për degën e doganës Tiranë, në shumën 55, 811 lekë, datë 15.10.2011, nga shitësi i automjetit.
- Kontratë shitje automjeti nr. 1623, rep., nr. 1254 kol., datë 02.03.2019. Automjet Mercedes Benz tip E 220 CDI, nr. shasje WDD***679, me targë AA *** BI, në shumën 1, 500 euro. Palë shitëse Xhavit Shala.

Procedura e vlerësimit:

DPSHTRR, me shkresën nr. ***, prot., datë 25.09.2023, konfirmon se Xhavit Shala ka pasur në pronësi automjetin me targë AA *** BI. Bashkëlidhur:

- Kontratë blerje automjeti nr. 392, rep, nr. 21, kol, datë 15.10.2011, Mercedes Benz Tip E-220, nr. shasje WDD***679, me targë IB***04, në vlerën 2, 500 euro. Palë blerëse Xhavit Shala.
- Kontratë shitje automjeti nr. 1623, rep, nr. 1254 kol, datë 02.03.2019. Automjet Benz Tip E-220, nr. shasje WDD***679, me targë AA *** BI, në shumën 1, 500 euro. Palë shitëse Xhavit Shala.

Trupa e Vlerësimit me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për kursimin e shumës prej 2, 500 euro për blerjen e automjetit tip Mercedes E-220, në vitin 2011, kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi (Aneksi 1).

Konkluzion:

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- *Automjeti Mercedes Benz me targa AA *** BI është blerë nga subjekti në vitin 2011, në shumën 2, 500 euro dhe është shitur në vitin 2019, në shumën 1, 500 euro.*
- *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.*
- *Subjekti i vlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme me qëllim blerjen e automjetit në vitin 2011.*

4. Autoveturë Mercedes Benz me targa AA *** VA, nr. shaspie WDD***864, Modeli 180 kompresor, ngjyra e zezë, tipi gaz/benzinë, vit prodhimi 2000, në vlerën 5, 000 euro.

Burimi i krijimit: Blerë nga të ardhurat nga mësimdhënia e kursimet familjare, si dhe shitja e Autoveturës Mercedes, tip E-220, me targë AA *** BI. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje automjeti nr. 610, rep, nr. 131/1 kol., datë 26.02.2019, Mercedes Benz nr. shaspie WDD***864, tipi 240 C 180 kompresor, në shumën 5, 000 euro. Palë blerëse Xhavit Shala.
- Kontratë shitje automjeti nr. 1623, rep, nr. 1254 kol, datë 02.03.2019. Automjet Benz tip E-220, nr. shaspie WDD***679, me targë AA *** BI, në shumën 1, 500 euro. Palë shitëse Xhavit Shala.

Procedura e vlerësimit:

DPSHTRR, me shkresën nr. ***, prot., datë 25.09.2023, konfirmon se Xhavit Shala ka në pronësi automjetin ne targë AA *** VA. Bashkëlidhur:

- Kontratë blerje automjeti nr. 610, rep, nr. 131/1, kol, datë 26.02.2019, Mercedes Benz, tip 204 C 180 kompresor, nr. shaspie WDD***864, në vlerën 5, 000 euro. Palë blerëse Xhavit Shala. Bashkëlidhur dokumentet e origjinës së automjetit.

Me e-mailin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se në të njëjtën ditë që ka blerë automjetin e tij Mercedes Benz, me targa AA *** VA, i ka thënë personit të cilit i bleu makinën, D. T, që merrej me shitblerje makinash, për të shitur automjetin e mëparshëm me targë AA *** BI. Fillimisht ai i kishte thënë se do ta mbante për vete automjetin, por nuk arritën të bënin dokumentin e shitblerjes atë ditë. Më pas z. D. T e ka shitur makinën disa ditë më vonë, dhe subjekti është njoftuar për të firmosur aktin e shitjes drejtpërsëdrejti me blerësin e ri e jo me të.

Në shpjegimet e datës 17.04.2024, subjekti i vlerësimit ka cituar se automjeti me targë AA *** VA është blerë 5, 000 euro, si dhe duke i dhënë mbi këtë shumë dhe makinën e tij automjetin tip Mercedes Benz me targë AA *** BI. Prandaj dhe kjo është futur si burim krijimi për blerjen e automjetit me targë AA *** VA. Ai e ka shitur makinën e subjektit ditë më vonë, duke marrë dhe shumën 1, 500 euro sipas marrëveshjes verbale.

Trupa e Vlerësimit me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për kursimin e shumës prej 5, 000 euro për blerjen e automjetit Mercedes Benz me targa AA *** VA, në vitin 2019, kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi (Aneksi 1).

Konkluzion:

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

- *Automjeti Mercedes Benz, me targa AA *** VA është blerë nga subjekti në vitin 2019, në shumën 5,000 euro me burim të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm me targa AA *** BI, në shumën 1,500 euro, po në vitin 2019, si dhe kursime familjare.*
 - *Subjekti dha sqarime lidhur me periudhat e shitblerjes së automjeteve në pronësi.*
 - *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.*
 - *Subjekti i vlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme me qëllim blerjen e automjetit në vitin 2019.*
5. Tokë arë, me sip. 501 m², në Qerret - Kavajë, regjistruar në ZRPP Kavajë, Zk. ***, nr. pasurie ***, vol. 13, fq.82, në vlerën 100,000 lekë.

Burimi i krijimit: Blerë me kursimet familjare në vitin 2007 nga babai im Fetah Shala dhe nëna Rabije Shala, të cilën e kanë përfituar atë me Ligjin nr. 7501 "Për tokën". Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme datë 15.03.2007, për pasurinë "Arë" me sip. 501 m², nr. pasurie ***, vol. 13, fq.82, Zk.***, në Qerret, me vlerë 100,000 lekë. Palë shitëse Fetah dhe Rabije Shala dhe palë blerëse Xhavit Shala.
- Certifikatë për vërtetim pronësie, për pasurinë "Arë", me sip. 501 m², nr. pasurie ***, vol. 13, fq.82, Zk. ***, në Qerret, Kavajë, në emër të Xhavit Shala, lëshuar në datë 30.03.2007. Bashkëlidhur: Harta treguese e regjistrimit.

Procedura e vlerësimit:

ASHK, Drejtoria Vendore Kavajë, me shkresën *** prot., datë 30.10.2023, konfirmon se në emër të Xhavit Shala, figuron e regjistruar pasuria me nr. ***, Zk. *** në Qerret, vol.13, fq. 82, përfituar me kontratë shitje. Bashkëlidhur:

- Kartela e pasurisë së paluajtshme e llojit arë me sip. 501 m², nr. pasurie ***, me vlerë 100,000 lekë, regjistruar në datë 30.03.2007.
- Kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. 530, rep, nr. 530 kol, datë 15.03.2007, për pasurinë "Arë" me sip. 501 m², nr. pasurie ***, vol. 13, fq.82, Zk. ***, në Qerret, me vlerë 100,000 lekë, palë shitëse Fetah dhe Rabije Shala dhe palë blerëse Xhavit Shala.
- Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë me nr. ***, arë me sip. 501 m², në emër të Fetah Shala, lëshuar në datë 26.12.2006. Harta treguese e pasurisë, Kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, Zk. *** në Qerret, Kavajë në emër të Fetah Shala.
- Vërtetim i datës 30.01.2007, nga Komuna Golem, ku miratohet e drejta për Fetah Shala, me cilësinë e kryetarit të familjes bujqësore të bëjë kalimin (shitjen) e pronësisë së pasurisë ***, me sip.501 m², Zk. 3101 në Qerret, të cilën e ka në bashkëpronësi me anëtarët e tjerë të familjes bujqësore, të fituar me Ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991.

Me e-mailin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se kjo sipërfaqe toke nuk është zhvilluar dhe nuk është shfrytëzuar nga ana e tij. Subjekti ka dorëzuar foto nga google, të sipërfaqes së tokës në pronësinë e subjektit, në Qerret, Kavajë, për të ilustruar vendndodhjen e saj në një zonë ende të pazhvilluar, si dhe foto të pronës, për të vërtetuar se është e pazhvilluar dhe e pashfrytëzuar.

Në procesverbalin e datës 26.01.2024, subjekti ka sqaruar se babai e ka përfitur tokën me Ligjin nr. 7501, por ai nuk ka përfitur në atë periudhë, pasi ishte i shkëputur nga Kavaja që në vitin 1984 dhe kishte pasaportizimin në Elbasan. Tokat me Ligjin nr. 7501 janë ndarë për familjarët, që deri në vitin 1991 ishin në trungun familjar. Për këtë arsye për të mos e lënë pa asnjë pjesë toke, babai i tij gjeti mundësinë me kontratë shitje dhe i dha 500 m². Kjo pjesë toke që i është shitur atij nga babai është nga sipërfaqja e përgjithshme e përfitur nga ai, me Ligjin nr. 7501.

Në procesverbalin e datës 02.02.2024, subjekti ka dorëzuar:

- AMTP nr. 29, datë 15.01.1993, në emër të Fetah Shala, ku konfirmohet se ka përfitur gjithsej 13.350 m², tokë arë.
- Certifikatë familjare nga Njësia Administrative Golem, e trungut familjar të Fetah Shala, ku tregohet përbërja familjare e tij në datë 01.08.1991. (Konfirmohet se Xhavit Shala, nuk ka qenë pjesë e trungut familjar në atë periudhë).
- Certifikatë familjare nga Njësia Administrative Elbasan, e trungut familjar të Xhavit Shala, ku tregohet përbërja familjare e tij, në datë 31.12.1991.
- Kontratë e shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.09.2003, me palë shitëse Fetah Shala, Rabije Shala, Saimir Shala dhe Luljeta Shala dhe palë blerëse Bajram Shala. Tokë arë me sip. 518 m², nr. pasurie *** në fshatin Qerret Kavajë, në shumën 150, 000 lekë. (Sipas sqarimeve të subjektit, kjo për të vërtetuar faktin se babai i tij, i ka dhënë tokë, përveç atij, edhe vëllait dhe motrës së madhe, të cilët nuk kanë qenë pjesë e trungut në atë periudhë).

Konkluzion:

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- *Pasuria tokë arë me sip. 501 m², në Qerret, Kavajë, në zotërim 100% të subjektit është blerë me kontratë shitblerje të vitit 2007, me palë shitëse prindërit e tij, në vlerën 100, 000 lekë, me burim të ardhurat familjare. Kjo pasuri është përfitur nga Fetah Shala (babai i subjektit) si kryetar i familjes bujqësore.*
 - *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK Drejtoria Vendore Kavajë.*
 - *Lidhur me pasurinë e trajtuar më sipër, përfitur në vitin 2007, ndodhemi në kushtet e nenit 32, pika 1.1, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.*
6. Apartament + papafingo dhe dy garazhe, të ndodhura në rr. “*****” nr. 82, Tiranë me vlerën 6, 800, 000 lekë. Ishte në proces legalizimi. Kjo pasuri 50% të së cilës unë e zotëroj dhe 50 % gruaja, ka qenë deklaruar në proces legalizimi në deklarinimet e vitit 2006.

Burimi i krijimit: Pasuria është përfituar me testamentin nr. 131, datë 09.06.2008. Vendim për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë nr.786, rep., nr. 330 kol, datë 26.02.2014, të vjehrrit Qazim Kuqashi. Kjo pasuri është legalizuar tashmë dhe e ndarë nga Aluizni në tre certifikata, është ri deklaruar nga ana ime për vitin 2021 si më poshtë:

- 1) Apartament me sip. 104.60 m², rr, “****”, nr.82, Tiranë, nr. prone ***, indeksi i hartës TR; T-15, Zk.***, vol.44, fq.141. E regjistruar nga ZVRPPD, Tirana Jug, mbi bazën e dokumentit Akt Trashëgimie, nr. rep.786, nr. kol 330, datë 26.02.2014, mbi bazën e Vendimit për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Testamentare. Kjo pasuri rrjedh nga trashëgimia testamentare e vjehrrit Qazim Kuqashi. Zotëron 50 %.
- 2) Apartament me sip. 104.60 m², rr. “****”, nr.82, Tiranë, nr. prone ***, indeksi i hartës TR; T-15, Zk.***, vol.44, fq.140. E regjistruar nga ZVRPPD, Tirana Jug, mbi bazën e dokumentit Akt Trashëgimie, nr. rep.786, nr. kol 330, datë 26.02.2014, mbi bazën e Vendimit për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Testamentare. Kjo pasuri rrjedh nga trashëgimia testamentare e vjehrrit Qazim Kuqashi. Zotëron 50 %.
- 3) Garazh me sip. 106.30 m², me bashkëshorten bashkëpronarë të 40% të kësaj sipërfaqe (në certifikatë figuron apartament), nr. prone ***, indeksi i hartës TR; T-15, Zk.***, vol.44, fq.136. E regjistruar nga ZVRPPD Tirana Jug. Data e regjistrimit 08.07.2020, mbi bazën e dokumentit Akt Trashëgimie, nr. rep.786, nr. kol 330, datë 26.02.2014. Kjo pasuri 40% të së cilës unë dhe bashkëshortja e zotërojmë, rrjedh si trashëgimi nga vjehri im Qazim Kuqashi, bërë me testamentin nr. 131, datë 09.06.2008 dhe Vendimi nr. 786, rep, nr. 330 kol, datë 26.02.2014, për Lëshimin e Dëshmisë Testamentare pas vdekjes së tij. Zotëron 20 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Certifikatë për vërtetim pronësie**, për pasurinë apartament, me sip. 104.6 m², me nr. ***, Zk. ***, vol.44, fq. 141, në emër të Aida Shala dhe Xhavit Fetah Shala, lëshuar në datë 08.07.2020. Bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme në emër të Aida Shala dhe Xhavit Shala, ku konfirmohet se regjistrimi i pasurisë është bërë me kontratë pjesëtimi nr. 1874/958, datë 20.06.2020. Harta treguese e regjistrimit.
- **Certifikatë për vërtetim pronësie**, për pasurinë apartament me sip. 104.6 m², me nr. ***, Zk.8190, vol.44, fq.140, në emër të Aida Shala dhe Xhavit Fetah Shala, lëshuar në datë 08.07.2020. Bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme në emër të Aida Shala dhe Xhavit Shala, ku konfirmohet se regjistrimi i pasurisë është bërë me kontratë pjesëtimi nr. 1874/958, datë 20.06.2020. Harta treguese e regjistrimit.
- **Certifikatë për vërtetim pronësie**, për pasurinë apartament me sip. 106.3 m², me nr. ***, Zk.***, vol.44, fq. 136, në emër të V. B, Aida Shala, F. Z, Xhavit Fetah Shala dhe S. H, me nga 1/5 pjesë secili, lëshuar në datë 08.07.2020. Bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme, ku konfirmohet se regjistrimi i pasurisë është bërë me kontratë pjesëtimi, nr. 1874/958, datë 20.06.2020. Harta treguese e regjistrimit.
- **Leje Legalizimi** muaji prill 2020 dhënë nga Drejtoria Rajonale Tiranë Jug, për objektin e banimit 5 kat + 1 kat nën tokë, në emër të S. H, Qazim Kuqashi, V. B, K. Z, Zk. ***, nr. pasurie ***, sip. e parcelës ndërtimore 205.6 m², sip. ndërtimi 106. 3 m², sipërfaqe totale ndërtimi 761.8 m², numri i kateve mbi tokë 5 dhe nën tokë 1. Bashkëlidhur Genplan i pasurisë.

- **Vetdeklarim për legalizimin e objektit**, banesë dhe garazh, në rr. “****”, me deklarues Qazim Kuqashi, datë 05.09.2006. Sipërfaqe e zënë 204 m² dhe sip. ndërtimi 260 m², numri i kateve mbi tokë 5, nën tokë 1. Njoftim për formularët e pagesave nr.3048/127, datë 12.04.2011, drejtuar K. Z, Qazim Kuqashi, V. B dhe S. H. Vlera e investimit 17, 900, 789 lekë, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë 89, 504 lekë.
- **Testament nr.131, datë 09.06.2008**, i testamentarit Qazim Kuqashi, i cili ka emëruar si trashëgimtar testamentar, vajzën e tij Aida Shala (Kuqashi) dhe dhëndrin e tij Xhavit Shala, duke ju lënë si trashëgim pas vdekjes së tij, një pronë në masën 50% me 50%, apartamentin + papafingo dhe 2 garazhe të ndodhura në bodrumin e objektit, në Tiranë, rr. “****”, objekte të cilat janë ende në proces legalizimi. Kjo është dëshira e tij e fundit dhe kërkon të respektohet nga të gjithë. Bashkëlidhur: Procesverbal për çelje testamenti nr. 1639, rep., nr. 666 kol., datë 12.04.2010.
- **Vendim për lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Testamentare** nr. 786, rep., nr. 380 kol., datë 26.02.2014, për trashëgimlënësin Qazim Kuqashi. Konfirmohet se Qazim Kuqashi ka ndërruar jetë në datë 29.03.2010 dhe si trashëgimtarë testamentarë të tij janë përcaktuar Aida Shala (Kuqashi) dhe Xhavit Shala, të cilët trashëgojnë në pjesë të barabarta nga ½ secili, të pasurisë trashëgimore, që është një apartament + papafingo dhe 2 garazhe të ndodhura në bodrumin e objektit, në Tiranë, rr. “****”, objekte të cilat janë ende në proces legalizimi, si dhe përgjigjen për detyrimet e saj trashëgimore në të njëjtën masë. Për të gjithë pjesën tjetër të trashëgimisë së trashëgimlënësit, zbatohet trashëgimia ligjore sipas Vendimit gjyqësor nr.4526, datë 25.04.2013.

Procedura e vlerësimit:

Me e-mailin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se vlera e pasurisë është shënuar 6, 800, 000 lekë, bazuar në një vlerësim të Aluiznit me 28, 333 lekë për metër katror sipërfaqe ndërtimi, paraqitur kjo në formularin e pagesës së taksës së ndërtimit në infrastrukturë për objekte informale. Pjesa takuese e tij është rreth 240 metra katror x 28, 333 lekë = 6, 799, 000 lekë.

Adresa e pasurisë është në rr. “****”. Fjala “****” është një lapsus. Në lidhje me burimin financiar të vjehrrit të tij ka sqaruar se, di vetëm që Qazim Kuqashi ishte trashëgimtar i vetëm testamentar i Alush Kuqashit, i njohur si tregtar shajak punues në Elbasan. Një pjesë të pasurive të tij, vjehrrit i ka marrë dhe i ka disponuar me testament, por ka dhe të tjera që nuk i ka marrë pasi kanë qenë të zëna dhe ndoshta ka bërë marrëveshje me këta persona. Vjehrrit nuk e ka deklaruar ndonjëherë burimin financiar për investimet e kryera nga ana e tij.

Disponon situacione të pjesshme punimesh, si dhe disa fatura pagesash për punimet e kryera nga ana e vjehrrit të tij Qazim Kuqashi. Pjesa më e madhe e dokumentacionit është djegur më 13 nëntor 2015, nga një zjarr që ra në katin e sipërm të shtëpisë. Nga ana e tij, pas vdekjes së vjehrrit, është investuar në banesën e ndërtuar nga ai në Tiranë dhe konkretisht:

Në vitin 2015 pas djegies së një pjese të katit të sipërm, për gërryerje, janë kryer shpenzime për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri në banesë rreth 600, 000 lekë dhe janë mbuluar nga kursimet familjare, të ardhurat nga mësimdhënia, gjendja cash etj.

Në vitin 2018, fasada e jashtme e pjesës së tij të banesës është veshur me kapot. Shuma e investuar ka qenë rreth 410, 000 lekë. Nga këto 239, 500 lekë shpenzime materiale, 168, 000 lekë vlera e fuqisë punëtore (përfshirë dhe lyerjen). Shpenzimet janë mbuluar nga kursimet

familjare, të ardhurat nga mësimdhënia, gjendja cash etj. Janë bërë punime për sistemimin e garazhit, së bashku me bashkëpronarët e tjerë, për shumën 348, 900 lekë. Pjesa e tij takuese e shpenzimeve 139, 560 lekë ($348, 900 : 5 = 69, 780 \times 2$ (përlllogaritur për dy kate), Shpenzimet janë mbuluar nga kursimet familjare, të ardhurat nga mësimdhënia, gjendja cash etj.

Gjithashtu janë blerë kondicionerë (sistem ngrohje ftohje), me vlerë 3, 600 euro (tremijë e gjashtëqind) euro, të cilat janë mbuluar nga kursimet familjare, të ardhurat nga mësimdhënia, gjendja cash etj.

Mobilimi i shtëpisë në përgjithësi ka qenë i përdorur në Elbasan dhe në Tiranë. Janë shtuar një komplet kolltukësh në vitin 2000 me vlerë 50, 000 lekë. Dy dhoma gjumi për djemtë dhe një guzhinë në vitin 2007, me vlerë përkatësisht 120, 000 lekë dhe 110, 000 lekë, si dhe dy biblioteka me vlerë 90, 000 lekë. Një tavolinë pune dhe karrige rrotulluese në vitin 2007, me vlerë 58, 000 lekë të dyja. Një dyshek në vitin 2022 me vlerë 51, 994 lekë. Gjithashtu pajisjet elektroshtëpiake janë rinovuar konkretisht televizorët në vitin 2011, me vlerë 100, 000 lekë dhe në vitin 2019 me vlerë 138, 540 lekë, kompjuter pune në vitin 2007, me vlerë 65, 000 lekë, dhe lavatriçe në vitin 2023 me vlerë 45, 000 lekë. Gjithashtu një pompë uji në vitin 2007, me vlerë 38, 500 lekë Gjithsej ky arredim ka kushtuar rreth 718, 534 lekë. Për sa më sipër disponon dokumentacion të pjesshëm. (Shpenzime në total për mobilim në vitin 2007 e në vazhdim rezultojnë rreth 817, 000 lekë).

Ne lidhje me regjistrimin e pasurisë, nëpërmjet kontratës së pjesëtimit ka sqaruar se, sipas procedurave të legalizimit fillimisht bëhet legalizimi në total i gjithë godinës (jo sipas pjesës takuese të secilit), dhe del një certifikatë legalizimi e përbashkët e godinës për të gjithë pronarët. Më pas bëhet pjesëtimi mes banorëve sipas pjesës takuese të tyre, nëpërmjet një kontratë pjesëtimi të pasurisë së paluajtshme.

Për faktin se përse vjehri Qazim Kuqashi ka emëruar si trashëgimtar testamentar vajzën Aida dhe dhëndrin Xhavit Shala, ka sqaruar se vjehri Qazim Kuqashi ka dhe një vajzë tjetër, së cilës i ka lënë trashëgimi me testament 3, 000 metra katror tokë arë, një pjesë të shtëpisë së vjetër (me trashëgimi ligjore), pasuri të luajtshme (numër llogarie), si dhe pjesë ullahte (me trashëgimi ligjore).

Gjithashtu, vjehri i tij Qazim Kuqashi, përpara se të emëronte si trashëgimtarë testamentar vajzën Aida dhe dhëndrin Xhavit Shala, ka banuar vetë në pjesën e re të shtëpisë në Elbasan (të ndërtuar bashkërisht në 1993 - 1994), si dhe në shtëpinë në Tiranë deri sa ka ndërruar jetë në vitin 2010. Ai ka jetuar bashkë me ta dhe ka pleqëruar tek vajza Aida dhe dhëndri Xhavit Shala. Tek ta ka pleqëruar dhe bashkëshortja e Qazimit, vjehra e tij Hatixhe Kuqashi, deri sa ka ndërruar jetë dhjetë vite më vonë, në vitin 2020. Në përgjithësi është një traditë që pasuria i lihet djalit apo vajzës ku pleqëron. Edhe babai dhe nëna e tij, pasurinë ja kanë lënë vëllait të tij ku kanë pleqëruar. Përveç dy vajzave, vjehri Qazim Kuqashi, ju ka lënë pasuri me testament dhe personave jashtë familjes, si motrës, nipit dhe mbesave. **Paraqiti:**

- **Dokumentacion për vjehrin e tij Qazim Kuqashi**, ku vërtetohet se nga familja e tij ka trashëguar prona në Elbasan dhe konkretisht nga babai i tij Alush Kuqashi;
- **Kontratë shitblerje e datës 17.07.1935**, ku Alush Kuqashi ka blerë gjithë vendin ullahte me 30 dru ullinj që ndodhet në sinurin Harmas të Elbasanit. Gjithë vendin me 27 dru ullinj,

ndodhur në sinurin Harmas të Elbasanit, regjistruar në regjistrat e kadastrës me nr. 50, 51, 52 dhe 53, datë 26.04.1927.

- **Notë Transkriptimi me nr. 759/126**, datë 20.03.1936, me të cilën Alush Kuqashi me cilësinë e palës blerëse, ka blerë të gjithë vreshtin 4 dynym me 35 dru ullinj, të ndodhur në sinurin Harmas të Elbasanit, me emrin Kapërçellë, si dhe vreshtin dy ovlek me 48 drurë ullinj, i ndodhur po në sinurin Harmas. Bashkëlidhur Vërtetim Zotnimi në emër të Alush Kuqashi.
- **Vendim nr. 5/2, datë 25.05.1994**, nga Komisioni i Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, në të cilin në bazë të Ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, neni 21, është vendosur se ish-pronarit Alush Kuqashi i jepet e drejta e parablerjes për sipërfaqen 64 m², zënë nga një pjesë e hotel Turizmit Elbasan. Bashkëlidhur: Vendim nr. 2465, datë 23.11.1993 i Gjykatës së Rrethit Elbasan, ku është vendosur vërtetimi i faktit juridik i pronësisë së babait të kërkuesit Qazim Kuqashi, Alush Kuqashi, mbi një truall të ndodhur në vendin e quajtur “Tregu i Leshnave” 100 kut.
- **Kërkesë drejtuar Komisionit të Kthimit të Trojeve në Bashkinë Elbasan**, nga Qazim Kuqashi në datë 09.08.1993, për njohjen e të drejtës së bashkëpronësisë mbi truallin dhe lokalit, sipas madhësisë 100 kut në Turizmin e Ri Elbasan, duke qenë se dyqani që ka trashëguar (sipas akteve të trashëgimisë) në rr. “Leshna” me sip. 100 kut, nuk ekziston as si ndërtesë dhe as si truall, pasi mbi të është ndërtuar Turizmi i ri. Vërtetim Zotnimi (Tapi) nr. 638, në emër të Alush Kuqashi, datë 18.08.1919, për dyqan me sip. 100 kutësh.
- **Kontratë dhurimi** nr. 4239 rep, nr. 3070 kol, datë 20.05.1993 me palë dhuruese Qazim Kuqashi dhe palë pranuese e dhurimit Aida Kuqashi, për pasuritë: Dyqan i përberë prej 10 kutësh në Elbasan, sipas vërtetimit të zotnimit nr. 638. Gjithë vendin ullishte me 32 dru ullinj të ndodhur në sinurin Harmas të Elbasanit. Gjithë vendin ullishte me 27 dru ullinj ndodhur në sinurin Harmas të Elbasanit. Të gjitha këto pasuri të patundshme dhuruesi Qazim Kuqashi ia dhuron pa shpërblim së bijës Aida Kuqashi.
- **Notë Transkriptimi** nr. 18613, Repertori, datë 08.03.1939. Palë blerëse Alush Kuqashi, për pasurinë “Arë”, 6 dynym me 28 dru ullinj në vlerën 65 napolona ari, ndodhur në sinurin Bejler Beje të Elbasanit.
- **Vërtetim pronësie** nr. 186, datë 02.02.1994, nga Gjykata e Rrethit, Zyra e Hipotekave. Vërtetohet se në radhorin 13, nr. 186, datë 08.03.1939, në favor të Alush Kuqashi nga Elbasani, u shit për 65 napolona ari, “Arë”, 6 dynym me 28 dru ullinj.
- **Njoftim për formularët e pagesave nr. 3048/127**, datë 12.04.2011, drejtuar K. Z, Qazim Kuqashi, V. B dhe S. H. Vlera e investimit 17, 900, 789 lekë, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë 89, 504 lekë.
- **Preventiv punimesh** në emër të Qazim Kuqashi i vitit 2006 + fatura pagesash nga Qazim Kuqashi, për blerje materiale ndërtimi në vitin 2006.
- **Kthim përgjigje** nr. 5264/1, prot., datë 28.09.2018 nga Njësia Administrative nr. 2, Tiranë, drejtuar Xhavit Shala, për punime për rifreskimin e suvatimeve dhe lysterjeve të jashtme.
- **Preventiv punimesh** për rikonstruksion fasade (veshje kapot). Kostoja e punimeve + materialet e ndërtimit në shumën 407, 500 lekë. Bashkëlidhur faturë e blerjeve të materialeve të ndërtimit datë 30.09.2018, nga Xhavit Shala.
- **Shënime nga Xhavit Shala** të shpenzimeve të vitit 2018 + fatura të pagesave për blerje materiale ndërtimi. Sipas shënimeve shuma e përgjithshme 3, 489, 000 lekë. (Shënim nga subjekti, ku ka sqaruar se shumat janë shprehur në lekë të vjetra).
- **Faturë blerje** kondicioneri nga ***, datë 19.09.2018, në shumën 3, 600 euro (455, 904 lekë). Bashkëlidhur pagesë fature në Credins Bank, datë 20.09.2018, e shumës 3, 600 euro.

- **Leje Legalizimi** e vitit 2020, dhënë nga Drejtoria Rajonale Tirana Jug, për objektin e banimit 5 kat + 1 kat nën tokë, në emër të S. H. Qazim Kuqashi, V. B, K. Z, Zk. ***, nr. pasurie ***, sip. e parcelës ndërtimore 205.6 m², sip. ndërtimi 106.3 m², sipërfaqe totale ndërtimi 761.8 m², numri i kateve mbi tokë 5 dhe nën tokë 1. Titulli i pronësisë mbi tokën “Do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave”.
- **Kontratë pjesëtim pasurie** nr. 1874 rep, nr. 957 kol, datë 20.06.2020. Pronarët me cilësinë e pjesëtuesve: Xhavit Shala, Aida Shala, S. H, F. Z, V. B. Objekti i kontratës: Pjesëtimi i pasurisë së paluajtshme nr.***, Zk.***, ndërtesë me sip. totale 106 m², nga e cila ndërtesë me sip. 106.3 m². Bashkëpronarët bien dakord si më poshtë:

Aida Shala, Xhavit Shala, do marrin në pronësi katin nëntokë me sip. prej 106.3 m².

Aida Shala dhe Xhavit Shala do marrin në pronësi katin e tretë me sip. 118.7 m², katin e katërt me sip. prej 118.7 m².

- Testament nr. 733, datë 23.06.2009 nga Qazim Kuqashi, në të cilin ai ka kërkuar që pas vdekjes së tij, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme ti testërojë si më poshtë:

- Një arë në sinurin Belerbej, me sip. 6 dynym dhe 28 dru ullinj, sipas vërtetimit të Zyrës së Hipotekave Elbasan me nr. 186, datë 02.02.1994 dhe aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. 78, i regjistruar datë 20.04.1998, të Komisionit të Tokës, ia lë trashëgim në mënyrë të barabartë vajzave të tij Aida Kuqashi dhe Brikena Kuqashi.
- Një truall të ndodhur në vendin e quajtur “Leshna”, me sip. 100 kut = 64 m², sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Elbasan nr. 2465, datë 23.11.1993 dhe Vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave nr. 5/2, datë 25.05.1994, të Bashkisë Elbasan, ia lë trashëgim në mënyrë të barabartë fëmijëve të vëllait Ibrahim Kuqashi.
- Një ullishte në sinurin Harmas me sip. 3 dynym dhe 57 dru ullinj, sipas zyrës së Hipotekave Elbasan nr. 290, datë 14.06.1995, si dhe sipas vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave të Rrethit Elbasan nr. 174, datë 15.03.1995, ia lë trashëgim në mënyrë të barabartë fëmijëve të vëllait të tij Ibrahim Kuqashi.
- Një ullishte në sinurin Harmas me sip. 4 dynym dhe 72 dru ullinj, sipas vërtetimit të zyrës së Kadastrës Elbasan nr.53 dhe nr.54, datë 23.08.1994, si dhe sipas vërtetimit të Komisionit të Tokave Elbasan nr.203 dhe nr.205, datë 10.10.1995, si dhe tapisë së vitit 1923, ia lë trashëgimi mbesës së tij R. D.

- Foto të shtëpisë në rr. “****”, nga jashtë, si dhe të mobilimit të brendshëm (gjithsej 17 copë).
- Fatura blerje pajisje shtëpiake 2006-2023, në shumën totale rreth 331, 534 lekë (gjithsej 7 copë).

Në procesverbalin e datës 26.01.2024, subjekti ka sqaruar në lidhje me mobilimin e shtëpisë në rr. “****” se ka qenë një lapsus nga ana e tij në mënyrën e shprehur, pasi ka dashur të thotë se është komplet kolltukësh të cilat ishin blerë në vitin 2000, kur kishte hyrë në shtëpinë në lagjen D. B, të cilat më pas i kishin marrë me vete. Pra arredimit të vjetër, i ishte shtuar vetëm ky komplet kolltukësh të cilat ishin blerë në shtëpinë në lagjen D. B dhe të gjitha i kishin marrë me vete për tek shtëpia në rr. “****”, në të cilën kanë filluar jetesën në vitin 2007.

Në funksion të hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, Trupa e Vlerësimit me emailin e datës 03.06.2024, i ka kërkuar subjektit të vlerësimit sqarime lidhur me:

1. Periudhat e sakta, se kur ka filluar dhe mbaruar ndërtimi i objektit në rrugën “***”, nr.82, Tiranë.
2. Lidhjen e vjehrrit Qazim Kuqashi me Z. V. B dhe Z. S. H, të cilët kanë kryer së bashku këtë investim pa leje, që më pas është legalizuar.
3. Burimin financiar të pjesës takuese të vjehrrit në këtë pasuri duke paraqitur dokumentacion shoqërues justifikues përkatës mbi të ardhurat e vjehrrit që kanë shërbyer si burim.
4. Paraqitjen e preventivit mbi vlerën e punimeve të gjithë godinës duke qartësuar dhe saktësuar përkatësisht pjesën takuese të vjehrrit.
5. Paraqitjen e librezës së energjisë elektrike dhe atë të ujit, ku të tregohet periudha në të cilën ka filluar të pagujë shpenzime energjie dhe uji në atë godinë.
6. Vënien në dispozicion ortofoto të objektit në fjalë për çdo vit, që nga momenti i parë që kanë filluar ndërtimet.

Subjekti i vlerësimit, më datë 10.06.2024 ka dorëzuar pranë Trupës së Vlerësimit, sqarimet përkatëse konkretisht:

Vjehrrit Qazim Kuqashi në mirëkuptim me pronarin e katit të tretë S. H, me të cilin kishte njohje, rreth vitit 2001, ka filluar një shtesë kati së bashku me papafingo, të cilat i ka përfunduar në fund të vitit 2006. Nuk ka patur asnjë marrëveshje me të tjerët për një investim të përbashkët nga themeli të këtij objekti dhe se nuk i ka njohur ata përveç S. H. Vjehrrit ka bërë shtesë kati mbi S.H dhe e ka financuar vet ndërtimin e kësaj shtese.

Lidhur me burimin financiar të vjehrrit me qëllim ndërtimin e objektit, subjekti u shpreh se është ndërtuar me pasuri të trashëguara nga Alush Kuqashi, por dhe nga kursimet e tij prandaj dhe ndërtimi i shtëpisë ka zgjatur rreth 5 vite, nga viti 2001 deri në vitin 2006. Ai shprehet se nuk ka dijeni, informacion apo mundësi të tjera për të verifikuar burimin e tij financiar.

Lidhur me preventivin e ndërtimeve, subjekti shprehet se nuk ka si të kishte preventiv apo projekt të godinës në kushtet e një ndërtimi informal. Subjekti ka dorëzuar disa situacione të pjesshme punimesh si dhe disa fatura pagesash të vitit 2006, për punimet e kryera nga vjehrrit Qazim Kuqashi, të cilat sipas tij dokumentojnë dhe provojnë se punimet janë kryer nga vjehrrit për ndërtimin e apartamentit dhe papafingos.

Në funksion të hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, subjekti i vlerësimit ka dorëzuar pranë Trupës së Vlerësimit:

Shkresë nr. 3973/1, prot., nr. 25.06.2024 të Furnizuesit të Shërbimit Universal Sh.a, ku citohet se në emër të Qazim Kuqashi, rezulton kontrata nr. E-209*** me kod klienti TR2E***03, hapur më datë 29.06.2007. Bashkëlidhur shkresës gjendet dokumentacioni si më poshtë:

Fotokopje e librezës me nr. 209***, në emër të Qazim Kuqashi;

Faturë tatimore e datës 30.06.2007 lidhur me pagesën për kundrejt OSHEE në vlerën 26, 880 lekë, për kontratën nr. E-209*** në emër të Qazim Kuqashi, në adresën “***”.

Detaje të faturimit për kontratën nr. E-209***, për periudhën 30.06.2007 – maj 2024.

Shkresë nr. K-1493/1, prot., datë 15.07.2024, e Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.a, ku citohet se në emër të Qazim Kuqashi rezulton kontrata me nr. 146***, e regjistruar sipas

regjistrit të kontraktuesve të vitit 2008, për objektin me adresë: rr. “****”, me status aktiv, në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me detyrime të likuiduara deri në muajin maj 2024.

Lidhur me pasuritë apartament, subjekti i vlerësimit u pyet gjatë seancës dëgjimore të datës 03.10.2024, nga anëtarja e Trupës së Vlerësimit, konkretisht: “...Siç dhe keni deklaruar dy apartamentet dhe garazhi në rr. “F.T”, Tiranë, janë pasuri të ndërtuara pa leje si katër katet ashtu dhe 2 katet e tjera të ndërtuara nga vjehri juaj dhe banuar edhe nga ju që prej vitit 2007, legalizuar në vitin 2020. Në kthim përgjigjet tuaja, jeni shprehur se kur vjehri ndërmori këtë nismë për të ndërtuar 2 katet, ju e keni këshilluar në lidhje me infrastrukturën e asaj zone, nëse do ja vlente investimi, kur në fakt duhej ta këshillonit në lidhje me paligjshmërinë e ndërtimit. Nisur nga këto fakte si dhe duke qenë se jeni një funksionar i lartë i Policisë së Shtetit, jurist, akademik dhe ekspert i sigurisë, duhet të mbështesni dhe siguroni ligjin dhe jo të vendoseni në një pozicion konflikti në zbatim të tij, duke mos cënuar besimin në publik. Komenti dhe qëndrimi juaj në lidhje me këtë çështje...”

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar se “...Unë i kam thënë që është zonë informale, dhe nuk ja vlen të investosh, pasi aty mund të ndërtohet një rotondo dhe ta fshijë shtëpinë fare. Pra unë e kam këshilluar dhe për këtë. Në fund fare vendimmarrja i takonte atij, nuk më takonte mua...”

Gjithashtu gjatë seancës dëgjimore kryesuesja e Trupës së Vlerësimit ka pyetur subjektin lidhur me mënyrën e përfitimit të pasurisë garazh fillimisht nga vjehri e më pas nga ana e tij.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar se “...Faktikisht garazhi mori emrin më mbrapa, pasi ata i ngritën themelet dhe i përdornin për depot e ujit, sepse zona ishte pa ujë. Më pas i kanë pastruar, i kanë rregulluar të gjithë bashkë dhe e kanë shfrytëzuar për makinat. Por e vërteta është se e kanë përdorur për depo uji, madje kur e legalizuar e vunë emrin apartament...”

Konkluzion:

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- *Dy apartamentet me sip. 104.60 m², në zotërim 100% të subjektit dhe bashkëshortes së tij, si dhe pasuria Garazh me sip. totale 106. 30 m², nga e cila ai ka në zotërim 40% me bashkëshorten, me adresë në rr. “****”, Tiranë, janë përfituar me testamentin nr. 131, datë 09.06.2008 dhe Akt Trashëgimie nr. 786/330, datë 26.02.2014 nga vjehri i tij Qazim Kuqashi.*
- *Subjekti ka deklaruar se nuk ka kryer shpenzime në ndërtimin e kësaj godine, por ka kryer vetëm shpenzime mobilimi, rikonstruktimi, kondicionimi, etj., për periudhën 2007 - 2023, në shumën totale rreth 2, 366, 600 lekë, me burim nga të ardhurat familjare, të cilat referuar tabelës financiare janë të mjaftueshme për justifikimin e këtyre shpenzimeve.*
- *Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me dy apartamentet me sip. 104.60 m² secili dhe pjesën takuese prej 40% me bashkëshorten në pasurinë garazh me sip. totale prej 106.30 m² në rr. “****” në Tiranë, të përfituar me dëshmi testamentare të vitit 2008 dhe dëshminë e trashëgimisë ligjore të vitit 2014, nga babai i bashkëshortes Qazim Kuqashi.*
- *Nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumentacion justifikues lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer për investimin e kryer nga babai i bashkëshortes në ndërtesën 5 katëshe në*

Tiranë, ku pjesa e tij takuese është 40% e garazhit dhe 100% të dy apartamenteve me sip. 104.6 m²/secili.

- *Shpjegimet e subjektit të vlerësimit gjatë seancës dëgjimore, u mbajtën në konsideratë nga Trupa e Vlerësimit.*
- *Nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar lidhur me këto pasuri, Trupa e Vlerësimit arrin në konkluzionin se ndodhemi në kushtet e nenit 32, pika 1.1, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.*

7. Apartament banimi me sipërfaqe takuese 80.76 m² dhe sip. shkalle takuese 7.2 m², nr. pasurie ***, Zk.***, në Golem, Kavajë, i krijuar nga bashkimi i dy garsonierave dhe legalizuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Zonat e Stimuluara, me Vendimin nr. 1027, datë 07.12.2022. Vlera 44, 000 euro. Apartamenti është bashkim i dy garsonierave të blera nga:

a) Shtetasit B.Th dhe S. Th, nr. prone ***, indeksi i hartës ***, Zona Kadastrale nr.***, vol.1, fq.1, e regjistruar në ZVRPP Tiranë, sip. 43.57 m², adresa Golem, Kavajë. Blerë në datë 25.08.2020, në shumën 25, 000 euro, referuar Aktit Noterial nr. rep 1579, nr. kol 521, datë 25.08.2020.

Burimi i krijimit: Të ardhurat për këtë pasuri janë kursimet në vite nga pagat e pjesëtareve të familjes, si dhe nga puna e dytë, mësimdhënia.

b) Shtetasi G. V, nr. prone ***. Indeksi i hartës ***, Zk.***, vol.1, fq.1, e regjistruar në ZVRPP Tiranë, me sip. 39.57 m², në Golem, Kavajë. Blerë në shumën 19, 000 euro, referuar kontratës me nr. 1895, rep, nr. 639 kol, datë 06.10.2020.

Burimi i krijimit: Të ardhurat për këtë pasuri janë siguruar nga mësimdhënia, si dhe ndihmë familjare tek prindi, nga djali Eros Shala e kursime të tjera familjare.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Dokumentacioni tekniko ligjor, si dhe vendimi për legalizimin e ndërtimit pa leje, nr.4266, prot., datë 14.12.2022, nga Drejtoria Vendore Zonat e Stimuluara.
- Vendim nr. 1027, datë 07.12.2022, nga Drejtoria Vendore Zonat e Stimuluara, për miratimin e kalimit të pronësisë mbi truallin funksional të lirë brenda zonës së stimuluar dhe legalizimin e ndërtimit pa leje, ku është vendosur:

Kalimi i pronësisë, mbi pasurinë truall funksional, me nr.64/22, në zonën e stimuluar “Olimpik” sh.p.k, Zk. ***, me sipërfaqe takuese sipas genplanit 32.53 m² dhe vlerë 57, 676 lekë, shlyer nga subjekti i interesuar brenda 1 dite nga data e njoftimit.

Legalizimi i njësisë ndërtimore, përfshirë në procedurat e legalizimit nëpërmjet aplikimit nr.245, prot., datë 25.03.2015, me numër Unik (INDEX), me këto të dhëna: Numër pasurie ***, Zk.***, sipërfaqe bazë 1.070.2 m², sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit të objektit 4.513, 24 m², sipërfaqe takuese (banimi) 80.76 m², sipërfaqe shkalle takuese 7.2 m², me 4 kate mbi tokë, në adresën Zona e Stimuluar “Olimpik” sh.p.k, Golem, Kavajë.

- Njoftim mbi detyrimet financiare për objektin, me vendndodhje në zonat e stimuluar "Olimpik" sh.p.k, nr. 4047, prot., datë 30.11.2022. Shuma për t'u paguar nga Xhavit Shala, 57, 676 lekë.
- Faturë pagese e shumës 57, 576 lekë, nga Xhavit Shala, në datë 30.11.2022, në Credins Bank, "Pagesa e parcelës ndërtimore në Zonat e Stimuluara".
- Deklaratë Noteriale nr.1579, rep, nr. 521 kol, datë 25.08.2020, nga B. Th, S. Th dhe Xhavit Shala, ku nga B. Th dhe S. Th deklarohet se kanë investuar për një apartament në katin e dytë, me sip. të ndërtuar 43.57 m², në godinë banimi Zk.*** Kavajë, që është në proces legalizimi, gjë e cila vërtetohet edhe nga formulari i kërkesave për legalizim nr. 337 prot., datë 02.04.2015. Këtë pasuri ja kanë shitur z. Xhavit Shala, në shumën 25, 000 euro, shumë e cila kalon e plotë sot në llogarinë bankare të z. B. Th. Meqenëse kjo pronë është në proces legalizimi, me vullnetin e plotë deklarojnë se janë plotësisht dakord që procedurat e legalizimit të këtij apartamenti të vazhdojnë dhe hipotekimi të bëhet në emër të z. Xhavit Shala, i cili do të ndjekë të gjitha procedurat e legalizimit dhe hipotekimit. Bashkëlidhur faturë transferte nga Credins Bank e shumës 25, 000 euro në datë 25.08.2020, nga llogaria e Xhavit Shala, në favor të S.Th ose B. Th, sipas Deklaratës nr. 1579/521, datë 25.08.2020.
- Deklaratë Noteriale nr. 1895, rep. nr. 639, kol., datë 06.10.2020, nga G. V dhe Xhavit Shala, ku nga G. V deklarohet se ka investuar për një apartament në katin e dytë, me sip. të ndërtuar 39.57 m², në godinë banimi Zk.***, Kavajë, që është në proces legalizimi, gjë e cila vërtetohet edhe nga formulari i vet deklarimit për legalizim nr.337, prot, datë 02.04.2015. Këtë pasuri ja ka shitur z. Xhavit Shala në shumën 19, 000 euro, shumë e cila do të kalojë në llogarinë bankare të z. G. V, në këtë mënyrë: Kësti i parë në shumën 10, 000 euro ekuivalent me 1, 239, 800 lekë do të paguhet pas nënshkrimit të kësaj deklarate dhe kësti i dytë 9, 000 euro do të paguhet deri në datë 31.12.2021. Meqenëse kjo pronë është në proces legalizimi, me vullnetin e plotë deklarojnë se janë plotësisht dakord që procedurat e legalizimit të këtij apartamenti të vazhdojnë dhe hipotekimi të bëhet në emër të z. Xhavit Shala, i cili do të ndjekë të gjitha procedurat e legalizimit dhe hipotekimit. Bashkëlidhur faturë transferte nga Credins Bank, e shumës 1, 239, 800 lekë, në datë 06.10.2020, nga llogaria e Xhavit Shala, sipas Kontratës nr. 1895/639, datë 06.10.2020.
- Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, në emër të Xhavit Shala, datë 14.02.2023.

Procedura e vlerësimit:

Credins Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 12.10.2023, konfirmon:

- ✓ Transferimin e shumës 1, 239, 800 lekë, në datë 06.10.2020, për G. V, sipas kontratës nr. 1895/639, datë 06.10.2020.
- ✓ Kreditimin e shumës 420, 000 lekë, në datë 26.08.2021 dhe transferimi i shumës 485, 200 lekë për G. V, sipas kontratës nr. 1895/639.
- ✓ Pagesën e shumës 57, 676 lekë, në datë 30.11.2022, pagesë parcele ndërtimore në zonat e stimuluar.
- ✓ Transferimin e shumës 700, 000 lekë, në datë 05.10.2020, nga llogaria e Eros Shala.

Nga llogaria në euro, konfirmohet:

- ✓ Transferimi i shumës 25, 000 euro, në datë 20.08.2020 për S. Th ose B. Th, sipas Kontratës nr. rep. 1579, nr. kol. 521, datë 25.08.2020.

- ✓ Arkëtimi i shumës 5, 000 euro në datë 05.05.2021 dhe transferimi i saj për G. V, po në datë 05.05.2021, sipas kontratës nr. rep. 1895, nr. kol. 639.

Nga llogaria e depozitës në monedhën lekë, konfirmohet tërheqje e depozitës 1, 230, 000 lekë, në datë 20.08.2020.

ASHK, Drejtoria e Përgjithshme, me shkresën nr.***, prot., datë 23.10.2023, konfirmon se Xhavit Shala, rezulton i pajisur me vendim legalizimi nr. 706964, datë 07.12.2022, banim, nga Zonat e Stimuluara.

ASHK, Drejtoria Vendore e Zonave të Stimuluara, me shkresën nr. ***, prot., datë 26.10.2023, konfirmon se Xhavit Shala është përfitues i së drejtës së pronësisë për objektin me vendndodhje në Qerret, Kavajë, nëpërmjet praktikës nr. 671, prot, datë 20.04.2015; nr. 27, prot., datë 24.02.2015 dhe nr. 337, prot., datë 02.04.2015. Bashkëlidhur:

- Praktika nr. 671, prot., datë 20.04.2015: Kërkesë për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar, “Olimpik sh.p.k” nga Gëzim Veliu, në datë 20.04.2015, banesë me sip. 39.57 m².
- Praktika nr. 27, prot., datë 24.02.2015: Kërkesë për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar, nga G. V, në datë 24.02.2015, godinë banimi 3+1 kat, me sip. 800 m², sip. e bazës 1.050 m² dhe sip. të përgjithshme e njësisë së ndërtuar 1.050 m², ndodhur në zonën “Olimpik”.
- Praktika nr. 337, prot., datë 02.04.2015: Kërkesë për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar, “Olimpik sh.p.k” nga B. Th, në datë 02.04.2015, banesë me sip. 43.57 m².
- Deklaratë Noteriale nr. 567, rep, nr. 259, kol., datë 01.04.2015, nga G.V dhe B. Th, ku deklarohet se G. V, bazuar në një marrëveshje me interes të përbashkët lidhur në datë 17.02.2006, ndërmjet firmës “Olimpik sh.p.k”, ka kontribuar me shpenzimet e tij dhe ka ndërtuar një kompleks turistik në zonën turistike Golem Kavajë. Ndërtimi i bërë nga shoqëria “Olimpik sh.p.k”, mbi një shesh me sip. 4.475 m² dhe sip. ndërtimi 4.400 m², është ndërtuar mbi një truall që është objekt i qirasë e vitit 2005, me palë qiradhënëse Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të RSH dhe qiramarrës firma “Olimpik sh.p.k”, me afat 99 vjet, me pronar de jure të pasurisë G. V.

G. V në bazë të një marrëveshje me interes të përbashkët me firmën Olimpik ka realizuar një investim me shpenzimet e veta të përcaktuar si ndërtim me sip. 1.012 m² truall dhe 4.160 m², ndërtim me përmasa 52 m² gjatësi dhe 20 m² gjerësi. Në këto kushte B. Th ka deklaruar se ka marrë në posedim nga investitori dhe poseduesi G. V një apartament me sip. ndërtimi 43.57 m², kundrejt vlerës 28, 000 euro. Fakti se këmbimi i mësipërm nuk është shitje ka të bëjë me mënyrën e këtij këmbimi të parakohshëm, deri sa G. V të plotësojë dokumentacionin ligjor dhe regjistrimin e kësaj prone në ZVRPP Kavajë dhe atëherë do të bëhet dhe kontrata e shitblerjes. Bashkëlidhur Aktmarrëveshje e datës 17.02.2006, midis shoqërisë “Olimpik sh.p.k” dhe G. V.

- Deklaratë Noteriale nr. 643, rep, nr. 304 kol, datë 10.04.2015 nga G. V, i cili deklaroi se bazuar në një marrëveshje me interes të përbashkët lidhur në datë 17.02.2006, ndërmjet firmës “Olimpik sh.p.k”, ka kontribuar me shpenzimet e tij dhe ka ndërtuar një kompleks turistik në zonën turistike Golem Kavajë. Ndërtimi i bërë nga shoqëria “Olimpik sh.p.k”, mbi një shesh me sip. 4.475 m² dhe sip. ndërtimi 4.400 m², është ndërtuar mbi një truall që

është objekt i qirasë, i vitit 2005, me palë qiradhënëse Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të RSH dhe qiramarrës firma “Olimpik sh.p.k”, me afat 99 vjet, me pronar de jure të pasurisë G. V.

G. V në bazë të një marrëveshje me interes të përbashkët me firmën Olimpik ka realizuar një investim me shpenzimet e veta, të përcaktuar si ndërtim me sip. 1.012 m² truall dhe 4.160 m² ndërtim, me përmasa 52 m² gjatësi dhe 20 m² gjerësi dhe nga ky ndërtim ka mbajtur në posedim një apartament me sip. ndërtimi 39.57 m².

- Kërkesë drejtuar ASHK nga Xhavit Shala nr. 3955 prot, datë 21.11.2022, për depozitimin e Deklaratës Noteriale nr. 1895 rep, nr. 639 kol, datë 06.10.2020, nga G. V dhe Xhavit Shala, ku nga G. V deklarohet se ka investuar për një apartament në katin e dytë, me sip. të ndërtuar 39.57 m², në godinë banimi Zk.*** Kavajë, që është në proces legalizimi, gjë e cila vërtetohet edhe nga formulari i vet deklarimit për legalizim nr.337, prot, datë 02.04.2015. Këtë pasuri ja ka shitur z. Xhavit Shala në shumën 19,000 euro, shumë e cila do të kalojë në llogarinë bankare të z. G. V në këtë mënyrë: Kësti i parë në shumën 10,000 euro ekuivalent me 1,239,800 lekë do të paguhet pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe kësti i dytë 9,000 euro do të paguhet deri në datë 31.12.2021. Meqenëse kjo pronë është në proces legalizimi, me vullnetin e plotë deklarojnë se janë plotësisht dakord që procedurat e legalizimit të këtij apartamenti të vazhdojnë dhe hipotekimi të bëhet në emër të z. Xhavit Shala, i cili do të ndjekë të gjitha procedurat e legalizimit dhe hipotekimit.

Bashkëlidhur kërkesa për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar nr. 671, prot., datë 02.04.2015, nga G. V, në datë 20.04.2015, banesë me sip. 39.57 m². Deklarata Noteriale nr. 643 rep, nr. 304 kol, datë 10.04.2015 (pasqyruar më sipër).

Bashkëlidhur faturë transferte nga Credins Bank, e shumës 1,239,800 lekë, në datë 06.10.2020, nga llogaria e Xhavit Shala, sipas Kontratës nr. 1895/639, datë 06.10.2020.

- Kërkesë drejtuar ASHK nga Xhavit Shala, nr. 3954, prot., datë 21.11.2022. për depozitimin e Deklaratës Noteriale nr. 1579, rep., nr. 521, kol, datë 25.08.2020, nga B. Th, S. Th dhe Xhavit Shala, ku nga B. Th dhe S. Th deklarohet se kanë investuar për një apartament në katin e dytë, me sip. të ndërtuar 43.57 m², në godinë banimi Zk.*** Kavajë, që është në proces legalizimi, gjë e cila vërtetohet edhe nga formulari i kërkesave për legalizim nr.337, prot, datë 02.04.2015. Këtë pasuri ja kanë shitur z. Xhavit Shala, në shumën 25,000 euro, shumë e cila kalon e plotë sot në llogarinë bankare të z. B. Th. Meqenëse kjo pronë është në proces legalizimi, me vullnetin e plotë deklarojnë se janë plotësisht dakord që procedurat e legalizimit të këtij apartamenti të vazhdojnë dhe hipotekimi të bëhet në emër të z. Xhavit Shala, i cili do të ndjekë të gjitha procedurat e legalizimit dhe hipotekimit. Bashkëlidhur: Praktika nr. 337, prot., datë 02.04.2015: Kërkesë për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar, “Olimpik sh.p.k” nga B. Th, në datë 02.04.2015, banesë me sip. 43.57 m². Faturë transferte nga Credins Bank, e shumës 25,000 euro, në datë 25.08.2020, nga llogaria e Xhavit Shala, në favor të S.Th ose B. Th sipas Deklaratës nr. 1579/521, datë 25.08.2020. Deklaratë Noteriale nr. 567, rep, nr. 259 kol, datë 01.04.2015, nga G. V dhe B. Th (pasqyruar më sipër). Akt Evidentimi nr. 47, datë 01.10.2021, për gjendjen ndërtimore në terren të ndërtimit pa leje, nga ASHK, Drejtoria Vendore Zonat e Stimuluara.
- Njoftim nga ASHK nr. 4047, prot., datë 30.11.2022, për detyrimet financiare për objektin me vendndodhje në zonën e stimuluar “Olimpik” sh.p.k, për Xhavit Shala. Vlera e truallit të njësisë së ndërtuar 57,676 lekë dhe vlera e përditësimit të pronës 976 lekë. Faturë pagese në Credins Bank nga Xhavit Shala, në datë 30.11.2022, e shumave 976 lekë + 57,676 lekë.

- Vendim nr. 1027, datë 07.12.2022, nga ASHK, Drejtoria Vendore Zonat e Stimuluara për miratimin e kalimit të pronësisë mbi truallin funksional/ të lirë brenda zonës së stimuluar/dhe legalizimin e ndërtimit pa leje, bazuar në kërkesat nr. 671, datë 20.04.2015, nr.27, datë 24.02.2015 dhe 337, datë 02.04.2015, ku është vendosur:
- Kalimi i pronësisë mbi pasurinë truall funksional, me numër 64/22, në zonën e stimuluar “Olimpik” sh.p.k, Zk.***, me sip. takuese sipas genplanit 32.53 m² dhe vlerë 57, 676 lekë, shlyer nga subjekti i interesuar brenda 1 dite nga data e njoftimit.
- Legalizimi i njësisë ndërtimore, përfshirë në procedurat e legalizimit nëpërmjet aplikimit 245 prot., datë 25.03.2015, me këto të dhëna: numër pasurie ***, Zk. ***, me sip. baze 1.070.2 m², sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit të objektit 4.513, 24 m². Sipërfaqe ndërtimi takuese (banimi) 80.76 m², sipërfaqe shkalle 7.2 m². Numër katesh 4 kate mbi tokë, në adresën Zona e Stimuluar “Olimpik” sh.p.k, Golem, Kavajë.

ASHK, Drejtoria Vendore Kavajë, me shkresën nr.*** prot., datë 30.10.2023, konfirmon se në emër të Xhavit Shala figuron e regjistruar pasuria me nr. ***, Zk.***, Golem, vol. 47, fq.61, fituar me leje legalizimi. Bashkëlidhur: Kartela e pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 80.76 m², nr. pasurie ***, në emër të Xhavit Shala. (Sipas kartelës së pasurisë adresa e Xhavit Shala është shënuar; rr. “****”, pallati 16, shk. 2/8, Tiranë) si dhe dokumentacioni i përfitimit të pasurisë (trajtuar më sipër).

Me e-mailin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se për blerjen e apartamentit të B. Th, të ardhurat gjithsej 25, 000 euro janë nga kursimet në vite nga pagat e pjesëtareve të familjes, si dhe nga puna e dytë e tij, mësimdhënia, konkretisht: Janë tërhequr nga depozita pa afat 1, 230, 000 lekë dhe janë konvertuar në 9, 930 euro. Janë pakësuar nga gjendja cash 1, 150, 000 lekë dhe janë konvertuar në rreth 9, 300 euro.

Diferenca e nevojshme prej 5, 770 euro është siguruar nga të ardhurat nga paga e pjesëtareve të familjes për periudhën janar - korrik 2020, pasi të ardhurat mujore të familjes nga pagat janë rreth 450, 000 lekë në muaj.

Për apartamentin e blerë nga G. V: Kësti i parë 1, 239, 800 lekë (10 mijë euro), paguar më 06.10.2020, është siguruar: 700, 000 lekë janë xhiruar nga djali Eros Shala + 275, 554 lekë të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin “Luarasi” + 250, 000 lekë të ardhura nga paga e pjesëtareve të familjes.

Kësti i dytë, 5, 000 euro, paguar më 05.05.2021, është siguruar nga të ardhurat nga paga e pjesëtareve të familjes për periudhën janar - prill 2021.

Kësti i tretë, 4 mijë euro (485, 200 lekë), paguar më 04.10.2021 është siguruar nga paga e pjesëtareve të familjes për periudhën maj - shtator 2021, si dhe të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin “Luarasi”.

Ka deklaruar se të dy apartamentet janë blerë të mobiluara dhe nuk ka investuar nga ana e tij për këtë qëllim.

Në lidhje me adresën e tij të banimit, të shënuar në kartelën e pasurisë nr. ***; Zk. ***, Golem, vol. 47, fq.61; rr. “****”, Pallati 16, Shkalla ***, Tiranë”, ka sqaruar se kjo është adresa që është regjistruar në Gjendjen Civile dhe figuron ende zyrtarisht si banor në Njësinë Administrative nr. 9, Tiranë. Kjo adresë i përket apartamentit të banimit, me sipërfaqe ndërtimi 114 m², me adresë zyrtare Njësia Administrative nr. 9, rruga “****”, pallati 16, shkalla 1, ap.8, kati 4,

ndërtuar nga Enti Kombëtar i Banesave dhe është marrë me kredi nga ata, në vitin 1999, me afat pagese për 25 vjet, i deklaruar në formularin e deklaramit të pasurisë.

Paraqiti:

- Nxjerrje llogarie në monedhën lekë nga Credins Bank, në emër të subjektit për periudhën janar 2019 - mars 2023 dhe prill 2023 - nëntor 2023.
- Nxjerrje llogarie në monedhën euro nga Credins Bank, në emër të subjektit, për periudhën janar 2019 - maj 2021.
- Nxjerrje llogarie në monedhën lekë nga Credins Bank, në emër të subjektit, ku konfirmohet depozita e çelur në datë 25.02.2019, në shumën 1, 000, 000 lekë dhe tërheqja e saj në datë 20.08.2020, në shumën 1, 230, 000 lekë.
- Kopje e librezës për kthim kredie nr. 727, nga Enti i Banesave, ku është shënuar adresa, “****”, sek 16, ap.8.
- Kërkim nga regjistri i gjendjes civile, ku është konfirmuar adresa e banimit për Xhavit Shala; Njësia Bashkiake nr. 9, rr. “****”, pallati 16, shk.2/8.
- Kërkim i thjeshtë në sistem, në emër të Xhavit Shala, ku konfirmohet adresa e qendrës së votimit sipas KQZ, në Njësinë Administrative nr. 9.
- Foto të mobilimit të brendshëm të apartamentit. (gjithsej 7 copë).

Në **procesverbalin e datës 24.11.2023**, subjekti ka sqaruar lidhur me mobilimin e apartamenteve të blera në Golem, ato janë blerë të mobiluara. Ky fakt nuk është shprehur në kontratat e shitblerjes, për arsye se shitësit i kanë thënë se nëse nuk të duhen, mund ti hedhësh pasi janë të përdorura me vite të tëra.

Lidhur me pasuritë e sipërcituara, subjekti i vlerësimit u pyet gjatë seancës dëgjimore të datës 03.10.2024, nga anëtarja e Trupës së Vlerësimit, konkretisht: *“...Gjithashtu dy garsonierat në Golem, zonë e stimuluar, i keni blerë me dijeninë tuaj si pasuri ndërtim pa leje në vitin 2020, legalizuar nga ju në vitin 2022. Nisur nga këto fakte si dhe duke qenë se jeni një funksionar i lartë i Policisë së Shtetit, jurist, akademik dhe ekspert i sigurisë, duhet të mbështesni dhe siguron ligjin dhe jo të vendoseni në një pozicion konflikti në zbatim të tij, duke mos cënuar besimin në publik. Komenti dhe qëndrimi juaj në lidhje me këtë çështje...”*

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar se: *“...Lidhur me rastin në Golem, e gjithë zona bregdetare ka qenë zone informale, dhe unë duke qenë se po vija drejt moshës së pensionit, doja që të gjeja një mundësi të kthehesha afër vendit tim ku kam lindur. Aty kam biseduar me personat të cilët më thane që nuk është legalizuar, por ai ishte problem i tyre, nuk ishte problemi im. Ata kishin bërë kërkesa herët për legalizimin dhe ishin në proces legalizimi. Unë nuk e quaj që kam nxitur paligjshmërinë në konceptim tim, pasi ajo ishte një procedure që kishte filluar. Nëse nuk do kishte filluar ishte problem tjetërm që unë do rrezikoja...”*

Trupa e Vlerësimit me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për mbulimin e shpenzimeve në vlerën totale prej 44, 000 euro, kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi (Aneksi 1).

Konkluzion:

Bazuar në deklaramin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- *Apartamenti me sip. 80.76 m², në Golem, Kavajë, në zotërim 100% të subjektit është përfutur në vitin 2020 nga blerja e dy garsonierave në shumat respektive 25, 000 euro dhe 19, 000 euro (total 44, 000 euro) dhe regjistruar me Leje Legalizimi të vitit 2022. Burimi i krijimit të apartamenteve janë të ardhurat familjare ndër vite.*
 - *Nuk ka kryer shpenzime mobilimi, ka sqaruar se apartamentet janë blerë të mobiluara.*
 - *Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues, lidhur me apartamentin me sip. 80.76 m², në Golem, Kavajë dhe burimin financiar të përdorur për blerjen e tij në vitin 2020.*
 - *Konfirmohet nga ASHK pronësia e subjektit në këtë apartament.*
 - *Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë pasur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme me qëllim shpenzimet e kryera në periudhat respektive për blerjen e pasurisë.*
 - *Shpjegimet e subjektit të vlerësimit gjatë seancës dëgjimore, u mbajtën në konsideratë nga Trupa e Vlerësimit.*
8. Llogari bankare në Tirana Bank, me gjendje në datë 14.02.2023, shuma 73, 362 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga si punonjës policie. Zotëron 100%.

Procedura e vlerësimit:

Tirana Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 20.09.2023, konfirmon llogari page në emër të Xhavit Shala, me balancë në datë 13.02.2023, shumën 73, 362 lekë dhe në datë 17.02.2023, në shumën 43, 710 lekë. Konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën dhjetor 2010 - janar 2023.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se *nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.*

9. Llogari bankare nr. 000004***69, në Credins Bank, me gjendje në datë 14.02.2022 në shumën 949, 836 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin Luarasi. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës :

- Nxjertje llogarie nga Credins Bank, në emër të Xhavit Shala, datë 14.02.2023, ku konfirmohet balanca e llogarisë në datë 14.02.2023, në shumën 949, 836 lekë.

Procedura e vlerësimit:

Credins Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 12.10.2023, konfirmon llogari page në emër të Xhavit Shala, me balancë në datë 17.02.2023, shumën 948, 536 lekë.

Konfirmohet kreditimi i pagës nga Kolegji Universitar Luarasi, për periudhën prill 2018 - mars 2022. Nga lëvizja e llogarisë rezulton hapje depozite në datë 25.02.2019, në shumën 1, 000, 000 lekë dhe në datë 29.10.2019, në shumën 500, 000 lekë. Tërhequr në datë 20.08.2020, në shumën 1, 230, 000 lekë, me shënimin “tërheqje për konvertim”.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se *nuk lindin dyshime*

apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

10. Llogari bankare nr. 000006***95, në euro në Credins Bank, me gjendje në datë 11.04.2018 në shumën 66 euro. Burimi i krijimit: Të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin Evropian të Tiranës për vitet 2015 - 2016. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, në emër të Xhavit Shala, datë 14.02.2023, ku konfirmohet balanca e llogarisë në 31.03.2018, në shumën 66 euro dhe në datë 14.02.2023 në shumën 41 euro.

Procedura e vlerësimit:

Credins Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 12.10.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në monedhën euro, në emër të Xhavit Shala, me balancë në datë 17.02.2023, në shumën 41 euro.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se ***nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.***

11. Depozitë bankare nr. 00001***84, në Credins Bank, me gjendje në datë 14.02.2022, në shumën 22, 141 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin Luarasi. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, në emër të Xhavit Shala, datë 14.02.2023, ku konfirmohet balanca e llogarisë në datë 14.02.2023, në shumën 22, 141 lekë.

Procedura e vlerësimit:

Credins Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 12.10.2023, konfirmon depozitë në emër të Xhavit Shala, me balancë në datë 17.02.2023 shumën 22, 141 lekë. Konfirmohet se është llogaria e depozitës së hapur në datë 25.02.2019, në shumën 1, 000, 000 lekë, tërhequr shuma 221, 364 lekë, në datë 30.04.2019: shtuar 500, 000 lekë, në datë 29.10.2019 dhe tërhequr nga depozita në datë 20.08.2020, në shumën 1, 230, 000 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se ***nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.***

12. Llogari bankare nr. 401***78, në BKT, me gjendje në datë 10.04.2018, në shumën 211 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin Beder, për vitet 2015 - 2016. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga BKT, në emër të Xhavit Shala, datë 14.02.2023, ku konfirmohet balanca e llogarisë në datë 15.04.2018, në shumën 211 lekë dhe në datë 28.05.2018, në shumën 0 lekë.

Procedura e vlerësimit:

BKT, me shkresën nr. ***, prot., datë 19.09.2023, konfirmon llogari në emër të Xhavit Shala për periudhën maj 2014 - maj 2018. Gjendja e llogarisë në datë 28.03.2018 në shumën 211 lekë. Mbyllur llogaria në datë 28.05.2018.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se ***nuk linden dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.***

13. Llogari bankare në Raiffeisen Bank, me gjendje në datë 14.02.2023, në shumën 24, 847 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, në emër të Xhavit Shala, datë 14.02.2023, ku konfirmohet balanca e llogarisë në datë 31.12.2022, në shumën 24, 847 lekë. Konfirmohen të ardhurat nga mësimdhënia.

Procedura e vlerësimit:

Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 18.09.2023, konfirmon llogari page në emër të Xhavit Shala, me balancë në datë 17.02.2023, në shumën 24, 847 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se ***nuk linden dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.***

14. Llogari bankare nr. 15011***9826, në Raiffeisen Bank, Prishtinë - Kosovë, me gjendje në datë 14.02.2023, në shumën 0 euro. Burimi i krijimit: Të ardhura nga mësimdhënia në kolegjin Universitar ISPE Prishtinë, Kosovë.

Procedura e vlerësimit:

Me e-mailin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se në bazë të një kontrate të nënshkruar me ISPE Prishtinë, ka dhënë mësim atje për rreth një vit. Gjendja e llogarisë në datë 21.09.2016 ka qenë rreth 1, 489 euro dhe në vitin 2018 ajo është boshatisur. Nuk ka arritur të marrë vërtetim nga Raiffeisen Bank, Prishtinë, Kosovë.

Subjekti ka dorëzuar vërtetim nr. 618/19, prot., datë 04.12.2019, nga Kolegji ISPE, ku konfirmohen marrëdhëniet e punës për Xhavit Shala, për periudhën 08.01.2016 - 30.09.2017. Bashkëlidhur Kontrata e Punës datë 11.01.2016. Paga bruto për një ligjëratë do jetë 50 euro.

Me procesverbalin e datës 24.11.2023, subjekti ka deklaruar se i është drejtuar me një kërkesë me e-mail Raiffeisen Bank, Prishtinë, Kosovë, për ti dërguar një statement bankar të llogarisë,

por ata i janë përgjigjur se duhet të shkojë vetë apo të autorizojë dikë me prokurë. Në këto kushte, më datë 20.11.2023, është paraqitur në Raiffeisen Bank, Prishtinë, Kosovë. Fillimisht i thanë se nuk ka numër llogarie, pasi më 1 mars 2023, për mospërdorim për disa vite të llogarisë e kishte mbyllur automatikisht sistemi, por me një bilanc pozitiv 424, 19 euro.

Kjo shumë, për të cilën ai nuk ishte në dijeni, ishte kredituar nga institucioni, ku jepte mësim pas rakordimeve që ata kishin bërë për pagesat në raport me të. Në këto kushte gjendja e llogarisë në Raiffeisen Bank, Prishtinë, Kosovë, më datë 17.02.2023, ka qenë 424,19 euro, ndërsa në datë 01.03.2023 është zero euro, pasi 424, 19 euro, për shkak të mospërdorimit për një kohë të gjatë të llogarisë, kishin kaluar për llogari të bankës. Bankës ju desh të riaktivizonte llogarinë e subjektit dhe ti kreditonte po atë ditë shumën 424, 19 Euro. Pas këtyre veprimeve u bë mbyllja zyrtarisht për këtë numër llogarie. **Paraqiti:**

- Korrespondencë e-mail e datës 17.11.2023 nga Xhavit Shala, drejtuar Raiffeisen Bank Kosovë, si dhe përgjigjen nga Raiffeisen Bank Kosovë në datë 17.11.2023.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank Kosovë, datë 20.11.2023 në emër të Xhavit Shala. Konfirmohet gjendja e llogarisë në datë 31.01.2020, në shumën 498 euro. Nuk ka lëvizje në llogari deri në datë 01.03.2023, ku është bërë transferimi i shumës 424, 19 euro dhe është bërë mbyllja online e llogarisë. Riaktivizim i llogarisë në datë 20.11.2023, ku është kredituar shuma 424, 19 euro, datë në të cilën është bërë tërheqja e shumës 424, 19 euro dhe mbyllja e llogarisë.
- Formular për mbyllje llogarie në Raiffeisen Bank Kosovë datë 20.11.2023 në emër të Xhavit Shala.

Konkluzion:

- *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.*
- *Gjendja e llogarisë në datë 17.02.2023, ka rezultuar në shumën 424 euro. Mbyllur llogaria në datë 20.11.2023.*
- *Konstatohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit.*

15. Gjendje cash (jashtë sistemit bankar) në datë 14.02.2023 në shumën 200, 000 lekë. Burimi i krijimit: Kursime familjare.

Procedura e vlerësimit:

Me e-mailin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se burimi i gjendjes cash të deklaruar janë kursimet nga paga e pjesëtareve të familjes. Të ardhurat mujore të familjes nga pagat janë rreth 450, 000 lekë në muaj dhe 200, 000 lekë janë kursimet e një muaji. Në deklarimin e pasurisë, secili pjesëtar ka deklaruar të ardhurat nga paga dhe kjo verifikohet lehtë.

Trupa e Vlerësimit me qëllim vlerësimin e mundësisë për kursimin e gjendjes cash në vlerën 200, 000 lekë në datë 14.02.2023, kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi (Aneksi 1).

Konkluzion:

- *Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë pasur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme me qëllim kursimin e vlerës prej 200, 000 lekë në datë 14.02.2023.*

Deklarimi i të ardhurave financiare ndër vite të subjektit të vlerësimit

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/b, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron të ardhurat nga paga, nga angazhime në veprimtari private dhe/ose publike, me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie të kryer brenda dhe jashtë vendit, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, licenca dhe patenta, që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër të subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur me të për periudhën nga momenti i fillimit të detyrës deri në datën e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë.

Sa më sipër subjekti i vlerësimit ka deklaruar:

- ❖ Të ardhura nga funksioni Drejtor i Qendrës Kërkimore Shkencore në Akademinë e Sigurisë për periudhën 13.06.2015 - 31.01.2023, në shumën 8, 557, 759 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i Shefit të Sektorit të Studimeve Prognostike në Drejtorinë e Studimeve Strategjike në DPPP, për periudhën 19.05.2014 - 14.06.2015, në shumën 1, 094, 106 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i specialistit koordinator në Sektorin e Botimeve, në Drejtorinë e Studimeve Strategjike në DPPP, për periudhën 01.12.2013 - 18.05.2014 në shumën 495, 616 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i Shefit të Sektorit të Koordinimit të Projekteve në DPPP, për periudhën 16.11.2009 - 30.11.2013 në shumën 3, 856, 376 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i Shefit të Sektorit në Akademinë e Policisë Arben Zylyftari, më pas Qendra e Formimit Policor, për periudhën 28.01.2008 - 15.11.2009, në shumën 1, 447, 618 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i pedagogut në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari”, për periudhën 16.01.2007 - 31.12.2007, në shumën 753, 213 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i Drejtorit të Policisë së Qarkut Lezhë, për periudhën 27.08.2003 - 14.07.2004, në shumën 629, 019 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i Shefit të Seksionit dhe specialistit të përpunimit statistikor në Drejtorinë Qendrore të Policisë Kriminale për periudhën 01.05.2002 - 26.08.2003, në shumën 598, 736 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i Drejtorit të Policisë së Qarkut Fier, për periudhën 20.11.2000 - 08.04.2002, në shumën 601, 163 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i Drejtorit të policisë Kriminale në Ministrinë e Rendit Publik, për periudhën 23.06.1999 – 19.11.2000, në shumën 519, 239 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i Kryetarit të Degës së SHIK, Qarku Elbasan për periudhën 06.10.1997 - 22.06.1999, në shumën 615, 170 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i Kryetarit të Inspektorit të Degës së SHIK, Qarku Elbasan për periudhën 1992 - 23.03.1995 në shumën 302, 123 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i oficerit të drejtimit në Degën e të Huajve në Ministrinë e Brendshme për periudhën 16.01.1991 - 30.12.1991, referuar pagës së vitit 1992 në shumën 53, 125 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i punëtorit operativ në Degën e Brendshme Elbasan për periudhën 01.07.1984 - 15.01.1991, përlllogaritur me një pagë mesatare mujore 680 lekë në muaj, në shumën 53, 040 lekë.

- ❖ Të ardhura nga mësimdhënia si pedagog i jashtëm në programin Master në Kolegjin Universitar “Luarasi” për periudhën 01.06.2013 - 14.02.2023, në shumën 4, 450, 537 lekë.
- ❖ Të ardhura nga mësimdhënia si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, për periudhën 2014 - 14.02.2023, në shumën 346, 285 lekë.
- ❖ Të ardhura nga mësimdhënia si pedagog i jashtëm në programin Master në Kolegjin Universitar “Beder” për periudhën janar 2014 deri në prill 2018, në shumën 509, 200 lekë.
- ❖ Të ardhura nga mësimdhënia si pedagog i jashtëm në programin Master në Kolegjin Universitar “Akademia Profesionale e Biznesit” për periudhën mars 2017 - dhjetor 2018 në shumën 315, 806 lekë.
- ❖ Të ardhura si lektor në një trajnim të realizuar në Autoritetin e Mediave Audiovizive për vitin 2015, në shumën 212, 500 lekë.
- ❖ Të ardhura nga mësimdhënia si pedagog i jashtëm në programin Master në Universitetin Evropian të Tiranës për periudhën 2015 deri në 2016, në shumën 1, 200 euro.
- ❖ Të ardhura nga mësimdhënia si pedagog i jashtëm në Universitetin “Kristal” për periudhën 2008 - 2012, në shumën 1, 241, 286 lekë.
- ❖ Të ardhura nga mësimdhënia si pedagog i jashtëm në Akademinë e Forcave të Armatosura për vitin 2015, në shumën 25, 500 lekë.
- ❖ Të ardhura nga një pagesë e xhiruar nga Eurosig, për dëmtim makine TPL nr.956AA 2016, në shumën 60, 000 lekë.
- ❖ Të ardhura nga mësimdhënia si pedagog në programin “Master” në Kolegjin ISPE, me adresë: rr. “Ardian Krasniqi”, nr.9, Prishtinë, Kosovë për periudhën janar - 21 shtator 2016, në shumën 2, 088 euro.
- ❖ Të ardhura nga rimbursimi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, selia Tiranë, i pagesave të kryera nga ana ime për ekranin led dhe librin e konferencës “Depresioni dhe vetëvrasja në Shqipëri”, të organizuar në Akademinë e Sigurisë në Tiranë, në prill 2017, në shumën 161, 200 lekë.
- ❖ Të ardhura si autor i librit Ballkani, “gjeopolitika dhe siguria” vëllimi i I-rë dhe II-të, në shumën 120, 000 lekë.
- ❖ Të ardhura nga lëshimi me qira i apartamentit tek Njësia Administrative nr. 9, rruga “Blloku Sizmik”, pallati 16, shkalla 1, ap.8, kati 4, nga data 01.01.2018 deri 14.02.2023, në shumën 620, 000 lekë.
- ❖ Të ardhura nga shitja e librave “Antikanabisi apo kanabopolitike”, “Penalizimi i kanabopolitikës”, “Shqiptarët në Udhëkryq”, “Siguria Kombëtare dhe Sfidat e Integritit” dhe “Kosova mes intrigave”, në shumën 1, 100, 000 lekë.
- ❖ Të ardhura si drejtues i Projektit “Nxitja e interesit, kultivimi i përgjegjësisë së komunitetit dhe veprimtarisë së qytetarëve për rritjen e sigurisë në akset rrugore”, financuar nga Fondacioni “Soros” në periudhën janar - qershor 2006, në shumën 2.400\$.
- ❖ Të ardhura nga puna si këshilltar për sigurinë, në kompaninë “Sigma”, për periudhën shtator 2004 - korrik 2005, në shumën 770, 000 lekë.
- ❖ Të ardhura nga puna si drejtues i firmës “Shala” sh.p.k., për periudhën 1996 - 1997, në shumën 1, 100, 000 lekë.
- ❖ Të ardhura nga titulli ekzekutiv, Vendimi civil nr.2518, datë 09.10.1996, i Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me palë kreditore Shoqëria “Shala” e debitore “Ndërmarrja e Prodhimit të Materialeve të Ndërtimit Elbasan”, me objekt ekzekutimi “Respektim kontrate”, në shumën 1, 930, 000 lekë.
- ❖ Të ardhura 550, 000 lekë nga shitja e apartamentit në Elbasan në vitin 1995, të privatizuar nga shteti.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Vërtetim** nr. 86, prot., datë 23.04.2018, nga SHISH Elbasan. Konfirmohen të ardhurat nga paga për Xhavit Shala për vitet 1992 - 1999 në shumën totale 917, 293 lekë.
- **Vërtetim** i datës 06.02.2020 nga Ministria e Brendshme. Konfirmohen të ardhurat nga paga për Xhavit Shala, për periudhën 23.06.1999 deri në 20.11.2000, në shumën totale neto 592, 477 lekë.
- **Vërtetim** nr.4, prot., datë 11.04.2018, nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier. Konfirmohen të ardhurat nga paga për Xhavit Shala, për periudhën 28.01.2000 - 15.04.2002, në shumën neto 601, 163 lekë.
- **Vërtetim** për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare. Konfirmohen të ardhurat mbi të cilat është derdhur kontributi për periudhën 01.05.2002 - 27.08.2003, në shumën 598, 736 lekë dhe 15.01.2009 - 31.12.2011, në shumën neto 2, 002, 985 lekë.
- **Vërtetim** për bazën e Vlerësueshme dhe pagën neto mesatare. Konfirmohen të ardhurat mbi të cilat është derdhur kontributi për periudhën shtator 2003 - korrik 2004, në shumën neto 629, 019 lekë.
- **Vërtetim** nr. 5, prot., datë 13.04.2018, nga Akademia e Sigurisë. Konfirmohen të ardhurat për Xhavit Shala, për periudhën 16.01.2007 - 16.11.2009 dhe 15.06.2015 - 31.03.2018, në shumën neto 3, 737, 319 lekë.
- **Vërtetim** për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare. Konfirmohen të ardhurat mbi të cilat është derdhur kontributi për periudhën 01.01.2012 - 15.06.2015, në shumën neto 3, 318, 124 lekë.
- **Vërtetim** nr. XH-15, prot., datë 15.02.2023, nga Akademia e Sigurisë. Konfirmohen të ardhurat dhe shpërblimet për periudhën 01.04.2018 - 31.01.2023, në shumën neto 5, 499, 697 lekë.
- **Vërtetim** datë 13.04.2018, nga Kolegji Universitar Luarasi. Konfirmohen të ardhurat nga paga për Xhavit Shala, për periudhën 01.06.2013 - 13.04.2018, në shumën neto 1, 520, 865 lekë.
- **Vërtetim** nr.319/1, prot., datë 18.04.2018, nga Fakulteti i Shkencave Sociale. Konfirmohen të ardhurat për Xhavit Shala, pedagog i jashtëm, për vitin akademik 2014 – 2015; 2015 - 2016 dhe 2016 - 2017, në shumën neto 136, 580 lekë.
- **Vërtetim** nr.423/2, prot., datë 25.04.2018, nga Fakulteti i Shkencave Sociale. Konfirmohen të ardhurat për Xhavit Shala, pedagog i jashtëm, për vitin akademik 2016 - 2017, në shumën neto 48, 939 lekë.
- **Vërtetim** page nr. 44, prot., datë 17.04.2018, nga Kolegji Universitar Beder. Konfirmohen të ardhurat nga paga si lektor me kohë të pjesshme për Xhavit Shala, për periudhën janar 2014 - shkurt 2018, në shumën totale 317, 000 lekë.
- **Nxjerrje llogarie** nga Raiffeisen Bank, datë 30.01.2020, në emër të Xhavit Shala. Konfirmohen të ardhurat nga Organizata Botërore e Shëndetit, për organizimin e konferencës “Depresioni dhe vetëvraska në Tiranë”, në shumën 161, 200 lekë, në datë 07.06.2017.
- **Nxjerrje llogarie** nga Raiffeisen Bank, datë 30.01.2020, në emër të Xhavit Shala. Konfirmohen të ardhurat nga Fondacioni Hafiz Ali Korça, për periudhën 16.01.2018 - mars 2018.
- **Informacion përmbledhës** nga Union Bank, datë 30.01.2020. Konfirmohet llogari page në emër të Xhavit Shala, për periudhën 2008 - 2018.

- **Nxjerrje llogarie** nga Union Bank, datë 11.04.2018, ku konfirmohen të ardhurat për Xhavit Shala, për periudhën dhjetor 2008 - shkurt 2009, në shumën 187, 200 lekë.
- **Vërtetim** nga Raiffeisen Bank, nr. 407, prot., datë 17.04.2018, ku konfirmohen kreditimet në llogari për periudhën 2008 - 2018.
- **Kontratë qiraje** datë 25.12.2017, me qiradhënës Xhavit Shala dhe qiramarrës P. B, për apartament të ndodhur në Njësinë Administrative nr.9, rr. “***”, pallati 16, shkalla 1, ap.8, kati 4, me afat 3 vjeçar, duke filluar nga data 01.01.2018, kundrejt shumës 10, 000 lekë.
- **Kontratë** midis autorit Xhavit Shala dhe shtëpisë botuese Onufri, për botimin e librit “Siguria kombëtare dhe sfidat e integritetit”, datë 30.05.2003. Çmimi në kopertinë do jetë 1, 000 lekë, tirazhi i botimit të parë do jetë 1, 000 kopje. Kur ky tirazh është në përfundim, botuesi është i detyruar të shtypë tirazhin e dytë. Kohëzgjatja e kontratës do jetë 5 vjet dhe libri do dalë brenda muajit qershor 2003.
- **Kontratë** midis autorit Xhavit Shala dhe shtëpisë botuese Onufri, për botimi e librit “Shqiptarët në udhëkryq”, datë 27.05.2004. Çmimi në kopertinë do jetë 1, 000 lekë, tirazhi i botimit të parë do jetë 1, 000 kopje. Kur ky tirazh është në përfundim, botuesi është i detyruar të shtypë tirazhin e dytë. Kohëzgjatja e kontratës do jetë 5 vjet dhe libri do dalë brenda muajit qershor 2004.
- **Kontratë** midis autorit Xhavit Shala dhe shtëpisë botuese Onufri, për botimin e librit “Antikanabis apo kanabopolitikë”, datë 20.06.2005. Çmimi në kopertinë do jetë 1, 000 lekë, tirazhi i botimit të parë do jetë 1, 000 kopje. Kur ky tirazh është në përfundim, botuesi është i detyruar të shtypë tirazhin e dytë. Kohëzgjatja e kontratës do jetë 5 vjet dhe libri do dalë brenda muajit gusht 2005.
- **Kontratë** midis autorit Xhavit Shala dhe shtëpisë botuese Onufri, për botimi e librit “Penalizimi i Kanabopolitikës”, datë 13.06.2007. Çmimi në kopertinë do jetë 1, 000 lekë, tirazhi i botimit të parë do jetë 1, 000 kopje. Kur ky tirazh është në përfundim, botuesi është i detyruar të shtypë tirazhin e dytë. Kohëzgjatja e kontratës do jetë 5 vjet dhe libri do dalë brenda muajit gusht 2007.
- **Kontratë** midis autorit Xhavit Shala dhe shtëpisë botuese Onufri, për botimi e librit “Kosova mes intrigave”. Çmimi në kopertinë do jetë 600 lekë, tirazhi i botimit të parë do jetë 1, 000 kopje. Kur ky tirazh është në përfundim, botuesi është i detyruar të shtypë tirazhin e dytë. Kohëzgjatja e kontratës do jetë 5 vjet dhe libri do dalë brenda muajit gusht 2008.
- **Kontratë** midis autorit Xhavit Shala dhe shtëpisë botuese Onufri, për botimi e librit “Ballkani, Gjeopolitika dhe Siguria” në dy vëllime, datë 17.03.2009. Çmimi në kopertinë do jetë 1, 500 lekë, tirazhi i botimit të parë do jetë 500 kopje. Kur ky tirazh është në përfundim, botuesi është i detyruar të shtypë tirazhin e dytë. Kohëzgjatja e kontratës do jetë 5 vjet dhe libri do dalë brenda muajit gusht 2009.
- **Kontratë** midis autorit Xhavit Shala dhe shtëpisë botuese Onufri, për botimi e librit “Çështja shqiptare dhe siguria rajonale”, datë 10.05.2016. Çmimi në kopertinë do jetë 2, 000 lekë, tirazhi i botimit të parë do jetë 500 kopje. Kur ky tirazh është në përfundim, botuesi është i detyruar të shtypë tirazhin e dytë. Kohëzgjatja e kontratës do jetë 5 vjet dhe libri do dalë brenda muajit gusht 2016.
- **Vërtetim** i datës 10.02.2020, nga Fondacioni Shqipëria e Hapur. Konfirmohet se organizata “Qendra Shqiptare e Studimeve për Sigurinë Kombëtare” me drejtues z. Xhavit Shala, është mbështetur nga Fondacioni Shqipëria e Hapur për Shqipërinë në vitin 2006, në shumën 6, 570 usd.

- **Vërtetim** nr. 264, prot., datë 06.02.2020, nga Sigma InterAlbanian. Konfirmohen të ardhurat nga paga për shërbimin e konsulencës për Xhavit Shala gjatë periudhës shtator 2004 - korrik 2005, në shumën 770, 000 lekë.
- **Kërkesë** drejtuar BKT, nga Xhavit Shala, datë 10.04.2018, për marrje informacioni për veprimet bankare të kryera pranë BKT, nga firma “Shala” sh.p.k, në periudhën 1995 - 1997. Bashkëlidhur përgjigje e shkresës së datës 10.04.2018, nga BKT, me nr. 1729/1, prot., datë 18.04.2018, ku konfirmohet se nuk mund ti vërë në dispozicion informacionin e kërkuar, pasi në vitin 2000 është bërë privatizimi i kësaj banke dhe dokumentacioni me status ruajtje të përhershme është dorëzuar pranë Arkivit Qendror Shtetëror, ndërsa dokumentacioni me status ruajtje të përkohshme, për periudhën para vitit 2005, është asgjësuar për shkak të kalimit të afateve të parashikuara në ligj.
- **Vërtetim** nr. 9, datë 11.04.2018, nga Zyra Përmbartimore Elbasan. Konfirmohet se Vendimi civil nr. 2518, datë 09.10.1996, i Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me palë kreditore Shoqëria “Shala” e debitore Ndërmarrja Prodhimit të Materialeve të Ndërtimit, me objekt ekzekutimi “respektim kontrate”, është ekzekutuar dhe vendosur pushimi. Bashkëlidhur Vendimi nr. 2519, datë 09.10.1996.
- **Urdhër** nr. 12, datë 11.01.2013, nga DPPSH, për dhënie certifikate për shërbime të dalluara, me rastin e 100 vjetorit të krijimit të Policisë së Shtetit. Bashkëlidhur listpagesa për shpërblime. Xhavit Shala ka përfituar shumën 27, 000 lekë.
- **Urdhër** nr. 18, datë 10.01.2018, nga DPPSH, për dhënie “Certifikata e Karrierës”. Certifikata e Karrierës të shoqërohet me shpërblim financiar në vlerë 45, 000 lekë. Bashkëlidhur Certifikata.
- **Urdhër** nr. 1204, datë 07.12.2018, nga DPPSH, për dhënie shpërblimi për punë cilësore, për drejtuesin Xhavit Shala, në masën një pagë mujore.

Procedura e vlerësimit:

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli mbi të ardhurat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, si dhe ka kryer verifikime në institucionet përgjegjëse, të cilat kanë dërguar përgjigjet përkatëse konkretisht:

Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 18.09.2023, konfirmon të ardhurat nga paga, honorare dhe pjesëmarrja në konferenca të ndryshme për Xhavit Shala, për periudhën janar 2007 - dhjetor 2010 dhe tetor 2015 - maj 2022, në shumën totale 4, 667, 921 lekë.

BKT, me shkresën nr. ***, prot., datë 19.09.2023, konfirmon të ardhura nga Fondacioni Sema, për periudhën prill 2014 - janar 2016, në shumën totale 238, 360 lekë.

Tirana Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 20.09.2023, konfirmon kreditimin e pagës për Xhavit Shala, për periudhën dhjetor 2010 - janar 2023, në shumën totale 13, 226, 090 lekë.

Credins Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 12.10.2023, konfirmon të ardhurat nga paga për Xhavit Shala, nga Universiteti Luarasi, për periudhën qershor 2013 - dhjetor 2022, në shumën totale 4, 625, 978 lekë. Në llogarinë në euro konfirmohen të ardhurat nga UET, për periudhën mars 2015 - mars 2016, në shumën 1, 453 euro.

Union Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 04.10.2023, konfirmon të ardhura nga honorare për Xhavit Shala, për periudhën dhjetor 2008 - janar 2012, në shumën totale 569, 407 lekë.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), me shkresën nr. ***, prot., datë 19.09.2023, konfirmon kontributet e derdhura për Xhavit Shala, për periudhën dhjetor 2012 - korrik 2023, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Universiteti Luarasi, Fondacioni “Sema”, UET, Akademia e Sigurisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Akademia Professionale e Biznesit, Fondacioni “Hafiz Korca”.

ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. ***, prot., datë 22.09.2023, konfirmon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave, për periudhën 1994 – 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet juridike apo fizike, nuk mund të konfirmojnë periudhën e kontributeve apo paga, mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, Nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës.

Në procesverbalin e datës 08.11.2023, subjekti ka deklaruar se ka filluar marrëdhëniet e punës në korrik 1984 në sistemin e Ministrisë së Brendshme, Oficer në Degën e Punëve të Brendshme Elbasan. Në vitin 1991 ka ardhur oficer drejtimi në Ministrinë e Brendshme. Në 1992 - 1995 në Elbasan, si Kryetar Dege dhe SHISH. Është larguar në prill 1995 dhe deri në shtator 1997 ka punuar me firmën Shala. Është rikthyer në SHISH, në shtator - tetor 1997 deri në qershor 1999. Në qershor 1999 deri në korrik 2004 ka qenë në Policinë e Shtetit. Nga korrik 2004 - qershor 2007 ka punuar si Drejtor i Sigurimit të Kompanisë Sigma dhe më pas me projektin e qendrës Shqiptare të Studimit për Sigurinë Kombëtare “Soros”. Që nga muaji gusht - dhjetor 2007 ka qenë në listë pritje të Akademisë së Sigurisë (DPPSH) (ku është paguar me gjysmën e pagës) dhe prej asaj periudhe nuk ka pasur më shkëputje nga Akademia.

Me e-mailin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se të ardhurat si oficer drejtimi në Degën e të Huajve në Ministrinë e Brendshme, për periudhën 16.01.1991 - 31.12.1991, janë përlllogaritur duke marrë për bazë pagën referuese të vitit 1992. Dhe për vitin 1992 i është referuar Vërtetimit nr. 86, datë 23.04.2018, të Drejtorisë SHISH Elbasan. (pasqyruar më sipër).

Të ardhurat nga funksioni i punëtorit operativ në Degën e Brendshme Elbasan për periudhën 01.07.1984 deri në 15.01.1991, janë përlllogaritur me një pagë mesatare mujore 680 lekë në muaj, referuar dosjes personale. Bashkëlidhur Vendimi i Emërtesës së DPB Elbasan, nr. 17, datë 15.07.1988, ku përcaktohet se Xhavit Shalës i caktohet paga bazë 680 lekë.

Të ardhura nga mësimdhënia si pedagog në programin “Master” në Kolegjin ISPE, me adresë: rr. “Ardian Krasniqi”, nr. 9, Prishtinë, Kosovë për periudhën janar - 21 shtator 2016, janë 2, 088.9 euro.

Të ardhurat si autor i librave “Ballkani”, “Gjeopolitika dhe siguria” në dy vëllime, si dhe “Antikanabisi apo kanabopolitike”, “Penalizimi i kanabopolitikës”, “Shqiptarët në Udhëkryq”, “Siguria Kombëtare dhe Sfidat e Integritit” dhe “Kosova mes intrigave”, janë deklaruar gjithsej 1, 220, 000 lekë. Kjo është përlllogaritur mbi bazën e kontratave me “Onufrin”, si dhe vërtetimin e lëshuar prej tyre, datë 09.11.2023. Subjekti i vlerësimit ka përlllogaritur sipas viteve honorarët e përfituara si pjesë takuese nga shitja e librave, dhe është shprehur se nga takimi i zhvilluar me shtëpinë botuese, në kohën e nënshkrimit të kontratave, kjo e fundit do të shlyente të gjitha detyrimet tatimore. Nuk ka dijeni nëse ata i kanë paguar apo jo tatimet në burim, në rastin e shitjes së librave të tij.

Lidhur me të ardhurat si drejtues i projektit “Nxitja e interesit, kultivimi i përgjegjësisë së komunitetit dhe veprimtarisë së qytetarëve për rritjen e sigurisë në akset rrugore”, financiar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, në periudhën janar - qershor 2006, ka sqaruar

se mbështetja financiare për Qendrën Shqiptare të Studimeve për Sigurinë Kombëtare ishte 6, 570 dollarë. Pra këto të ardhura ishin për zbatimin nga organizata të projektit “Nxitja e interesit, kultivimi i përgjegjësisë së komunitetit dhe veprimtarisë së qytetarëve për rritjen e sigurisë në akset rrugore”. Ky financim është kredituar për QSHSSK në Raiffeisen Bank. Veprimet janë kryer në godinën e Raiffeisen Bank, pranë ish Lidhjes së Shkrimtarëve. Si drejtues i projektit është paguar gjithsej 2, 400 dollarë.

Të ardhura nga puna si drejtues i firmës “Shala” sh.p.k., për periudhën 1996 - 1997 janë deklaruar 1, 100, 000 lekë. Veprimet bankare të Firmës “Shala” në atë kohë janë kryer në Degën e Bankës Kombëtare Elbasan. Për të dokumentuar këto të ardhura, i është drejtuar në datë 10.04.2018, Bankës Kombëtare Tregtare. Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr. 1729/1, datë 17.04.2018, shpjegon se pas privatizimit të saj në vitin 2000, nuk i disponon më këto të dhëna. Të ardhurat e deklaruara i provon me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore për Xhavit Shalën, në vitet 1996 - 1997.

Të ardhurat nga titulli ekzekutiv, vendimi civil nr. 2518, datë 09.10.1996, i Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me palë kreditore Shoqëria “Shala”, e debitore Ndërmarrja e Prodhimit të Materialeve të Ndërtimit Elbasan, me objekt ekzekutimi “Respektim kontrate”. Të ardhurat e përfituara nga zbatimi i këtij titulli ekzekutiv janë 1, 930, 000 lekë. Kjo provohet me: Vendimin nr. 2518, datë 09.10.1996, të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Vërtetim nr. 9, datë 11.04.2018, i Zyrës së Përmbarrimit Elbasan mbi ekzekutimin e vendimit të mësipërm të gjykatës.

Dosja që përmbante praktikën për ekzekutimin e vendimit të mësipërm të Gjykatës, sipas shpjegimeve të zyrës së përmbarrimit, është djegur në vitin 1997, kur u sulmua Gjykata e Elbasanit. Në bazë të vendimit të Gjykatës, Zyra e Përmbarrimit, përlllogarit shumën me gjithë interesat që detyrohej pala e paditur, shumë e cila arrinte në 1, 930, 000 lekë dhe e ekzekutoi vendimin.

Në lidhje me mësimdhënien ka sqaruar se të ardhurat kanë qenë që nga viti 2008 e deri më sot, një punësim i dytë dhe burim i dytë legjitim të ardhurash për të. Mësimdhënia është e vetmja mundësi që lejohet për dy punësim nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit, referuar Ligjit “Për Policinë e Shtetit” të vitit 2007 dhe 2014. Leja për mësimdhënien fillimisht jepej nga Drejtoria e Standardeve Profesionale dhe më pas nga Titullari i Institucionit. Leja merret një herë në vit dhe ka kohëzgjatje njëvjeçare.

Gjatë të gjithë periudhës që është angazhuar më mësimdhënie, gjithmonë ka marrë miratimin sipas procedurës dhe këtë e provon me dokumentacionin e ruajtur për të paktën 10 vite. Nuk ka gjetur në sekretari të institucionit dokumentacion për lejen e tij për mësimdhënie për para 10 viteve.

Për të ardhurat nga qiradhënia, ka deklaruar se nuk është nënshkruar kontratë vijuese për periudhën 2021 - 2023, pasi qiramarrësi pret që të largohet në Kanada. Është rënë dakord me gojë, që kontrata e nënshkruar me 25.12.2017, të jetë vazhduese deri në largimin e qiramarrësit në Kanada. Si qiradhënës, ka paguar në vazhdimësi tatimin në burim dhe këtë e provon me dokumentacionin e deklaramit të të ardhurave në DPT.

Me procesverbalin e datës 24.11.2023, subjekti ka deklaruar se në lidhje me lejen e mësimdhënies për periudhën 2007 - 2009, i është drejtuar me një kërkesë Akademisë së Sigurisë për nxjerrjen nga sekretaria apo regjistri përkatës për të dy punësuarit në Sektorin e

Burimeve Njerëzore të Akademisë së Sigurisë, të kopjeve të dokumentacionit për leje për mësimdhënie si veprimtari të dyta, për periudhën 2007 - 2009, kur ka qenë në Akademinë e Sigurisë. Akademia e Sigurisë, me shkresën nr.2561/1, datë 21.11.2023, në përgjigje të kërkesës së tij konfirmojnë se: “...Pas kontrollit të bërë në sekretarinë e Akademisë së Sigurisë, duke qenë se kanë kaluar dhe afatet e ruajtjes së këtyre dokumenteve, rezulton se nuk disponojnë shkresë për leje për mësimdhënie si veprimtari të dyta, për periudhën 2007 - 2009, për Z. Xhavit Shala...”.

Për nxjerrjen nga sekretaria të lejeve të mësimdhënies, i është drejtuar me një kërkesë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, ku ka punuar për vitet 2009 - 2012 (për të cilët mungojnë praktikat e lejes për mësimdhënie, si veprimtari të dyta).

Për këtë kërkesë, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr.4836, datë 22.11.2023, përgjigjet se: “...Në Arkivin në Veprim, në Sektorin e Sekretariatit dhe Arkivit, në Drejtorinë e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nuk disponohet ky dokumentacion, të cilit i kanë kaluar dhe afatet e ruajtjes...”.

Në shpjegimet e datës 17.04.2024, lidhur me të ardhurat e përfituara nga mësimdhënia si pedagog i jashtëm në Universitetin Kristal, për periudhën 2008 – 2012, në shumën 1, 241, 286 lekë, subjekti u shpreh se meqenëse universiteti ishte mbyllur dhe për pasojë nuk mund të merrte vërtetim për të ardhurat nga mësimdhënia, i është referuar statement bankar të Union Bank datë 11.04.2018, ku përmendet totali i shumës së kredituar. Kur është bërë deklarimi, është bërë një lapsus pasi për të njëjtën datë e shumë, është referuar statement i ProCredit Bank.

Subjekti ka dorëzuar:

- **Vendim** emërtese nr. 17, datë 15.07.1988, i DPB Elbasan. Konfirmohet paga bazë në shumën 680 lekë, me të drejtë administrative nga data 16.07.1988.
- **Vërtetim** për bazën e vlerësuar dhe pagën neto mesatare, nga ISSH Elbasan. Konfirmohen të ardhurat e pagës mbi të cilën janë derdhur kontributet për Xhavit Shala për periudhën prill 1996 - prill 1997, në shumën bruto 56, 540 lekë.
- **Vërtetim** nr. 618/19, prot., datë 04.12.2019, nga Kolegji ISPE, ku konfirmohen marrëdhëniet e punës për Xhavit Shala për periudhën 08.01.2016 - 30.09.2017. Bashkëlidhur Kontrata e Punës datë 11.01.2016. Paga bruto për 1 ligjëratë do jetë 50 euro.
- **Vërtetim** nga Shtëpia Botuese “Onufri”, datë 09.11.2023. Konfirmohet se Xhavit Shala ka tërhequr honorare nga Onufri për vitet 2003 - 2017, në shumën rreth 1, 220, 000 lekë.
- **Vërtetim** nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, datë 10.02.2020. Konfirmohet se organizata “Qendra Shqiptare e Studimeve për Sigurinë Kombëtare”, me drejtues Xhavit Shala, është mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë në vitin 2006, me shumën 6, 570 usd. Bashkëlidhur Raporti Vjetor i Fondacionit Shoqëria e Hapur Soros, për vitin 2006, në të cilin konfirmohen fondet e dhëna për Qendrën e Studimeve për Sigurinë Kombëtare, në vlerën 6, 570 usd.
- **Kërkesë** e Xhavit Shala, datë 10.04.2018, drejtuar Bankës Kombëtare Tregtare datë 10.04.2018, për marrje informacioni për veprimet bankare të kryera pranë BKT nga firma “Shala” sh.p.k, në periudhën 1995 - 1997. Bashkëlidhur përgjigje e shkresës së datës 10.04.2018, nga BKT, me nr. 1729/1, prot., datë 18.04.2018, ku konfirmohet se nuk mund ti vërë në dispozicion informacionin e kërkuar, pasi në vitin 2000 është bërë privatizimi i kësaj banke dhe dokumentacioni me status ruajtje të përhershme është dorëzuar pranë

Arkivit Qendror Shtetëror, ndërsa dokumentacioni me status ruajtje të përkohshme, për periudhën para vitit 2005, është asgjësuar për shkak të kalimit të afateve të parashikuara në ligj.

- **Vendim** i Gjykatës së Rrethit Elbasan nr.2519, datë 09.10.1996, me palë paditëse Shoqëria “Shala sh.p.k”, përfaqësuar nga Xhavit Shala dhe palë e paditur Ndërmarrja e Prodhimit të Materialeve të Ndërtimit pranë Kombinatit Metalurgjik Elbasan, ku është vendosur: Pranimi i kërkesë-padisë të paraqitur nga pala paditëse Shoqëria “Shala” sh.p.k, duke e detyruar palën e paditur, Ndërmarrja e Prodhimit të Materialeve të Ndërtimit pranë Kombinatit Metalurgjik Elbasan, që të vazhdojë zbatimin e kontratës së lidhur me anën paditëse, si dhe të detyrohet ana e paditur t’i paguajë palës paditëse nga data 09.09.1995, e në vazhdim, çdo muaj, shumën prej 181, 500 lekë, sipas afateve të përcaktuara në kontratën e datës 31.03.1995. Afati i kontratës ishte deri në datë 31.03.1997.
- **Vërtetim** nr. 9, datë 11.04.2018, nga Zyra Përmbarimore Elbasan. Konfirmohet se Vendimi civil nr. 2518, datë 09.10.1996 i Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me palë kreditore Shoqëria “Shala sh.p.k”, e debitore Ndërmarrja e Prodhimit Materialeve të Ndërtimit, me objekt ekzekutimi “respektim kontrate”, është ekzekutuar dhe vendosur pushimi.
- **Shkresë** nr. Xh-10/1, prot., datë 28.10.2013, “Përgjigje për kërkesën e Drejtues Xhavit Shala për dy punësim”. Jepet dakordësia për dy punësimin për një afat 1 vjeçar.
- **Shkresë** nr. 373/Xh-3, prot., datë 19.03.2013 “Përgjigje për kërkesën e Drejtues Xhavit Shala për dy punësim”. Jepet dakordësia për dy punësimin për një afat 1 vjeçar.
- **Shkresë** nr. Xh-6/1, prot., datë 10.12.2014 “Përgjigje për kërkesën e Drejtues Xhavit Shala për dy punësim”. Jepet dakordësia për dy punësimin për një afat 1 vjeçar. **Bashkëlidhur:**
- **Njoftim** për regjistrimin e një interesi (Kërkesë) për Biznes/Dy punësim, datë 07.12.2014, për mësimdhënie në programin “Master Shkencor” në Universitetin “Luarasi”, në Universitetin Evropian të Tiranës (UET) dhe Universitetin “Beder”.
- **Shkresë** nr.348/1, prot., datë 01.03.2016, “Për dhënie leje dy punësimi”. Jepet dakordësia për dy punësimin për një afat 1 vjeçar. Bashkëlidhur kërkesë e datës 26.02.2016, për leje dy punësimi.
- **Shkresë** nr. 885/1, prot., datë 04.04.2017 “Për dhënie leje dy punësimi”. Jepet dakordësia për dy punësimin për një afat 1 vjeçar.
- **Shkresë** nr. 1410/1, prot., datë 22.06.2018 “Për miratimin e lejes për punësimin për veprimtari të dyta (mësimdhënie)”. Jepet dakordësia për dy punësimin për periudhën 22.06.2018 - 21.06.2019. Bashkëlidhur: Kontratë pune individuale me kohë të pjesshme të stafit akademik, datë 15.10.2018, me Universitetin “Bedër”.
- **Shkresë** nr. 2317/1, prot., datë 28.10.2019 “Për miratimin e lejes për punësimin për veprimtari të dyta (mësimdhënie)”. Jepet dakordësia për dy punësimin për periudhën 17.10.2019 - 17.10. 2020. Bashkëlidhur: Kërkesë nr. 2317, datë 17.10.2019, për leje dy punësimi. Kontratë pune individuale me kohë të pjesshme të stafit akademik, datë 11.11.2019, me Universitetin “Bedër”.
- **Shkresë** nr. 1341/1, prot., datë 10.11.2020 “Për dhënie leje dy punësimi”. Jepet dakordësia për dy punësimin me afat 1 vit. Bashkëlidhur kërkesë nr. 1341, datë 10.11.2020, për leje dy punësimi.
- **Shkresë** nr. 1261/1, prot., datë 02.11.2021 “Për miratimin e lejes për punësimin për veprimtari të dyta (mësimdhënie)”. Jepet dakordësia për dy punësimin për periudhën 02.11.2021 - 02.11.2022. Bashkëlidhur: Kërkesë nr. 1261, datë 08.10.2021, për leje dy punësimi.

- **Vërtetim** nga Universiteti Luarasi nr. extra, prot., datë 01.11.2021, ku konfirmohet se Xhavit Shala është i punësuar si pedagog me kohë të pjesshme, pranë Fakultetit të Drejtësisë, për vitin akademik 2021 - 2022.
- **Shkresë** nr.2197/1, prot, datë 14.10.2022 “Për miratimin e lejes për punësimin për veprimtari të dyta (mësimdhënie)”. Jepet dakordësia për dy punësimin për periudhën 14.10.2022 - 10.10.2023. Bashkëlidhur: Kërkesë nr.2197, datë 11.10.2022, për leje dy punësimi. Kontratë pune më afat të caktuar (staf akademik me kohë të pjesshme) të datës 14.11.2022, e lidhur me Universitetin “Luarasi”.
- **Shkresë** nr. 2208/1, prot., datë 10.10.2023 “Për miratimin e lejes për punësimin për veprimtari të dyta (mësimdhënie)”. Jepet dakordësia për dy punësimin për periudhën 10.10.2023 - 09.10.2024. Bashkëlidhur: Kontratë pune për personelin akademik me kohë të pjesshme, datë 12.05.2023, e lidhur me Universitetin e Tiranës.
- **Deklarata individuale vjetore e të ardhurave** në emër të Xhavit Shala, për vitet 2018 - 2022. Konfirmohet deklarimi i të ardhurave nga qiradhënia në shumën 120, 000 lekë në vit, si dhe shlyerja e detyrimeve tatimore për të ardhurat në burim.
- **Kthim përgjigje** nr.4836, prot., datë 22.11.2023, nga DPPSH, ku konfirmohet se nga Arkivi në veprim, në Sektorin e Sekretariatit dhe Arkivit, në Drejtorinë e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nuk disponohet dokumentacioni për lejet e dy punësimit për veprimtarinë e mësimdhënies për periudhën 2009 - 2012, pasi ka kaluar afati i ruajtjes.
- **Kthim përgjigje** nr. 2561/1, prot., datë 21.11.2023, nga Akademia e Sigurisë, ku konfirmohet se nuk disponohet shkresë për leje për mësimdhënie si veprimtari të dyta, për periudhën 2007-2009, për Xhavit Shala, duke qenë se kanë kaluar afatet e ruajtjes së këtyre dokumenteve.

Konkluzion:

- *Të ardhurat neto të subjektit nga paga dhe shpërblimet, për periudhën 1984 – shkurt 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 28, 269, 000 lekë, (për periudhën 1984 - 2006 llogaritur nga dokumentacioni dhe 01.01.2007 - janar 2023 nga përgjigjet e bankave).*
- *Të ardhurat e pa dokumentuara nga puna si drejtues i firmës “Shala” sh.p.k, për periudhën 1996 - 1997, në shumën 1, 043, 460 lekë, (llogaritur tek të ardhurat vetëm shuma 56, 540 lekë, për të cilat janë derdhur kontributet).*
- *Të ardhurat e deklaruar nga ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan të vitit 1996, janë në shumën 1, 930, 000 lekë.*
- *Të ardhurat bruto nga qiradhënia për periudhën 2018 - 2023, në shumën 620, 000 lekë. (Shlyerja e detyrimeve tatimore trajtuar më poshtë).*
- *Të ardhurat nga shitja e librave për periudhën 2003 - 2017, në shumën rreth 1, 220, 000 lekë.*
- *Të ardhura nga shitja e apartamentit në Elbasan, në vitin 1994, të privatizuar nga shteti në shumën 550, 000 lekë.*

Deklarimi i detyrimeve financiare të subjektit të vlerësimit

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/c, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje,

detyrim ndaj të tretëve, etj.), që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar detyrimet financiare si më poshtë:

1. Kredi për apartament nga Enti Kombëtar i Banesave, në shumën 1, 503, 436 lekë, me kohëzgjatje 25 vjet, me këst mujor 4, 730 lekë, për blerjen e apartamentit të ndërtuar nga vetë Enti Kombëtar i Banesave. Detyrimi i mbetur 163, 953 lekë.

Procedura e vlerësimit:

Me procesverbalin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se sipas librezës së kthimit të kredisë, shuma e shlyer është gjithsej 1, 301, 826 lekë dhe detyrimi i mbetur për t'u paguar në Entin Kombëtar të Banesave është gjithsej 201, 610 lekë. Ka dorëzuar:

- Librezë për kthim kredie nga Enti Kombëtar i Banesave, në emër të Xhavit Shala. Çmimi i apartamentit 1, 503, 436 lekë, kësti i paguar 86, 517 lekë, kredia e mbetur 1, 416, 919 lekë. Pagesa fillon nga muaji gusht 2001. Kësti i llogaritur 4, 730 lekë.

Konkluzion:

- *Konfirmohet detyrimi i shlyer deri në datë 01.06.2023, në shumën 1, 361, 243. Shuma e shlyer deri në datë 31.12.2022, në rreth 1, 246, 346 lekë dhe detyrimi i mbetur rreth 170, 573 lekë.*
- *Subjekti ka paraqitur sqarime dhe dokumentacion justifikues në lidhje me shlyerjen e kësteve të kredisë.*

Deklarimi i shpenzimeve të subjektit të vlerësimit.

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/ç, d, dh, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaroi shpenzimet e vitit të fundit për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha pagesat periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të tij ose të personave të lidhur; udhëtimet private personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen, shpenzimet e përballuara; arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, në momentin e deklaramit apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve.

🚩 Në mbështetje të nenit 33, pika 1/ç, subjekti deklaroi:

Shpenzime për vitin e fundit periudha janar - dhjetor 2022, në shumën 205, 805 lekë nga të cilat, për ujë 44, 903 lekë, për drita 108, 822 lekë, për internet 23, 880 lekë, dhe për shërbim celular 28, 200 lekë (unë, bashkëshortja dhe djali).

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kopje e librezës së furnizimit me energji elektrike me nr. 209003, në emër të Qazim Kuqashi. Konfirmohet shlyerja e detyrimeve për vitin 2022 (janar - dhjetor), në shumën totale rreth 80, 186 lekë.
- Kopje e librezës së OSHEE me nr. kontrate 41627, në emër të Xhavit Shala. Konfirmohet shlyerja e detyrimeve për vitin 2022 (janar - dhjetor), në shumën totale rreth 40, 375 lekë.
- Kopje e librezës së UKT në emër të Qazim Kuqashi, me nr. 146***. Konfirmohet shlyerja e detyrimeve për vitin 2022 (janar - dhjetor), në shumën totale rreth 40, 319 lekë.
- Kopje e librezës së UKT në emër të Xhavit Shala, me nr. 252***. Konfirmohet shlyerja e detyrimeve për vitin 2022 (janar - dhjetor), në shumën totale rreth 3, 180 lekë.
- Mandat pagesë datë 10.06.2021, për Pronet, në shumën 23, 880 lekë, për shërbimin internet, për periudhën 10.06.2021 - 10.06.2022. Bashkëlidhur kontratë pajtimi për shërbimin e aksesit në internet, datë 10.03.2021, me kompaninë Pronet.

Procedura e vlerësimit:

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli sa i përket shpenzimeve të deklaruara nga subjekti i vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezultojnë se:

Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU), me shkresën nr. ***, prot., datë 25.09.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Xhavit Fetah Shala, identifikohet 1 abonent me kontratë furnizimi nr. DUIE***41627, në instancën Kavajë. Shuma e paguar për vitin 2022 (janar - dhjetor 2022), në shumën 40, 375 lekë.

Me gjeneralitetet Xhavit Shala (nuk konfirmohet emri i babait), identifikohen 2 abonentë me kontratën e furnizimit me nr. BU***03087863, në instancën Burrel dhe nr. TR2D02***0089, në instancën Tiranë.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës - Kanalizime Tiranë, me shkresën nr. ***, prot., datë 18.10.2023, konfirmon 1 kontratë në emër të Xhavit Shala, me nr. 0704***, për objektin në rr. “D. B” me detyrime të shlyera deri në muajin gusht 2023. Shuma e paguar për vitin 2022, rreth 21, 610 lekë.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës - Kanalizime Lezhë, me shkresën nr. ***, prot., datë 27.09.2023, konfirmon se në emër të Xhavit Shala, rezultojnë një kontratë furnizimi me ujë me nr. 3110324, në adresën: rr. K., Mamurras. Është debitor ndaj UK Lezhë, në shumën 119, 671 lekë.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës - Kanalizime Lezhë, me shkresën nr. ***, prot., datë 23.11.2023, konfirmon se pas verifikimeve të kryera ka rezultuar se kontrata me nr. 311***, nuk i përket z. Xhavit Fetah Shala, i datëlindjes 07.08.1961, me nr. ID GI0***108A, por një shtetasi tjetër me të njëjtat gjeneralitete (emër mbiemër) Xh. B. Shala, banues në Mamurras.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës - Kanalizime Durrës, me shkresën nr. ***, prot., datë 27.09.2023, konfirmon 1 kontratë në emër të Xhavit Shala, me adresë Golem, Kavajë me nr. 25292. Shuma e paguar për vitin 2022, rreth 3, 030 lekë.

12 Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës - Kanalizime, me shkresat nr. 69/34a; 69/35a; 69/37a; 69/39a – 69/47a, prot., nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Vodafone Albania sh.a, me shkresën nr. ***, prot., datë 15.11.2023, konfirmon se në emër të Xhavit Shala, figuron i regjistruar 1 numër telefoni nga data 02.04.2008. Shuma e paguar për vitin 2022, rreth 6, 000 lekë.

Në emër të Aida Shala, figuron i regjistruar 1 numër telefoni nga data 02.05.2008. Shuma e paguar për vitin 2022, rreth 8, 400 lekë.

Në emër të Eros Shala, nuk korrespondon asnjë numër celular, i regjistruar në rrjetin e shoqërisë Vodafone Albania sh.a.

Gjithashtu nuk korrespondon asnjë kontratë telefonike fiks apo interneti në shoqërinë Vodafone Albania, në emër të Xhavit Shala dhe personave të lidhur.

One Albania sh.a, me shkresën nr. ***, prot., datë 11.10.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga Xhavit Shala, Aida Shala dhe Eros Shala.

Albania Satellite Communications sh.p.k, me shkresën nr. ***, prot., datë 29.09.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Abissnet sh.a, me shkresën nr. V-prot., datë 09.02.2024, nuk konfirmon kontrata në emër të Xhavit Shala, Aida Shala dhe Eros Shala. Konfirmon kontratë në emër të Astrit Shala, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, e cila trajtohet më poshtë.

Digicom sh.a, me shkresën nr. ***, prot., datë 20.09.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Me e-mailin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se kontrata për energjinë elektrike në shtëpinë ku ai banon është ende në emër të Qazim Kuqashit, dhe ka nr. TR2E***09003. Shpenzimet për energjinë elektrike, për këtë kontratë, për vitin 2022, janë 80, 186 lekë. Kontrata me Ujësjiellësin në shtëpinë ku ai banon është akoma në emër të Qazim Kuqashit, dhe ka nr. 146***. Shpenzimet për ujësjiellësin, për këtë kontratë, për vitin 2022, janë 39, 967.2 lekë.

Shpenzimet për energjinë elektrike për shtëpinë në Golem, në emër të Xhavit Shala, me nr. kontrate DUIE***41627, për vitin 2022, janë 40, 375 lekë.

Shpenzimet për ujësjiellësin, për shtëpinë në Golem, në emër të Xhavit Shala, me kontratë nr.25292, të lidhur me Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës, për vitin 2022, janë 3, 030 lekë. Pra në total, shpenzimet për furnizimin me energji elektrike dhe ujë për vitin 2022, për shtëpinë në Tiranë, në adresën “F. T”, nr.82, dhe shtëpinë në Golem, janë gjithsej 163, 558.4 lekë.

Nuk ka asnjë njohuri në lidhje me kontratën nr. BUOE***3087863 në Burrel. Ndërsa kontrata për energjinë elektrike me nr. TR2D02***0089, në Tiranë, në emër të Xhavit Shala është për shtëpinë në “Njësinë Administrative nr. 9, rr. “D.B”, Pallati 16, Shkalla 2-8, Tiranë”. Kjo shtëpi është e dhënë me qira dhe detyrimet për energjinë elektrike për vitin 2022 janë paguar nga qiramarrësi dhe janë verifikuar nga ana e tij. Kjo konfirmohet dhe nga librezja e pagesës bashkëlidhur. Kontrata me Shoqërinë Ujësjiellës - Kanalizime Tiranë, më nr. 070***, për furnizimin me ujë në emër të Xhavit Shala është për shtëpinë e tij në “Njësinë Administrative nr. 9, rr. D.B”, Pallati 16, Shkalla 2-8, Tiranë”. Kjo shtëpi është e dhënë me qira dhe detyrimet për furnizimin me ujë për vitin 2022 janë paguar nga qiramarrësi dhe janë verifikuar nga ana e tij. Kjo konfirmohet dhe nga librezja e pagesës bashkëlidhur.

Ka deklaruar se Xhavit Shala, i biri i Fetahut dhe i Rabijes, i datëlindjes 07.08.1961, lindur në Qerret, Durrës dhe banues në Tiranë, rr. "F.T", nr.82, nuk ka asnjë lidhje me abonentët me të njëjtin emër me kontratë nr. BUOE***087863, por pa atësi, të konfirmuara nga FSHU në Burrel. Gjithashtu nuk ka asnjë lidhje me abonentin me të njëjtin emër por pa atësi, me nr. kontrate 311***, të konfirmuar nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë. Këtë e konfirmon me kërkesën nr. Xh-29, prot., datë 09.11.2023, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, përgjigjes së kësaj drejtorie me nr. Xh-29/1, prot., datë 10.11.2023, si dhe të raportit nga regjistri kombëtar i gjendjes civile, ku vërtetohet se në Shqipëri figuron vetëm një shtetas me të dhënat: Xhavit Shala, i datëlindjes 07.08.1961, lindur në Qerret, Durrës.

Shpenzimet e telefonisë për vitin 2022, për subjektin Xhavit Shala kanë qenë 6, 030 lekë, për bashkëshorten Aida Shala, 9, 100 lekë dhe për djalin Eros Shala, 18, 200 lekë. Subjekti ka deklaruar gjithashtu se gjatë vitit 2022 ka marrë trajtim mjekësor më datë 23.12.2022, dhe ka bërë një ndërhyrje kirurgjikale në Spitalin Salus dhe ka kushtuar 4, 687 euro.

Bashkëshortja e tij Aida Shala, më datë 18.05.2022 ka bërë një ndërhyrje në Spitalin Salus dhe ka kushtuar 4, 275 euro. Të gjitha shpenzimet janë mbuluar nga të ardhurat nga paga e tij, bashkëshortes dhe dy djemve.

Paraqiti:

- Kopje e librezës së energjisë elektrike me nr. 209***, në emër të Qazim Kuqashit, ku konfirmohet shuma e paguar në vitin 2022, rreth 80, 186 lekë.
- Kopje e librezës me UK, nr. 146***, në emër të Qazim Kuqashit, ku konfirmohet shuma e paguar në vitin 2022, rreth 40, 319 lekë.
- Kopje e librezës me OSHEE me nr. DUIE***041627, në emër të Xhavit Shala, ku konfirmohet shuma e paguar në vitin 2022, rreth 40, 375 lekë.
- Kopje e librezës me nr. 25292, të lidhur me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kavajë, në emër të Xhavit Shala, ku konfirmohet shuma e paguar për vitin 2022, në rreth 3, 180 lekë.
- Kopje e librezës me FSHU me nr. 200***, në emër të Xhavit Shala, ku konfirmohet shuma e paguar për vitin 2022, rreth 61, 018 lekë.
- Kopje e librezës me UKT, me nr. 070***, në emër të Xhavit Shala, ku konfirmohet shuma e paguar për vitin 2022, rreth 21, 793 lekë.
- Kërkesë nr.Xh-29, prot., datë 9.11.2023, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, për marrje dokumentacioni, ku të vërtetohet se me gjeneralitetet e tij dhe të djalit Astrit Shala, nuk ka njeri tjetër në Shqipëri.
- Kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me nr. Xh-29/1, prot., datë 10.11.2023, ku konfirmohet se me të dhënat e paraqitura Xhavit Shala, lindur në Qerret, Durrës, më datë 07.08.1961, figuron të jetë regjistruar vetëm një shtetas.
Me të dhënat Astrit Shala, lindur në Elbasan, më datë 06.05.1988, figuron të jetë i regjistruar vetëm një shtetas.
Me të dhënat Astrit Shala (emër, mbiemër), figurojnë të regjistruar 11 shtetas.
- Raporti nga regjistri kombëtar i gjendjes civile, datë 11.11.2023, ku vërtetohet se në Shqipëri figuron vetëm një shtetas me të dhënat: Xhavit Shala, i datëlindjes 07.08.1961, lindur në Qerret, Durrës.
- Mandat pagesë datë 10.06.2021, për Pronet, në shumën 23, 880 lekë, për shërbimin internet për periudhën 10.06.2021 - 10.06.2022. Bashkëlidhur kontratë pajtimi për shërbimin e aksesit në internet, datë 10.03.2021, me kompaninë Pronet.

- Faturë pagese për Pronet, nga Xhavit Shala, datë 06.08.2023, për periudhën deri në datë 12.06.2024, në shumën 17, 880 lekë.
- Tabela përmbledhëse nga kompania Vodafone, me nr. 1031362, për shpenzimet telefonike të klientit Xhavit Shala, për vitin 2022.
- Tabela përmbledhëse nga kompania Vodafone, me nr.1031393, për shpenzimet telefonike të klientit Aida Shala, për vitin 2022.
- Statement nga Credins Bank në emër të Eros Shala, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022. Konfirmohet shuma e paguar për vitin 2022, për Vodafone në shumën 16, 800 lekë.
- Faturë pagese nga Aida Shala në Spitalin Salus, datë 18.05.2022, në shumën 4, 275 euro, (521, 550 lekë). Shuma totale e faturës 4, 275 euro.
- Faturë pagese nga Xhavit Shala, në Spitalin Salus, datë 23.12.2022, në shumën 4, 687 euro (553, 125 lekë).

Me procesverbalin e datës 24.11.2023, subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë njohuri në lidhje me kontratën nr. BUOE***3087863, në Burrel. Për këtë, me datë 16.11.2023, i është drejtuar me një kërkesë Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a, dhe ka kërkuar informacion nëse kontrata me nr. BUOE***3087863, në Burrel, është në emër të Xhavit Fetah Shala, i datëlindjes 07.08.1961, lindur në Qerret Durrës, me nr. ID G108***08A dhe për kontrata të tjera për furnizimin me energji elektrike që janë në emër të Xhavit Fetah Shala, i datëlindjes 07.08.1961, lindur në Qerret Kavajë, me nr. ID G108***084. Deri tani nuk ka marrë përgjigje nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.

Po ashtu me datë 16.11.2023, i është drejtuar Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime sha. Lezhë, me kërkesën për informacion nëse Xhavit Fetah Shala, i datëlindjes 07.08.1961, lindur në Qerret Durrës, me nr. ID G108***084, ka kontratë furnizimi me ujë nga Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Lezhë sh.a. dhe nëse Xhavit Shala, i cili rezulton me kontratën e furnizimit me ujë, me nr. 311***, në adresën “Rr. e K.”, Mamurras, është i biri i Fetah Shalës.

Pas kërkesës së tij, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës - Kanalizime sh.a. Lezhë, me shkresën nr. 1095/1, prot, datë 21.11.2023, me lëndë “Saktësim informacioni”, i është drejtuar ILDKPKI-së dhe për dijeni subjektit se Xhavit Fetah Shala, i ditëlindjes 07.08.1961, lindur në Qerret Kavajë, me nr. ID G108***084, nuk ka kontratë furnizimi me ujë nga Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Lezhë sh.a. dhe se kontrata me nr. 311*** nuk i përket Xhavit Fetah Shalës, i ditëlindjes 07.08.1961, lindur në Qerret Kavajë, me nr. ID G108***08A, por një shtetasi tjetër me të njëjtat gjeneralitete (emër, mbiemër) Xh. B. Shala, banues në Mamurras. Për këtë, në fund të kësaj shkrese, Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Lezhë sh.a, kërkon ndjesë për lapsusin e bërë.

Ka dorëzuar:

- Kërkesë drejtuar FSHU sh.a, datë 16.11.2023, nga Xhavit Shala.
- Kërkesë drejtuar Ujësjetllës - Kanalizime sh.a Lezhë, datë 16.11.2023, nga Xhavit Shala.
- Saktësim informacioni nga Ujësjetllës - Kanalizime sh.a Lezhë, nr. 1095/1, prot., datë 21.11.2023, (pasqyruar te përgjigja e UK-Lezhë me sipër).

Konkluzion:

- *Shpenzimet e deklaruara për ujë, energji elektrike, shpenzime telefonie dhe interneti, me kontrata në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të, në total për periudhën*

01.01.2022 - 31.12.2022 janë rreth 302, 000 lekë, nga të cilat (sipas deklaramit të subjektit 82, 811 lekë të paguara nga qiramarrësi).

- **Shpenzime shëndetësore për subjektin dhe bashkëshorten për vitin 2022, në total 8, 962 euro, e konvertuar rreth 1, 036, 000 lekë.**

🚩 Në mbështetje të nenit 33, pika 1/d, subjekti deklaron:

- Gjatë tre viteve të fundit, udhëtimet e mia individuale apo me bashkëshorten, kemi qenë disa herë për në Kosovë, ku kemi qëndruar në lidhjet tona fisnore.
- Kam udhëtuar zyrtarisht për në Bullgari, në tetor 2021, në përbërje të një delegacioni shtetëror. Udhëtimi është financuar nga Policia e Shtetit.
- Kam udhëtuar zyrtarisht për në Finlandë, në nëntor 2021. Udhëtimi është financuar nga Projekti Finlandezo – Estonez i binjakëzimit me Akademinë e Sigurisë.

Procedura e vlerësimit:

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli sa i përket udhëtimeve të deklaruara nga subjekti i vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezultoi se:

Me e-mailin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se gjatë tre viteve të fundit (2020 - 2022), ka bërë gjithsej tre udhëtime jashtë shtetit, si më poshtë:

1. Më datë 17.06.2021 ka qenë në Kosovë, vajtje - ardhje brenda ditës. Shpenzimet për këtë udhëtim janë rreth 100 euro, të ardhura këto nga paga.
2. Më datë 13.10.2021 deri më datë 16.10.2021, ka udhëtuar për në Bullgari në përbërje të një delegacioni shtetëror. Shpenzimet për këtë udhëtim, në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 920, datë 11.10.2021, janë përballuar nga Policia e Shtetit.
3. Më datë 14.11.2021 deri me datë 20.11.2021, në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1024, datë 09.11.2021, ka udhëtuar për në Finlandë në një vizitë studimore, në përbërje të një delegacioni të Akademisë së Sigurisë, të organizuar në kuadër të Projektit të Binjakëzimit Forcimi i Kapaciteteve dhe Efikasitetit të Akademisë së Sigurisë. Shpenzimet e udhëtimit janë përballuar nga pala finlandeze.

Bashkëshortja Aida Shala për periudhën 2020 - 2022, nuk ka bërë udhëtime jashtë shtetit.

Djali Eros Shala gjatë periudhës 2020 - 2022: Nga data 06.05.2021 deri më datë 07.05.2021, ka udhëtuar me autobus për në Kosovë. Shpenzimet për këtë udhëtim janë rreth 200 euro, të ardhura këto nga paga e tij.

Nga data 26.07.2021 deri më datë 02.07.2021, ka udhëtuar me autobus për në Mal të Zi. Shpenzimet për këtë udhëtim janë rreth 600 euro, të ardhura këto nga paga e tij. Nga data 10.08.2021 deri më 17.08.2021, ka udhëtuar për në Egjipt. Shpenzimet për këtë udhëtim janë rreth 1, 700 euro, ta ardhura këto nga paga e tij.

Djali Astrit Shala gjatë periudhës 2020 - 2022: Nga data 17.03.2022 - 24.03.2022, ka udhëtuar për në Bruksel, për llogari të institucionit ku punon, i cili ka mbuluar dhe shpenzimet.

Nga data 26.09.2022 deri më datë 02.10.2022, ka udhëtuar për në Bruksel, për llogari të institucionit ku punon, i cili ka mbuluar dhe shpenzimet. Për arsye të procedurave të tyre, institucioni ku punon (Ambasada e SHBA në Tiranë), nuk ka praktikë të lëshojë dokumentacion justifikues për të tilla shërbime. **Paraqiti:**

- Raport nga sistemi TIMS, për Xhavit Shala, ku konfirmohen 3 hyrje/dalje për periudhën qershor 2021 - nëntor 2021.
- Raport nga sistemi TIMS, për Aida Shala, ku nuk konfirmohen hyrje /dalje për periudhën 2020 - 2022.
- Raport nga sistemi TIMS, për Eros Shala, ku konfirmohen 3 dalje dhe 2 hyrje në vitin 2021.
- Raport nga sistemi TIMS, për Astrit Shala, ku konfirmohen 7 hyrje/dalje, për periudhën mars 2022 - tetor 2023. Për periudhën deri në 17.02.2023, rezultojnë 3 hyrje/dalje nga Komisariati i Policisë Rinas.
- Urdhër nr. 920, datë 11.10.2021, i DPPSH, për dërgimin me shërbim jashtë vendit, për Xhavit Shala, me detyrë Drejtor i Qendrës Kërkimore, në Akademinë e Sigurisë, për periudhën 13 - 15 tetor 2021, në Sofie, Bullgari. Data e nisjes do jetë 13 tetor 2021 dhe data e kthimit do jetë 16 tetor 2021. Shpenzimet e udhëtimit, dietat e plota ditore (ushqim + fjetje), si dhe transporti i brendshëm (aeroport – hotel - aeroport), mbulohe nga institucioni.
- Urdhër nr. 1024, datë 09.11.2021, i DPPSH, për dërgimin me shërbim jashtë vendit, për Xhavit Shala, me detyrë Drejtor i Qendrës Kërkimore Shkencore, në Akademinë e Sigurisë, për periudhën 14 - 20 nëntor 2021 në Helsinki, Finlandë. Data e nisjes do jetë 13 nëntor 2021 dhe data e kthimit do jetë 21 nëntor 2021. Shpenzimet mbulohe nga pala organizatore.

Me procesverbalin e datës 24.11.2023, subjekti ka deklaruar se djali Astrit Shala, nga data 17.03.2022 deri më 24.03.2022, ka udhëtuar për në Bruksel, për llogari të institucionit ku punon, i cili ka mbuluar dhe shpenzimet rreth 2, 000 euro.

Nga data 26.09.2022 deri më datë 02.10.2022, ka udhëtuar për në Bruksel, për llogari të institucionit ku punon, i cili ka mbuluar dhe shpenzimet rreth 2, 000 euro.

Djali i tij i ka konfirmuar përsëri, që për arsye të procedurave të tyre, institucioni ku punon (Ambasada e SHBA në Tiranë), nuk ka praktikë të lëshojë dokumentacion justifikues për të tilla shërbime, për jashtë ambasade.

Në shpjegimet e datës 17.04.2024, subjekti i vlerësimit ka sqaruar se më datë 20.07.2022, djali i tij Eros Shala, ka tërhequr nga llogaria e tij 250, 000 lekë. Po në këtë ditë, me këtë vlerë ai i ka paguar subjektit “***” sh.p.k shumën 1, 870 euro, për të prentuar së bashku me të dashurën e tij, pushimet për në Bodrum, Turqi, të cilat pavarësisht prentimit, nuk u realizuan.

Paraqiti:

Mandat arkëtimi nga subjekti,

Voucher i udhëtimit datë 20.07.2022.

Konkluzion:

- ***Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, sa i përket hyrje - daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë, gjatë periudhës 2020- 2022, të subjektit dhe personave të lidhur me të.***

- *Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur, gjatë periudhës 01.01.2020 - 31.12.2022, rezultojnë në total rreth 550, 000 lekë.*
- *Shpenzimet e deklaruara për djalit Astrit Shala janë për arsye pune në shumën 4, 000 euro, dhe janë mbuluar nga institucioni, për të cilat nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues.*

🚩 Në mbështetje të nenit 33, pika 1/dh, subjekti deklaron:

- ❖ Shpenzime për arsimimin e djalit, Astrit Shala, në Shkollën e Mesme Jopublike “Turgut Ozal”, gjatë 4 viteve të shkollës së mesme, 2003 - 2007, sipas vërtetimit të këtij institucioni nr. 236/397, datë 13.04.2018, në shumën 900, 000 lekë.
- ❖ Shpenzime për arsimimin e djalit Astrit Shala, në Universitetin e Tiranës (Publik), në Fakultetin Ekonomik, gjatë 4 viteve të shkollës së lartë, 2007 - 2011, përlllogaritur sipas pagesave vjetore, në shumën 120, 000 lekë.
- ❖ Shpenzime për arsimimin e djalit Eros Shala, në Shkollën e Mesme Jopublike “Instituti Arsimor Eurolingua”, gjatë 4 viteve të shkollës së mesme 2007 - 2011, në shumën 6, 400 euro.
- ❖ Shpenzime për arsimimin e djalit Eros Shala, në Universitetin Evropian të Tiranës (Jo publik), në Fakultetin Juridik, në programin Bachelor, vetëm për vitin shkollor 2011 – 2012, në shumën 2, 000 euro.
- ❖ Shpenzime për arsimimin e djalit Eros Shala, në Universitetin e Tiranës (Publik), në Fakultetin Juridik, në programin Bachelor, vetëm për vitin e dytë e të tretë, viti 2012 - 2014 në shumën 63, 800 lekë.
- ❖ Shpenzime për arsimimin e djalit Eros Shala, në Universitetin e Tiranës (Publik), në Institutin e Studimeve Evropiane, në programin “Master shkencor” në “Legjislacioni dhe Institucionet e BE-së, për të dy vitet (2014 - 2016), në shumën 180, 000 lekë.
- ❖ Shpenzime shkollimi për subjektin Xhavit Shala, në programin e Postmaster për “EU Business Laë” në Universitetin e Tiranës (Publik), në Fakultetin Juridik, në vitet 2009 - 2011, në shumën 105, 000 lekë.
- ❖ Shpenzime shkollimi për deklaruesin Xhavit Shala, në programin e Doktoraturës për “Siguri dhe Mbrojtje” në Akademinë e Mbrojtjes (Publik), në vitet 2011 - 2013, në shumën 207, 000 lekë.
- ❖ Shpenzime shkollimi për subjektin Xhavit Shala, në programin e Doktoraturës për “Histori” në Akademinë e Studimeve Albanologjike (Publik), në vitet 2012- 2015, në shumën 212, 500 lekë.
- ❖ Tatim mbi të ardhurat personale për vitet 2017 - 2021, në shumën 592, 480 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Kthim përgjigje** nga Institucioni arsimor Turgut Ozal, nr. 236/397, prot., datë 13.04.2018, ku konfirmohet se, për vitet 2003 - 2007, për nxënësin Astrit Shala nuk disponon informacion të ruajtur.
- **Vërtetim** nr. 031, prot., datë 13.04.2018, nga Instituti Arsimor Eurolingua, ku konfirmohet se Eros Shala ka përfunduar gjimnazin në vitin 2007 - 2011. Gjatë 4 viteve të studimit ka paguar në total 6, 400 euro.
- **Mandat arkëtimi** datë 04.10.2012, nga Universiteti Evropian i Tiranës. Arkëtuar nga Eros Shala shuma 1, 000 euro.

- **Mandat pagese** në Credins Bank, datë 03.12.2012, nga Eros Shala, tarifë regjistrimi në Fakultetin e Drejtësisë në shumën 1, 700 lekë.
- **Mandat pagese** në Credins Bank, datë 29.08.2012, nga Eros Shala, tarifë studimesh në shumën 1, 100 lekë.
- **Mandat pagese** nga Union Bank, datë 25.01.2013.
- **Urdhër pagese** në Union Bank, datë 25.01.2013. për Fakultetin e Drejtësisë “tarifë shkollimi” për Eros Shala në shumën 31, 900 lekë.
- **Mandat pagese** në Credins Bank, datë 18.12.2014 nga Eros Shala, për Universitetin e Tiranës në shumën 54, 100 lekë.
- **Mandat pagese** në Credins Bank, datë 08.06.2015 nga Eros Shala, për Universitetin e Tiranës në shumën 36. 100 lekë.
- **Mandat pagese** në Credins Bank, datë 26.01.2016 nga Eros Shala, për Universitetin e Tiranës në shumën 50, 100 lekë.
- **Mandat pagese** në Credins Bank, datë 30.05.2016 nga Eros Shala, për Universitetin e Tiranës në shumën 40, 100 lekë.
- **Mandat pagese** në Union Bank, datë 27.04.2011 nga Xhavit Shala, pagesë tarifë shkollimi viti 2011, Reparti Ushtarak 5561. Pagesë Doktorature, në shumën 60, 000 lekë.
- **Mandat pagese** në Union Bank, datë 27.04.2011 nga Xhavit Shala, pagesë tarifë shkollimi viti 2011, Reparti Ushtarak 5561. Pagesë Doktorature, në shumën 50, 000 lekë.
- **Mandat pagese** në Union Bank, datë 27.04.2011 nga Xhavit Shala, pagesë tarifë shkollimi viti 2011, Reparti Ushtarak 5561. Pagesë Doktorature, në shumën 20, 000 lekë.
- **Mandat pagese** në Credins Bank, datë 12.02.2013 nga Xhavit Shala, pagesë kësti 2, Doktoraturë në shumën 70, 000 lekë.
- **Mandat pagese** për Qendrën e Studimeve Albanologjike Tiranë datë 12.03.2012, në shumën 52, 050 lekë.
- **Shkresë** nga Qendra e Studimeve Albanologjike Tiranë nr. 195, prot., datë 05.03.2015, për Xhavit Shala, ku njoftohet se shuma e paguar deri në shkurt 2015 është 154, 500 lekë dhe detyrimi për tu paguar është në shumën 58, 000 lekë. Bashkëlidhur, faturë pagese e shumës 58, 000 lekë nga Xhavit Shala në BKT “Tarifë për shkollimin K.4, viti 2011 - 2012, Doktoraturë Shkenca Histori”.
- **Diplomë Doktorate** në emër të Xhavit Shala lëshuar në datë 22.11.2013.
- **Doktoratë** në Shkencat Historike në emër të Xhavit Shala, lëshuar në datë 30.12.2020.
- **Diplomë** nga Universiteti i Tiranës, ku fiton titullin Profesor i Asociuar, në emër të Xhavit Shala, lëshuar në datë 28.06.2022.

Procedura e vlerësimit:

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli sa i përket shpenzimeve për arsimim të deklaruar nga subjekti i vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezulton se:

Union Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 04.10.2023, konfirmon pagesë tarife doktorature nga llogaria e Xhavit Shala, në datë 27.04.2011, në shumën 60, 000 lekë dhe në datën 28.02.2013, në shumën 50, 000 lekë. Pagesë për shkollimin e Eros Shala në datë 25.01.2013, në shumën 31, 900 lekë.

Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 18.09.2023, konfirmon shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat për vitin 2017, në shumën 149, 042 lekë.

Credins Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 12.10.2023, konfirmon shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga paga (Diva), për vitet 2018 - 2021, në shumën totale 443, 488 lekë.

Me e-mailin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se shpenzimet për arsimimin e djalit, Astrit Shala, në Shkollën e Mesme Jopublike “Turgut Ozal”, gjatë 4 viteve të shkollës së mesme, 2003 - 2007, janë përlllogaritur gjithsej 900, 000 lekë, sipas referencës 225, 000 lekë që ka paguar në vit. Më datë 12.04.2018, djali Astrit Shala, me një e-mail i është drejtuar atij institucioni për t’u pajisur me vërtetim për këtë pagesë të kryer, por shkolla e mesme jopublike “Turgut Ozal”, me shkresën nr. 236/397, datë 13.04.2018, i përgjigjet se ai institucion nuk disponon informacion të ruajtur për sa ata kërkojnë, si dhe nuk disponojnë dokumentacion tjetër për këto shpenzime.

Shpenzime për arsimimin e djalit, Astrit Shala, në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin Ekonomik, gjatë 4 viteve të shkollës së larte, 2007 - 2011, janë përlllogaritur 120, 000 lekë. Përlllogaritja është bërë sipas referencave vjetore të paguara. Nuk disponon dokumentacion tjetër për këto shpenzime.

Shpenzime për arsimimin e djalit, Eros Shala, në Universitetin Evropian të Tiranës, në Fakultetin Juridik, në programin Bachelor, për vitin shkollor 2011 - 2012 janë paguar 2, 000 euro, në dy këste. Për këtë disponon mandat arkëtimet nr. 000119, datë 04.10.2011 dhe nr 000415, datë 10.11.2011. Vitin e dytë, djali i tij, transferoi studimet në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tiranës.

Shpenzime shkollimi për subjektin Xhavit Shala, në Programin e Posmaster për “EU Business Laë” në Universitetin e Tiranës (publik), në Fakultetin Juridik, në vitet 2009 - 2011 kanë qenë gjithsej 105, 000 lekë. Për këtë nuk disponojnë dokumentacion.

Shpenzime shkollimi për deklaruesin Xhavit Shala, në Programin e Doktoraturës për “Siguri dhe Mbrojtje” në Akademinë e Mbrojtjes, në vitet 2011 - 2013 janë shpenzuar 207, 000 lekë. Disponon dokumentacionin për shumën 137, 000 lekë për këtë program doktore dhe konkretisht:

Faturë për 7, 000 lekë si taksë regjistrimi, (pagesë me dy mandate 5, 000 lekë dhe 2, 000 lekë më 27 Prill 2011 në Union Bank).

Urdhër pagesë e kështit të parë 60, 000 lekë, datë 27.04.2011 të Union Bank, për llogari të Repartit Ushtarak 5561 (Akademia Ushtarake) si dhe kësti i dytë, 70, 000 lekë me urdhër pagesë të datës 12.02.2013 të Credins Bank.

Shpenzime shkollimi për subjektin Xhavit Shala, në Programin e Doktoraturës për “Histori” në Akademinë e Studimeve Albanologjike (Publik), në vitet 2012 - 2015, gjithsej 212, 500 lekë. Kjo provohet me shkresë nr. 1195, datë 05.03.2015, të Drejtorit të Qendrës së Studimeve Albanologjike si dhe njoftimin e Bankës Kombëtare Tregtare të datës 09.03.2015. **Paraqiti:**

- **Kopje e-maili**, datë 12.04.2018, drejtuar Shkollës së Mesme Jopublike “Turgut Ozal”, nga Astrit Shala, për marrje vërtetimi për pagesat e kryera për vitet 2003 - 2007.
- **Kthim përgjigje** nga “Turgut Ozal” nr. 236/397, datë 13.04.2018, ku konfirmohet se nuk ka informacion të ruajtur për pagesat e kryera për nxënësin Astrit Shala për vitet 2003 - 2007.

- **Mandat arkëtimi** datë 04.10.2011 dhe datë 10.11.2011, në Universitetin Evropian të Tiranës nga Eros Shala në shumën 2, 000 euro (1, 000 euro secila faturë). Likuidim për vitin e parë 2011 - 2012, Juridik.
- **Urdhër pagese** e kështit të parë 60, 000 lekë, datë 27.04.2011, në Union Bank, për llogari të Repartit Ushtarak 5561 (Akademia Ushtarake). Pagesë doktore nga Xhavit Shala.
- **Urdhër pagese** taksë regjistrimi në shumën 7, 000 lekë (5, 000 lekë + 2, 000 lekë), datë 27.04.2011, në Union Bank, për llogari të Repartit Ushtarak 5561. Pagesë doktore nga Xhavit Shala.
- **Urdhër pagese** nga Credins Bank, datë 12.02.2013, në shumën 70, 000 lekë, nga Xhavit Shala, “tarifë shkollimi, kësti i 2, Doktoraturë, Xhavit Shala”.
- **Shkresë** nr. 195, datë 05.03.2015, e Qendrës së Studimeve Albanologjike, për shlyerje detyrimi financiar për studimet në QSA, drejtuar Xhavit Shala. Konfirmohet se deri në fund të muajit shkurt 2015, shuma e shlyer nga totali i detyrueshëm prej 212,500 lekë është 154, 500 lekë dhe detyrimi i mbetur është 58, 000 lekë, shumë e cila duhet të paguhet deri në datë 15.04.2015.

Bashkëlidhur: Faturë pagesë në BKT, datë 09.03.2015, e shumës 58, 000 lekë nga Xhavit Shala, për Qendrën e Studimeve Albanologjike tarifa e shkollimit, kësti 4, viti 2011 - 2012. Doktoraturë, shkenca histori.

Konkluzion:

- *Shpenzimet e deklaruara dhe të dokumentuara për arsimimin e subjektit dhe personave të lidhur, gjatë periudhës 2003 deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, rezultojnë në total rreth rreth 2, 780, 000 lekë.*
- *Shpenzime për pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat (sipas DIVA) në shumën totale rreth 593, 000 lekë.*

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES - AIDA SHALA DEKLARIMI I PASURIVE

Deklarimi i pasurisë

Bashkëshortja e subjektit të vlerësimit, Znj. Aida Shala, ka deklaruar pasuritë si më poshtë:

1. Ullishte me sipërfaqe 5, 444 m². Regjistruar në ZRPP Elbasan, Zona Kadastrale nr. ***, nr. pasurie ***, vol. 3, fq. 194. Burimi i krijimit: Pasuria është përfituar si trashëgimtare ligjore e babait Qazim Kuqashi, me vendim gjykate për çeljen e trashëgimisë ligjore nr. 4526, datë 25.04.2013. Babai këtë pronë e ka përfituar nga trashëgimia testamentare e gjyshit tim Alush Kuqashi, por edhe me Ligjin nr. 7501. Zotëron 1/3 ose 33.3%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë nr. ***, vol. 3, fq. 194, Zk. 8526, Elbasan, e llojit “Ullishte”, me sip. 5, 444 m², në emër të Aida Kuqashi, Brikena Kuqashi dhe Hatixhe Kuqashi, me pjesë takuese 1/3 secila, lëshuar në datë 22.01.2014. Bashkëlidhur, Harta treguese e regjistrimit.
- Certifikatë për vërtetim pronësie e pasurisë ullishte, me sip. 5, 444 m², në emër të Qazim Kuqashi.

- Vendim nr. 4526, datë 25.04.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë për trashëgimlënësin Qazim Kuqashi, duke caktuar si trashëgimtarë të tij: Hatixhe Kuqashi (b/shortja); Aida Shala (Kuqashi) e bija dhe Brikena Jazexhiu (Kuqashi), e bija.
- Vendim për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Testamentare nr. 3115 rep, nr. 1392, kol., datë 09.12.2020, për trashëgimlënësen Hatixhe Kuqashi. Konfirmohet se Hatixhe Kuqashi ka ndërruar jetë në datë 06.02.2020 dhe si trashëgimtare testamentare janë Aida Shala (Kuqashi) dhe Brikena Kuqashi, ku Aida Shala trashëgon pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimlënëses, përveç depozitave bankare të trashëgimlënëses. Brikena Kuqashi, trashëgon pasurinë e luajtshme në vlerë monetare në lekë ose valutë të huaj së bashku me interesat përkatëse në të gjitha bankat në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Procedura e vlerësimit:

ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan, me shkresën nr. ***, prot, datë 13.11.2023, nuk konfirmon pasurinë e deklaruar nga bashkëshortja e subjektit.

Në procesverbalin e datës 26.01.2024, subjekti ka sqaruar se ndoshta ka qenë lapsus nga ana e bashkëshortes në deklarin e pjesës takuese, pasi ajo ka përfitur edhe pjesën e nënës së saj në këto pasuri prej 1/3. Kjo, mbështetur në bazë të Vendimit të Lëshimit të Dëshmisë Testamentare nr. 3115, rep., nr. 1392, kol., datë 09.12.2020, ku, bashkëshortja e tij, Aida, trashëgon të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të nënës së saj, përjashtoj depozitat bankare deri në ditën e hartimit të testamentit. Ndërsa, vajza, Brikena, ka përfitur llogaritë /depozitat bankare që ka pasur nëna e saj deri ditën e hartimit të testamentit. Pra, si rrjedhojë e kësaj, bashkëshortja e tij në këto pasuri zotëron 66.6% ose 2/3 e tyre.

Për faktin e mos regjistrimit të tyre në ASHK, sqaroi se nga ana e tij është bërë kërkesë në E-Albania përpara dy viteve por deri tani nuk ka asnjë përgjigje.

Gjithashtu, sqaroi faktin se nuk e kanë parë edhe shumë të ngutshme regjistrimin e pjesës takuese të bashkëshortes në ASHK pasi për ta nuk përbën problem pasi ato i kanë në zotërim të dyja motrat.

Në procesverbalin e datës 02.02.2024, subjekti ka dorëzuar:

- Kërkesë në ASHK, datë 01.01.2021, nga Aida Shala, për regjistrimin e Aktit të Trashëgimisë.
- Aplikim për shërbimet e ASHK, për regjistrimin e Aktit të Trashëgimisë, datë 09.12.2020.

Konkluzion:

- *Subjekti ka deklaruar se nuk ka ende përgjigje nga ASHK, në lidhje me këtë kërkesë dhe aplikim të kryer nga bashkëshortja e tij.*
- *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.*
- *Pasuria është përfitur me trashëgimi ligjore nga babai dhe trashëgimi testamentare nga nëna e bashkëshortes. Pjesa takuese e bashkëshortes së subjektit është 2/3.*

2. Ullishte me sipërfaqe 238 m². Regjistruar në ZRPP Elbasan, Zona Kadastrale nr. ***, nr. pasurie ***, vol. 3, fq. 196. Burimi i krijimit: Pasuria është përfituar si trashëgimtare ligjore e babait Qazim Kuqashi, me vendim gjykate për çeljen e trashëgimisë ligjore nr. 4526, datë 25.04.2013. Babai këtë pronë e ka përfituar nga trashëgimia testamentare e gjyshit tim Alush Kuqashi, por edhe me Ligjin nr. 7501. Zotëron 66.6 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për vërtetim pronësie e pasurisë nr. ***, vol. 3, fq. 196, Zk. ***, Elbasan, e llojit “Ullishte”, me sip. 238 m², në emër të Aida Kuqashi, Brikena Kuqashi dhe Hatixhe Kuqashi, me pjesë takuese 1/3 secila, lëshuar në datë 22.01.2014.

Bashkëlidhur: Harta treguese e regjistrimit. Certifikatë për vërtetim pronësie e pasurisë ullishte, me sip. 238 m², në emër të Qazim Kuqashi.

- Vendim nr. 4526, datë 25.04.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë për trashëgimlënësin Qazim Kuqashi, duke caktuar si trashëgimtarë të tij: Hatixhe Kuqashi (b/shortja); Aida Shala (Kuqashi), e bija dhe Brikena Jazexhiu (Kuqashi) e bija.
- Vendim për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Testamentare nr. 3115 rep, nr. 1392 kol., datë 09.12.2020, për trashëgimlënësen Hatixhe Kuqashi. Konfirmohet se Hatixhe Kuqashi ka ndërruar jetë në datë 06.02.2020 dhe si trashëgimtare testamentare janë Aida Shala (Kuqashi) dhe Brikena Kuqashi, ku Aida Shala trashëgon pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimlënëses, përveç depozitave bankare të trashëgimlënëses. Brikena Kuqashi, trashëgon pasurinë e luajtshme në vlerë monetare në lekë ose valutë të huaj së bashku me interesat përkatëse në të gjitha bankat në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Procedura e vlerësimit:

ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan, me shkresën nr. ***, prot, datë 13.11.2023, nuk konfirmon pasurinë e deklaruar nga bashkëshortja e subjektit.

Në **procesverbalin e datës 26.01.2024**, subjekti ka sqaruar pjesën takuese të bashkëshortes, dhe ka paraqitur dokumentacion, trajtuar më sipër.

Konkluzion:

- *ASHK Elbasan, nuk konfirmon pasurinë e paluajtshme.*
- *Pasuria është përfituar me trashëgimi ligjore nga babai dhe trashëgimi testamentare nga nëna e bashkëshortes. Pjesa takuese e bashkëshortes së subjektit është 2/3.*

3. Ullishte me sipërfaqe 2, 777 m². Regjistruar në ZRPP Elbasan, Zona Kadastrale nr. ***, nr. pasurie ***, vol. 3, fq. 195. Burimi i krijimit: Pasuria është përfituar si trashëgimtare ligjore e babait Qazim Kuqashi, me vendim gjykate për çeljen e trashëgimisë ligjore nr. 4526, datë 25.04.2013. Babai këtë pronë e ka përfituar nga trashëgimia testamentare e gjyshit tim Alush Kuqashi, por edhe me Ligjin nr. 7501. Zotëron 66.6%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për vërtetim pronësie e pasurisë nr. ***, vol. 3, fq., 195, Zk. ***, Elbasan, e llojit “Ullishte”, me sip. 2, 777 m², në emër të Aida Kuqashi, Brikena Kuqashi dhe Hatixhe

Kuqashi, me pjesë takuese 1/3 secila, lëshuar në datë 22.01.2014. Bashkëlidhur, Harta treguese e regjistrimit.

- Certifikatë për vërtetim pronësie e pasurisë ullishte me sip. 2, 777 m², në emër të Qazim Kuqashi.
- Vendim nr. 4526, datë 25.04.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë për trashëgimlënësin Qazim Kuqashi, duke caktuar si trashëgimtarë të tij: Hatixhe Kuqashi (b/shortja); Aida Shala (Kuqashi), e bija dhe Brikena Jazexhiu (Kuqashi) e bija.
- Vendim për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Testamentare nr. 3115 rep, nr. 1392 kol., datë 09.12.2020, për trashëgimlënësen Hatixhe Kuqashi. Konfirmohet se Hatixhe Kuqashi ka ndërruar jetë në datë 06.02.2020 dhe si trashëgimtare testamentare janë Aida Shala (Kuqashi) dhe Brikena Kuqashi, ku Aida Shala trashëgon pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimlënëses, përveç depozitave bankare të trashëgimlënëses. Brikena Kuqashi, trashëgon pasurinë e luajtshme në vlerë monetare në lekë ose valutë të huaj së bashku me interesat përkatëse në të gjitha bankat në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Procedura e vlerësimit:

ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan, me shkresën nr. ***, prot, datë 13.11.2023, nuk konfirmon pasurinë e deklaruar nga bashkëshortja e subjektit.

Në procesverbalin e datës 26.01.2024, subjekti ka sqaruar pjesën takuese të bashkëshortes, dhe ka paraqitur dokumentacion, trajtuar më sipër.

Konkluzion:

- *ASHK Elbasan, nuk konfirmon pasurinë e paluajtshme.*
 - *Pasuria është përfituar me trashëgimi ligjore nga babai dhe trashëgimi testamentare nga nëna e bashkëshortes. Pjesa takuese e bashkëshortes së subjektit është 2/3.*
4. Shtëpi banimi, Lagja “****”, rr. “****”, nr. 16, Elbasan, me sip. truall 183, 8 m² dhe sip. ndërtimi 98.4 m². Regjistruar në ZVRPP Elbasan, Zk.***, nr. pasurie ***, vol. 29, fq. 85. Burimi i krijimit: Pasuria është përfituar si trashëgimtare ligjore e babait Qazim Kuqashi, me vendim gjykate për çeljen e trashëgimisë ligjore nr. 4526, datë 25.04.2013. Zotëron 66.6 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për vërtetim pronësie, për pasurinë me nr. ***, vol. 29, fq. 85, Zk. ***, Elbasan, e llojit Truall, me sip. 183.8 m², nga e cila, ndërtesë me sip. 98.4 m² në emër të Qazim Kuqashi, lëshuar në datë 01.02.2008. Bashkëlidhur: Harta treguese e regjistrimit.
- Vendim nr. 4526, datë 25.04.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë për trashëgimlënësin Qazim Kuqashi, duke caktuar si trashëgimtarë të tij: Hatixhe Kuqashi (b/shortja), Aida Shala (Kuqashi), e bija dhe Brikena Jazexhiu (Kuqashi) e bija.
- Vendim për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Testamentare nr. 3115, rep, nr. 1392 kol., datë 09.12.2020, për trashëgimlënësen Hatixhe Kuqashi. Konfirmohet se Hatixhe Kuqashi ka ndërruar jetë në datë 06.02.2020 dhe si trashëgimtare testamentare janë Aida

Shala (Kuçashi) dhe Brikena Kuqashi, ku Aida Shala trashëgon pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimlënëses, përveç depozitave bankare të trashëgimlënëses. Brikena Kuqashi, trashëgon pasurinë e luajtshme në vlerë monetare në lekë ose valutë të huaj së bashku me interesat përkatëse në të gjitha bankat në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Procedura e vlerësimit:

ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan, me shkresën nr. ***, prot, datë 13.11.2023, nuk konfirmon pasurinë e deklaruar nga bashkëshortja e subjektit.

Në **procesverbalin e datës 26.01.2024**, subjekti ka sqaruar pjesën takuese të bashkëshortes, dhe ka paraqitur dokumentacion, trajtuar më sipër.

Konkluzion:

- *ASHK Elbasan, nuk konfirmon pasurinë e paluajtshme.*
 - *Pasuria është përfituar me trashëgimi ligjore nga babai dhe trashëgimi testamentare nga nëna e bashkëshortes. Pjesa takuese e bashkëshortes së subjektit është 2/3.*
5. Llogari bankare, nr. 010***946, në Raiffeisen Bank Tiranë, me balancë në datë 15.02.2023, në shumën 66, 000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga si shefe e Sektorit të Ruajtjes së Fondeve në AIDSSH. Zotëron 100%.

Procedura e vlerësimit:

Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 18.09.2023, konfirmon llogari page në emër të Aida Shala, me balancë në datë 17.02.2023, shumën 491 lekë. Overdraft me balancë -65, 000 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë bankare të personit të lidhur me subjektin e vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezulton se ***deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e Raiffeisen Bank.***

6. Tokë arë me sipërfaqe 6, 000 m². Regjistruar në ZRPP Elbasan, Zona Kadastrale nr. ***, nr. pasurie ***, vol. 9, fq. 51. Burimi i krijimit: Përfituar me testamentin nr. 733, datë 23.06.2009 dhe Vendim Gjykate “Për çeljen e trashëgimisë testamentare nr. 1352 (2445), datë 09.06.2010. Babai këtë pronë e ka përfituar nga trashëgimia testamentare e gjyshit tim Alush Kuqashi, por edhe me Ligjin nr. 7501. Zotëron 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për vërtetim pronësie, për pasurinë me nr. ***, vol. 9, fq. 51, Zk. ***, Elbasan, e llojit “Arë”, me sip. 6, 000 m² në emër të Aida Shala dhe Brikena Jazexhi, lëshuar në datë 09.07.2012. Bashkëlidhur, harta treguese e regjistrimit.
- Testament nr. 733, datë 23.06.2009 nga Qazim Kuqashi, i cili i ka lënë trashëgimi vajzave të tij Aida Kuqashi, bashkëshorte e Xhavit Shala dhe Brikena Kuqashi, në pjesë të barabarta, një arë në sinurin Belerbej, me sipërfaqe 6 dynym dhe 28 dru ullinj, sipas

vërtetimit të Zyrës së Hipotekave Elbasan nr. 186, datë 02.02.1994 dhe të aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. 78, i regjistruar në datë 20.04.1998 të Komisionit të Tokës.

- Vendim për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Testamentare nr. 1352, datë 09.06.2010, për trashëgimlënësin Qazim Kuqashi. Konfirmohet se Qazim Kuqashi ka ndërruar jetë në datë 29.03.2010 dhe si trashëgimtarë testamentare janë Aida Shala dhe Brikena Kuqashi, duke trashëguar nga 50 % pjesë secila, për pasuritë arë, që ndodhet në ngastrat me nr. 153/2 dhe 155/1, në lagjen Belerbej, qyteti Elbasan, me sip. 6, 000 m².

Procedura e vlerësimit:

ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan, me shkresën nr. ***, prot, datë 13.11.2023, konfirmon në emër të Aida Shala pasurinë nr. 153/7, e llojit “Arë”, me sip. 6, 000 m², e ndodhur në Zk. ***, Elbasan, e regjistruar në vol. 9, fq. 511, e përfituar sipas Dëshmisë së Trashëgimisë nr. 1352, Vendimi datë 09.06.2010 të Gjykatës Elbasan. Bashkëlidhur:

- Kartela e Pasurisë së Paluajtshme e pasurisë me nr. ***, e llojit “Arë”, me sip. totale 6, 000 m², në emër të Aida Shala dhe Brikena Jazexhiu, e regjistruar në datë 09.07.2012.
- Kartela e pasurisë së paluajtshme “Arë”, me sip. 6, 427 m², me nr. pasurie ***, Zk. ***, Elbasan, në emër të Aida Shala dhe Brikena Jazexhiu, regjistruar në datë 07.01.2013, në bazë të AMTP, nr.78, Belerbej, 384, me status “Mbyllur”.
- AMTP nr. regjistrimi 78, ku konfirmohet se në mbështetje të “Ligjit për Tokën” nr. 7501, datë 19.07.1991, familjes së Alush Kuqashi i jepet në pronësi 6, 000 m² tokë ndodhur në Belerbej, Elbasan.
- Vendim nr. 1212, rep, nr. 972 kol., datë 27.06.2002, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për lëshim dëshmie trashëgimie, për trashëgimlënësin Alush Kuqashi dhe Aida Kuqashi, ku konfirmohet se si trashëgimtar testamentar i vetëm i tyre është përcaktuar djali i tyre Qazim Kuqashi.
- Vendim për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Testamentare nr. 1352, datë 09.06.2010, për trashëgimlënësin Qazim Kuqashi. Konfirmohet se Qazim Kuqashi ka ndërruar jetë në datë 29.03.2010 dhe si trashëgimtarë testamentare janë Aida Shala dhe Brikena Kuqashi, duke trashëguar nga ½ pjesë secila, për pasuritë arë, që ndodhen në ngastrat me nr. 153/2 dhe 155/1, në lagjen Bejlerbe, qyteti Elbasan, me sip. 6, 000 m².

Konkluzion:

- ***Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK.***
 - ***Pasuria është përfituar me trashëgimi testamentare nga babai i bashkëshortes.***
7. Apartament + papafingo dhe dy garazhe të ndodhura në rr. “****”, nr. 82, Tiranë. Është në proces legalizimi. Kjo pasuri, 50% të së cilës e zotëroj unë dhe 50 % bashkëshorti, ka qenë deklaruar në proces legalizimi në deklaratimet e vitit 2016. Burimi i krijimit: Pasuria është përfituar me testamentin nr. 131, datë 09.06.2008. **Trajtuar më sipër.**

Deklarimi i të ardhurave nga personi i lidhur me subjektin e vlerësimit

- ❖ Të ardhura nga funksioni i mësueses në shkollën e mesme të fshatit Shushicë për periudhën gusht 1987 - gusht 1991, sipas listës së pagesave të kohës në shumën 31, 680 lekë.

- ❖ Të ardhura nga funksioni i specialistes së Bërthamës Shkencore të Gjuhësisë në Seksionin e Arsimit Elbasan për periudhën shtator 1991 - nëntor 1992, në shumën 8, 494 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni si mësuese dhe nëndrejtoreshë në gjimnazin “Ahmet Dakli” dhe “Kostandin Kristoforidhi”, Elbasan, për periudhën gusht - nëntor 1992, nëntor 1999, referuar Vërtetimit të Drejtorisë Arsimore Elbasan të datë 24.04.2018, në shumën 617, 929 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i redaktore e korrektore letrare në Revistën “Policia Sot” dhe specialistes në Sektorin e Arkivit të MPB për periudhën qershor 2000 - prill 2005, gjithsej 1, 634, 109 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni si specialiste në sektorin e Arkivit të MPB, më pas Drejtorja e Arkivit të MPB, për periudhën maj 2005 - mars 2017, në shumën 7, 036, 131 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i Shefe e Sektorit të Ruajtjes së Fondeve në AIDSSH, për periudhën mars 2017 - janar 2023, në shumën 5, 665, 988 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Vërtetim** nga ISSH, Drejtoria Rajonale Elbasan, ku konfirmohet fillimi i marrëdhënieve të punës në datë 01.01.1988 deri në 31.12.1990, për Aida Kuqashi.
- **Vërtetim** datë 25.04.2018 nga Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan, ku konfirmohen të ardhurat nga paga për Aida Shala për periudhën 16.09.1991 - 15.11.1992, por në librin e pagave, nuk ka informacion për periudhën nëntor 1991 - gusht 1992, pasi libri i këtij viti shkollor mungon. Sipas të ardhurave të dokumentuara rezultojnë për periudhën 16.09.1991 - 15.11.1992, në shumën neto 7, 494 lekë.
- **Vërtetim** për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, për Aida Shala, për periudhën 16.11.1992 - 12.11.1999, në shumën neto 616, 160 lekë.
- **Vërtetim** i datës 06.02.2020 nga Ministria e Brendshme, ku konfirmohen të ardhurat nga paga e Aida Shala për periudhën 01.06.2000 - 01.05.2005, në shumën totale neto 1, 649, 607 lekë.
- **Vërtetim** nr. 108 prot., datë 17.04.2010, ku konfirmohen kreditimet në llogarinë e Aida Shala për periudhën 2005 - 2018.
- **Vërtetim** nr. 317 prot., datë 23.04.2018. nga Autoriteti për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, ku konfirmohen të ardhurat nga paga për Aida Shala për periudhën mars 2017 - mars 2018, në shumën 1, 008, 582 lekë, si dhe të ardhura nga dieta në shumën 35, 952 lekë.
- **Vërtetim** nr. 133 prot., datë 30.01.2020, nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, ku konfirmohen të ardhurat nga paga për Aida Shala për vitet 2017 - 2019, në shumën totale 2, 696, 991 lekë.
- **Vërtetim** nr. 341, prot., datë 15.02.2023, nga Autoriteti për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, ku konfirmohen të ardhurat nga paga për Aida Shala për periudhën prill 2018 - 2023, në shumën 4.270.263 lekë.

Procedura e vlerësimit:

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli për të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur me subjektin e vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, nga ku rezulton se:

Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 18.09.2023, konfirmon të ardhurat nga paga për Aida Shala për periudhën prill 2005 - janar 2023, në shumën totale 11, 703, 787 lekë dhe 1, 574 euro.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), me shkresën nr. ***, prot., datë 19.09.2023, konfirmon kontributet e derdhura për Aida Shala për periudhën dhjetor 2012 - mars 2017 nga Aparati i Ministrisë së Brendshme dhe për periudhën mars 2017 - gusht 2023 nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Nga muaji nëntor 2022, përfiton pension invaliditeti të pjesshëm me masë mujore aktuale 17, 371 lekë.

ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. ***, prot., datë 22.09.2023, konfirmon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave, për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet juridike apo fizike, nuk mund të konfirmojnë periudhën kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës.

Konkluzion:

- *Të ardhurat neto nga pagat e bashkëshortes, për periudhën shtator 1991 - shkurt 2023, rezultojnë në shumën rreth 14, 159, 000 lekë.*

DEKLARIMI I DJALIT - EROS SHALA DEKLARIMI I PASURIVE

Deklarimi i pasurisë

Djali i subjektit të vlerësimit, Z. Eros Shala, në pasqyrën e deklarimit të pasurive dhe burimit të krijimit, ka deklaruar pasuritë si më poshtë:

1. Automjet marka Volkswagen, targa AA *** ZS, nr. shasio WV***33254, modeli Golf 5, ngjyra gri, tipi benzinë + gaz, vit prodhimi 2004, data e regjistrimit 25.11.2021, data e blerjes 25.11.2021. Vlera 4, 200 euro. Burimi i krijimit: Automjeti është blerë me të ardhura nga paga. Zotëron 100 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje pasuri e luajtshme nr. 2695, rep., nr. 863 kol., datë 25.11.2021. Automjet Volkswagen Golf, me targë AA *** ZS, në vlerën 4, 200 euro. Palë blerëse Eros Shala.

Procedura e vlerësimit:

DPSHTRR, me shkresën nr, ***, prot., datë 25.09.2023, konfirmon se Eros Shala ka në pronësi automjetin me targë AA *** ZS. Bashkëlidhur:

- Kontratë blerje automjeti nr. 2695, rep., nr. 863 kol., datë 25.11.2021, Automjet Volkswagen Golf me targë AA *** ZS, në vlerën 4, 200 euro. Palë blerëse Eros Shala.

Trupa e Vlerësimit ka konstatuar se nga llogaria pranë Credins Bank janë debituar nga Eros Shala 530, 000 lekë.

Në shpjegimet e datës 17.04.2024, subjekti i vlerësimit, ka sqaruar se kjo shumë është tërhequr nga djali i tij, me qëllim blerjen e automjetit tip Golf 5 me targë AA *** ZS, në vlerën 4, 200 euro.

Me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për kursimin e shumës prej 4, 200 euro për blerjen e automjetit tip Volkswagen në vitin 2021, Trupa e Vlerësimit kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi (Aneksi 1).

Konkluzion:

- ***Konstatohet se, automjeti është blerë në vitin 2021 në shumën 4, 200 euro, me burim nga të ardhurat nga paga.***
 - ***Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.***
 - ***Personi i lidhur me subjektin e vlerësimit, ka pasur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme me qëllim blerjen e automjetit në vitin 2021.***
2. Llogari page individuale në Credins Bank, me balancë në datë 20.02.2023, shumën 1, 163, 475 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga, shuma 981, 493 lekë. Të ardhura nga paga si Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA). Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Credins Bank datë 20.02.2023, në emër të Eros Shala, ku konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën shkurt 2021 - janar 2023. Balanca e llogarisë në datë 20.02.2023, në shumën 1, 163, 475 lekë.

Procedura e vlerësimit:

Credins Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 12.10.2023, konfirmon llogari page në emër të Eros Shala, me balancë në datë 17.02.2023, shumën 1, 164, 775 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë bankare të personit të lidhur me subjektin e vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezulton se ***deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e Credins Bank.***

Gjithashtu referuar analizës financiare përkatëse (Aneksi 1), rezulton se personi i lidhur me subjektin e vlerësimit, ka pasur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme me qëllim kursimin e vlerës prej 1, 164, 775 lekë, në vitin 2023.

3. Depozitë Individuale në Credins Bank, me balancë në datë 20.02.2023, në shumën 1, 200, 000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga si Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA). Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Detajet e llogarisë në emër të Eros Shala nga Credins Bank datë 20.02.2023, ku konfirmohet depozitë me afat, çelur në datë 10.04.2020, me datë maturimi 10.04.2023, në shumën 1, 200, 000 lekë.

Procedura e vlerësimit:

Credins Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 12.10.2023, konfirmon depozitë në emër të Eros Shala, hapur në datë 10.04.2020, në shumën 1, 200, 000 lekë, me balancë në datë 17.02.2023, shumën 1, 200, 000 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë bankare të personit të lidhur me subjektin e vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezulton se ***deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e Credins Bank.***

Në shpjegimet e datës 17.04.2024, subjekti i vlerësimit është shprehur se djali i tij jeton me ta, dhe nuk ka pasur nevojë të harxhojë për të përballuar koston e jetesës (të ushqyerit). Ata e kanë inkurajuar që ai të kursejë të ardhurat e siguruar prej tij.

Referuar analizës financiare përkatëse (Aneksi 1), rezulton se personi i lidhur me subjektin e vlerësimit, ka pasur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme me qëllim kursimin e vlerës prej 1, 200, 000 lekë, në vitin 2020.

4. Llogari rrjedhëse në Credins Bank, me balancë në shumën 18, 339 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga norma e interesit të depozitës bankare. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Detajet e llogarisë në emër të Eros Shala nga Credins Bank datë 20.02.2023. Konfirmohet llogari rrjedhëse, çelur në datë 10.04.2020, me balancë në shumën 18, 339 lekë.

Procedura e vlerësimit:

Credins Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 12.10.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Eros Shala, me balancë në datë 17.02.2023, shumën 18, 339 lekë.

Konkluzion:

- ***Konstatohet se llogaria është krijuar gjatë periudhës prill 2021 - shkurt 2023, ku kanë kaluar interesat e depozitës në shumën totale 18, 339 lekë.***
- ***Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Bank.***

Deklarimi i të ardhurave nga personi i lidhur me subjektin e vlerësimit

- ❖ Të ardhura nga funksioni i specialistit në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) për periudhën gusht 2016 - shkurt 2023, në shumën 5, 764, 021 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. 514, prot., datë 04.02.2020, nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), ku konfirmohen të ardhurat për Eros Shala, për periudhën gusht 2016 - dhjetor 2019, në shumën totale 2, 803, 044 lekë.
- Vërtetim nr. 1020 prot., datë 27.02.2023, nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), ku konfirmohen të ardhurat për Eros Shala për periudhën prill 2018 - shkurt 2023. Të ardhurat për periudhën janar 2020 - shkurt 2023, në shumën 2, 905, 207 lekë.

Procedura e vlerësimit:

Credins Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 12.10.2023, konfirmon kreditimin e pagës, dieta dhe shpërblime për Eros Shala nga AMA, për periudhën gusht 2016 - shkurt 2023, në shumën totale 7, 009, 512 lekë.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), me shkresën nr. ***, prot., datë 19.09.2023, konfirmon kontributet e derdhura për Eros Shala për periudhën gusht 2016 - korrik 2023 nga AMA.

ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. ***, prot., datë 22.09.2023, konfirmon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave, për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet juridike apo fizike, nuk mund të konfirmojnë periudhën e kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës.

Konkluzion:

- *Të ardhurat neto nga pagat dhe shpërblimet e djalit Eros Shala, për periudhën gusht 2016 - shkurt 2023, rezultojnë në total në shumën rreth 7, 010, 000 lekë.*

DEKLARIMI I DJALIT - ASTRIT SHALA DEKLARIMI I PASURIVE

Deklarimi i pasurisë

Djali i subjektit të vlerësimit, Z. Astrit Shala, në pasqyrën e deklarimit të pasurive dhe burimit të krijimit, ka deklaruar pasuritë si më poshtë:

1. Automjet Toyota me targë AA *** TT, nr. shaspie JTMB***9716, modeli RAV4, ngjyra e zezë, tipi naftë. Vit prodhimi 2007, data e regjistrimit 09.05.2018. Data e blerjes 08.05.2018, me kontratë nr. 512, rep., nr. 296, kol., në shumën 900, 000 lekë.

Burimi i krijimit: Automjeti është blerë me kredi bankare në lekë nga Intesa SanPaolo Bank, marrë më 08.05.2018, në shumën 1, 000, 000, për blerje makine. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje pasuri e luajtshme nr. 512, rep, nr. 296 kol., datë 08.05.2018, automjet Toyota Rav 4, me nr. shaspie JTMB***9716, në shumën 900, 000 lekë. Palë blerëse Astrit Shala.
- Kontratë kredi bankare datë 02.05.2018, me palë kredidhënëse Intesa Sanpaolo Bank dhe kredimarrës Astrit Shala. Shuma 1, 000, 000 lekë, afati 3 vjet.

Procedura e vlerësimit:

DPSHTRR, me shkresën nr. ***, prot. datë 25.09.2023, konfirmon se Astrit Shala ka në pronësi automjetin me targë AA *** TT. Bashkëlidhur:

- Kontratë blerje automjeti nr. 512, rep. nr. 296, kol., datë 08.05.2018, automjet Toyota Rav 4, me nr. shasio JTMB***9716, në shumën 900, 000 lekë. Palë blerëse Astrit Shala.

Intesa SanPaolo Bank, me shkresën *** prot., datë 26.09.2023, konfirmon kredi në emër të Astrit Shala, për periudhën 07.05.2018 - 07.05.2021. Nga nxjerrja e llogarisë rezulton disbursim kredie në datë 07.05.2018, në shumën 1, 000, 000 lekë, për blerje makine.

Gjithashtu nga këqyrja e kontratës së kredisë nënshkruar ndërmjet institucionit bankar dhe shtetasit Astrit Shala më datë 02.05.2018, përcaktohet shuma e kredisë 1, 000, 000 lekë, me afat 3 vjeçar, kësti rreth 30, 000 lekë në muaj, ku përfshihet principali së bashku me interesin. Shuma e paguar në total për periudhën 2018 – 2021 rreth 1, 073, 232 lekë, (357, 720.48 lekë për çdo vit).

Konkluzion:

- *Konstatohet se automjeti me targa AA *** TT, është blerë në vitin 2018, me burim nga kredia në Intesa Sanpaolo Bank.*
 - *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e DPSHTRR dhe Intesa SanPaolo Bank.*
 - *Referuar analizës financiare, personi i lidhur me subjektin e vlerësimit, ka pasur të ardhura të mjaftueshme me qëllim pagesën e kësteve të kredisë për blerjen e automjetit.*
2. Llogari bankare në lekë nr. 367***101 në Intesa SanPaolo Bank Albania, Tiranë, me balancë në datë 14.02.2023, në shumën 306, 167.74 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga si punonjës i Ambasadës së SHBA-së Tiranë. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Intesa SanPaolo Bank në emër të Astrit Shala, me balancë në datë 14.02.2023, në shumën 306, 169 lekë.
- Nxjerrje llogarie nga Intesa SanPaolo Bank në emër të Astrit Shala, ku konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën 06.06.2008 - 18.08.2023.

Procedura e vlerësimit:

Intesa SanPaolo Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 26.09.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Astrit Shala, me balancë në datë 17.02.2023, në shumën 74, 636 lekë.

(Sipas nxjerrjes së llogarisë rezulton gjendja e llogarisë në datë 14.02.2023, në shumën 306, 000 lekë. Transferuar shuma 306, 000 lekë në llogarinë në monedhën usd, në datë 15.02.2023 dhe kreditimi i pagës në datë 17.02.2023, në shumën 74, 467 lekë).

Konkluzion:

- *Diferenca midis shumës së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka si rezultat i paraqitjes në dy data të ndryshme dhe konkretisht deklarimi i përket datës 14.02.2023, kërkesa dhe përgjigjet e bankës i përkasin datës 17.02.2023.*
 - *Referuar analizës financiare, personi i lidhur me subjektin e vlerësimit, ka pasur të ardhura të mjaftueshme me qëllim kursimin e vlerës prej 306, 169 lekë në datë 14.02.2023.*
3. Llogari bankare në lekë C010***71 në Credins Bank Tiranë, me balancë në datë 14.02.2023, në shumën 0 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga si punonjës i Ambasadës së SHBA-së Tiranë. Zotëron 100%

Procedura e vlerësimit:

Credins Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 12.10.2023, konfirmon llogari page në emër të Astrit Shala, me balancë në datë 17.02.2023, shumën -3, 383 lekë. Konstatohet se, llogaria është krijuar gjatë periudhës 2015 - 2023.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë bankare të personit të lidhur me subjektin e vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezulton se *deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e Credins Bank.*

4. Llogari bankare në euro nr. 367***101 në Intesa SanPaolo Bank Albania, Tiranë, me balancë në datë 14.02.2023, në shumën 1, 693.24 euro.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga si punonjës i Ambasadës së SHBA-së Tiranë. Zotëron 100%

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Intesa SanPaolo Bank në emër të Astrit Shala, me balancë në datë 14.02.2023, në shumën 1, 693.24 euro.

Procedura e vlerësimit:

Intesa SanPaolo Bank, me shkresën nr. ***, prot. datë 26.09.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Astrit Shala në monedhën euro, me balancë në datë 17.02.2023, në shumën 845 euro. Sipas nxjerrjes së llogarisë rezulton gjendja e llogarisë në datë 13.02.2023, në shumën 1, 693 euro. Tërhequr shuma 850 euro më datë 17.02.2023 dhe balanca e mbetur 843 euro.

Konkluzion:

- *Konstatohet se llogaria është krijuar gjatë periudhës shkurt 2020 - shkurt 2023.*
- *Diferenca midis shumës së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka si rezultat i paraqitjes në dy data të ndryshme dhe konkretisht deklarimi i përket datës 14.02.2023, kërkesa dhe përgjigjet e bankës i përkasin datës 17.02.2023.*

5. Llogari bankare në dollarë nr. 3678***02 në Intesa SanPaolo Bank Albania, Tiranë. me balancë në datë 14.02.2023, në shumën 10, 244.12 usd. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga si punonjës i Ambasadës së SHBA-së në Tiranë. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Intesa SanPaolo Bank në emër të Astrit Shala, me balancë në datë 14.02.2023, në shumën 10, 244 usd.

Procedura e vlerësimit:

Intesa SanPaolo Bank, me shkresën nr.***, prot., datë 26.09.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Astrit Shala në monedhën usd, me balancë në datë 17.02.2023, në shumën 12, 614 usd. (Sipas nxjerrjes së llogarisë rezulton gjendja e llogarisë në datë 14.02.2023, në shumën 10, 244 usd. Transferuar shuma 2, 828 usd nga llogaria në monedhën lekë në datë 15.02.2023).

Konkluzion:

- *Konstatohet se llogaria është krijuar gjatë periudhës shkurt 2020 - shkurt 2023.*
- *Diferenca midis shumës së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka si rezultat i paraqitjes në dy data të ndryshme dhe konkretisht deklarimi i përket datës 14.02.2023, kërkesa dhe përgjigjet e bankës i përkasin datës 17.02.2023.*
- *Referuar analizës financiare, personi i lidhur me subjektin e vlerësimit, ka pasur të ardhura të mjaftueshme me qëllim kursimin e vlerës prej 10, 244 usd në datë 14.02.2023.*

6. Llogari bankare në dollar nr. 3678***001 në Intesa SanPaolo Bank Albania Tiranë, me balancë në datë 14.02.2023, në shumën 1.86 dollar. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga si punonjës i Ambasadës së SHBA-së në Tiranë. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Intesa SanPaolo Bank në emër të Astrit Shala, me balancë në datë 14.02.2023, në shumën 1.86 euro.

Procedura e vlerësimit:

Intesa SanPaolo Bank me shkresën nr. ***, prot., datë 26.09.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Astrit Shala në monedhën euro, me balancë në datë 17.02.2023, në shumën 1.86 euro.

Me e-mailin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se llogaria bankare e Astrit Shalës nr. 3678***001 në Intesa SanPaolo Bank Tiranë është me gjendjen 1.86 euro dhe jo dollar.

Konkluzion:

- *Konstatohet se, llogaria është krijuar gjatë periudhës shtator 2016 - janar 2017.*
- *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e Intesa SanPaolo Bank.*

Deklarimi i të ardhurave nga personi i lidhur me subjektin e vlerësimit

- ❖ Të ardhura në total nga puna si punonjës i Kompanisë ICTS Albania sh.p.k., për periudhën 06.06.2008 - 10.11.2014, sipas statementit të Intesa SanPaolo Bank datë 17.04.2018, në shumën 2, 916, 744 lekë.
- ❖ Të ardhura në total nga puna si punonjës në Ambasadën e SHBA-së Tiranë, për periudhën 01.11.2014 - 15.02.2023, sipas statementit të Intesa SanPaolo Bank datë 17.04.2018, për periudhën 01.11.2014 - 15.02.2023, në shumën 14, 532, 671 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Intesa SanPaolo Bank në emër të Astrit Shala, ku konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën 06.06.2008 - 18.08.2023.

Procedura e vlerësimit:

BKT me shkresën nr. ***, prot., datë 19.09.2023, konfirmon të ardhura nga paga për Astrit Shala për periudhën nëntor 2007 - prill 2008, në shumën 102, 000 lekë. Llogaria është mbyllur në datë 18.05.2012.

Intesa San Paolo Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 26.09.2023, konfirmon të ardhurat nga paga për Astrit Shala për periudhën maj 2008 - shkurt 2023, në shumën totale 16, 040, 851 lekë. Nga llogaria në euro konfirmohen të ardhura në shumën 3, 200 euro (në datë 08.09.2016).

Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), me shkresën nr. ***, prot., datë 19.09.2023, konfirmon kontributet e derdhura për Astrit Shala për periudhën janar 2012 - tetor 2014 nga ICTS Albania - Integrated Services dhe nga nëntor 2014 - prill 2023 nga Ambasada SH.B.A.

ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. 69/30c, prot., datë 22.09.2023, konfirmon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave, për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet juridike apo fizike, nuk mund të konfirmojnë periudhën e kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës.

Konkluzion:

- *Të ardhurat neto nga paga e djalit Astrit Shala për periudhën nëntor 2007 – shkurt 2023 rezultojnë në shumën rreth 16, 513, 000 lekë.*

DETYRIME FINANCIARE

1. Kthim kredie bankare marrë nga Intesa SanPaolo Bank më 08.05.2018, në shumën 1, 000, 000 lekë, për blerje makine. Shuma e kthyer në total me gjithë interesa 1.073.232 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë kredie konsumatore datë 02.05.2018 në Intesa SanPaolo Bank, me kredimarrës Astrit Shala, në shumën 1, 000, 000 lekë, me qëllim blerje makine, me afat 36 muaj (07.05.2018 - 07.05.2021).

- Amortizim kredie, disbursuar në datë 07.05.2018 - 07.05.2021, në shumën 1, 000, 000 lekë.
- Vërtetim nga Intesa SanPaolo Bank datë 27.07.2022, ku konfirmohet mbyllja e kredisë së marrë nga Astrit Shala në datë 07.05.2021 dhe nuk ka asnjë marrëdhënie kredie me Intesa SanPaolo Bank.

Procedura e vlerësimit:

Intesa San Paolo Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 26.09.2023, konfirmon kredi në emër të Astrit Shala, për periudhën 07.05.2018 - 07.05.2021. Nga nxjerrja e llogarisë rezultojnë disbursim kredie në datë 07.05.2018, në shumën 1, 000, 000 lekë, për blerje makine.

Konkluzion:

- *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Intesa SanPaolo Bank.*

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

- Shpenzime për vitin e fundit, periudha janar - dhjetor 2022, në shumën 592, 032 lekë, nga të cilat, për ujë 27, 461 lekë, për drita 64, 171 lekë, për internet 24, 000 lekë dhe për shërbim celular 20, 400 lekë, qira banese 456, 000 lekë.

Procedura e vlerësimit:

Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU), me shkresën nr. ***, prot., datë 25.09.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Astrit Shala, identifikohen 3 abonentë me kontratë furnizimi nr. DU2C***66216, në instancën Shijak, me nr. DU2***64114610, në instancën Shijak: nr. DUOA***2508, në instancën Durrës.

Shoqëria Rajonale Ujësjetës - Kanalizime Durrës, me shkresën nr.***, prot, datë 27.09.2023, konfirmon 1 kontratë në emër të Astrit Shala, me adresë Katund i Ri, Durrës, me nr. 703***. Shuma e paguar për vitin 2022, rreth 2, 160 lekë.

14 Shoqëritë Rajonale të Ujësjetës - Kanalizime, me shkresat nr. 5/34a, 5/46a, prot., nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Vodafone Albania sh.a, me shkresën nr. ***, prot, datë 15.11.2023, konfirmon se në emër të Astrit Shala, figurojnë të regjistruara 4 numra telefoni, nga të cilët, 2 prej tyre me status inaktiv nga data 23.12.2020. Një numër me status aktiv, i cili është bartur më datë 10.03.2022 në rrjetin e shoqërisë Vodafone Albania sha. Shuma e paguar për vitin 2022, rreth 14, 850 lekë. Një numër me status aktiv, aktivizuar në datë 25.08.2023 (pas kohës së dorëzimit të deklaratës).

Në emër të Astrit Shala nuk korrespondon asnjë kontratë telefonike fiks apo interneti në shoqërinë Vodafone Albania.

One Albania sh.a, me shkresën nr. ***, prot. datë 11.10.2023, konfirmon se në emër të Astrit Shala, rezultojnë i regjistruar numri One Albania +35567635***5 dhe nga data 01.01.2022 deri në 31.12.2022 ka paguar 15, 800 lekë.

Albania Satellite Communications shpk, me shkresën nr. 69/50a, prot., datë 29.09.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Abissnet sh.a, me shkresën nr. V-prot, datë 09.02.2024, konfirmon se Astrit Shala, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 ka qenë palë në kontratat e shërbimit të internetit, datë 02.10.2021 dhe 06.11.2022, ku faturimi total i pagesave për këtë shërbim është 21, 800 lekë.

Digicom sh.a, me shkresën nr. ***, prot, datë 20.09.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Me e-mailin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se Astrit Shala, si qiraxhi, disponon si dokumente librezë me UK me nr. kontratë nr. 3 -E6197***, librezë me FSHU me nr. kontratë O-626*** të TR-1 si dhe shpenzimet e internetit për vitin 2022. Astrit Shala, i biri i Xhavitit dhe i Aidës, i datëlindjes 06.05.1988, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë nuk ka asnjë lidhje me abonentët me të njëjtin emër, me kontrata nr. DU2C****662116, nr. DU2C***4114610 në Shijak si dhe nr. DU2C****002508 në Durrës, të konfirmuara nga FSHU (por pa atësi). Gjithashtu, Astrit Xhavit Shala, nuk ka asnjë lidhje me abonentin me të njëjtin emër, por pa atësi, me nr. kontrate 7032***, në Katundin e Ri, Durrës, të konfirmuara nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime, Durrës. Këtë e konfirmon me kërkesën nr. Xh-29, prot, datë 09.11.2023, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, përgjigjes së kësaj drejtorie me nr. Xh-29/1, prot., datë 10.11.2023 si dhe të raportit nga regjistri kombëtar i gjendjes civile, ku vërtetohet se në Shqipëri figuron vetëm një shtetas me të dhënat: Astrit Shala, lindur në Elbasan më datë 06.05.1988, ndërkohë që, vetëm me këtë emër e mbiemër, por me atësi tjetër, figurojnë 11 shtetas në Shqipëri, dy nga të cilët nga Katundi i Ri-Durrës.

Subjekti ka dorëzuar:

- Kopje libreze me UKT, nr. kontratë 3-E6197***, në emër të J. J. Shuma e paguar për vitin 2022 rreth 21, 472 lekë (janë vulosur pagesat e muajit nëntor dhe dhjetor por nuk është shënuar shuma).
- Kopje libreze me OSHEE, nr. kontratë 0-626*** të TR-1, në emër të J. J. Shuma e paguar për vitin 2022 rreth 64, 171 lekë.
- Tabelë e pagesave të Abissnet sh.a për periudhën maj 2022 - gusht 2023, ku konfirmohet se shuma e paguar për periudhën maj 2022 - tetor 2022 rreth 1, 800 lekë/muaj dhe nga dhjetor 2022 në shumen 19, 000 lekë/muaj.
- Kërkesë nr. Xh-29, prot, datë 09.01.2023, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, për marrje dokumentacioni, ku të vërtetohet se me gjeneralitetet e tij dhe të djalit të tij Astrit Shala nuk ka njeri tjetër në Shqipëri.
- Kthim përgjigje nga Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me nr. Xh-29/1, prot, datë 10.11.2023, ku konfirmohet se me të dhënat e paraqitura Xhavit Shala, lindur në Qerret, Durrës, më datë 07.08.1961, figuron të jetë regjistruar vetëm një shtetas. Me të dhënat Astrit Shala, lindur në Elbasan, më datë 06.05.1988 figuron të jetë i regjistruar vetëm një shtetas. Me të dhënat Astrit Shala (emër, mbiemër), figurojnë të regjistruar 11 shtetas.
- Raporti nga regjistri kombëtar i gjendjes civile datë 11.11.2023, ku vërtetohet se me të dhënat Astrit Xhavit Shala, i datëlindjes 06.05.1988, figuron vetëm një person me adresë banimi në Tiranë, 1016, Njësia Bashkiake nr. 9, D. B, 16, 28. Personat e tjerë me emër dhe mbiemër të njëjtë Astrit Shala, me adresë në Durrës, Katund i Ri, në Durrës dhe në Rrashbull, kanë atësi të ndryshme.

Me procesverbalin e datës 24.11.2023, subjekti ka deklaruar se Astrit Shala, si qiramarrës, disponon kontratën me qiradhënësin, të firmosur që në vitin 2019 nga bashkëjetuesja e tij, për vlerën 32, 000 lekë në muaj. Kontrata është rinovuar në formë verbale dhe për vitin 2022, qiradhënësi e ka ngritur çmimin në 38 mijë lekë në muaj. Nuk kanë firmosur kontratë tjetër me mendimin se mund të gjejnë një mundësi më pak të kushtueshme. Ka paraqitur:

- Kontratë Qiraje e thjeshtë e datës 09.09.2019. Qiramarrës R. Sh. Qiradhënës J. J. Apartament me sip. 83 m², në shumën mujore 32,000 lekë, me afat 1 vit deri në datë 08.09.2020, me të drejtë rinovimi, me adresë rr. “Trëndafili i Bardhë”, Tiranë.
- Vërtetim datë 13.04.2024, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, mbi të ardhurat e shtetasës R. Sh, për periudhën 2012 – 2023.

Në shpjegimet e datës 17.04.2024, subjekti ka sqaruar se djali i tij Astrit Shala, ka kryer një ndërhyrje kirurgjikale në Spitalin Salus ku ka bashkëlidhur dokumentacionin justifikues, konkretisht:

- Faturë tatimore shitje nga Spitali Salus, datë 11.01.2023, në vlerën 275, 310 lekë.

Konkluzion:

- *Shpenzimet e deklaruara nga djali Astrit Shala për ujë, energji elektrike, shpenzime telefonie dhe interneti, në total për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 janë rreth 146, 000 lekë.*
 - *Shpenzimet për qira apartamenti për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, janë në shumën rreth 456, 000 lekë. (Kontrata në emër të bashkëjetueses së tij).*
 - *Shpenzimet për mjekim për periudhën objekt vlerësimi janë në shumën 275, 310 lekë.*
- Shpenzime për arsimimin e Astrit Shala, në Universitetin Mesdhetar të Tiranës në administrim biznes, në shumën 1, 200 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Faturë pagese në Raiffeisen Bank datë 20.02.2023 nga Astrit Shala, në shumën 802, 50 euro, “Pagesë shkollë viti i 3 Administrim Biznes”.
- Faturë pagese në Raiffeisen Bank datë 14.06.2023 nga Astrit Shala, në shumën 402, 50 euro, “Pagesë kësti i fundit”, për Mesdheu Education sh.p.k.

Procedura e vlerësimit:

Intesa SanPaolo Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 26.09.2023, konfirmon pagesë të kryer nga llogaria në euro e Astrit Shala në datë 13.02.2023, për Universitetin Mesdhetar (kësti i parë dhe i dytë) në shumën 800 euro.

Me inventarin e datës 16.11.2023, subjekti ka dorëzuar:

- Faturë pagese në Raiffeisen Bank datë 20.02.2023 nga Astrit Shala në shumën 802, 50 euro, “Pagesë shkollë viti i 3 Administrim Biznes”.
- Faturë pagese në Raiffeisen Bank datë 14.06.2023 nga Astrit Shala, në shumën 402, 50 euro, “Pagesë kësti i fundit”, për Mesdheu Education sh.p.k.

Konkluzion:

- *Shpenzimet e deklaruara dhe të dokumentuara për arsimimin e djalit Astrit Shala, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, janë në shumën rreth 92, 000 lekë.*
- *Gjatë periudhës 20.02.2023 - 14.06.2023, rezultojnë në total rreth 139, 000 lekë. (Shpenzimet e deklaruara i përkasin periudhës pas datës së dorëzimit të deklaratës së vlerësimit).*

Shkresat e institucioneve:

Banka e Shqipërisë, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Procredit Bank, Banka e Parë e Investimeve, Banka Amerikane e Investimeve, Banka OTP Albania, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing sh.p.k, Landeslease sh.a, Raiffeisen Invest, Credins Invest, EasyPay, Fondi Besa, Institucioni Financiar NOA, Iute Credit, Kredo. AI; konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk janë klientë të tyre, ç'ka konfirmohet me deklarin.

ASHK, Zyrat/Drejtoritë Vendore: Librazhd, Kamëz Vorë, Tirana Rurale 1, Tiranë Rurale 2, Tirana Jug, Tirana Veri, Mallakastër, Devoll, Korçë, Fier, Berat, Gramsh, Kuçovë, Pukë, Malësi e Madhe, Kukës, Kavajë, Lushnjë, Pogradec, Krujë, Gjirokastrë, Kolonjë, Has, Mat, Bulqizë, Durrës, Skrapar, Peqin, Tropojë, Mirditë, Tepelenë, Përmet, Sarandë, Dibër, Lezhë, Kurbin, Shkodër, Vlorë, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

Unioni Financiar i Tiranës, me shkresën nr. ***, prot., datë 21.09.2023, konfirmon 1 transaksion në hyrje në emër të Astrit Shala, për periudhën 11.09.2018 - 17.02.2023, ku është tërhequr shuma 68 euro.

AK-Invest, me shkresën nr. ***, prot., datë 25.09.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk kanë kryer transferta monetare nëpërmjet rrjetit AK-Invest sh.a. Megjithatë ka konfirmuar se shtetasit Xh. S (jo Shala), A. S (jo Shala) dhe Astrit Shala, kanë kryer dërgesa jashtë territorit të Shqipërisë, nga Kosova, Italia dhe Britania e Madhe.

Me e-mailin e datës 16.11.2023, subjekti ka deklaruar se lidhur me konfirmimet e AK-Invest sh.a, ai dhe pjesëtarët e familjes nuk kanë kryer transferta monetare nëpërmjet këtij rrjeti, as nga Shqipëria dhe as nga Kosova, Italia dhe Britania e Madhe.

Me procesverbalin e datës 24.11.2023, subjekti ka deklaruar se në datë 16.11.2023 i është drejtuar AK Invest me katër kërkesa, për vete dhe pjesëtarët e familjes, për të gjithë transaksionet e kryera nëpërmjet tyre dhe për të gjithë periudhat.

Në përgjigjen nr. 1648, datë 17.11.2023, AK Invest vërteton se “Shtetasi Xhavit Shala, i datëlindjes 07.08.1961, mbajtës i dokumentit me numër personal identifikimi GI08***084, nuk ka kryer transferta bankare nëpërmjet rrjetit të AK Invest sha”.

Në përgjigjen nr. 1649, datë 17.11.2023, AK Invest vërteton se “Shtetasja Aida Shala, e datëlindjes 01.07.1965, mbajtëse e dokumentit me numër personal identifikimi G557***79C, nuk ka kryer transferta bankare nëpërmjet rrjetit të AK Invest sha”.

Në përgjigjen nr. 1647, datë 17.11.2023, AK Invest vërteton se “Shtetasi Astrit Shala, i datëlindjes 06.05.1988, mbajtës i dokumentit me numër personal identifikimi T805060***, nuk ka kryer transferta bankare nëpërmjet rrjetit të AK Invest sha”.

Në përgjigjen nr. 1650, datë 17.11.2023, AK Invest vërteton se “Shtetasi Eros Shala, i datëlindjes 24.04.1992, mbajtës i dokumentit me numër personal identifikimi J204***73J, nuk ka kryer transferta bankare nëpërmjet rrjetit të AK Invest sha”. Ka dorëzuar:

- Vërtetim nga AK Invest nr. 1648 prot., datë 17.11.2023, ku konfirmohet se Xhavit Shala i datëlindjes 07.08.1961, mbajtës i dokumentit me numër personal identifikimi GI08***084, nuk ka kryer transferta monetare nëpërmjet rrjetit të AK Invest sha”.
- Vërtetin nga AK Invest nr. 1649 prot., datë 17.11.2023, ku konfirmohet se Aida Shala e datëlindjes 01.07.1965, mbajtëse e dokumentit me numër personal identifikimi GSS***179C, nuk ka kryer transferta monetare nëpërmjet rrjetit të AK Invest sha”.
- Vërtetim nga AK Invest nr. 1647 prot., datë 17.11.2023, ku konfirmohet se Astrit Shala i datëlindjes 06.05.1988, mbajtës i dokumentit me numër personal identifikimi I80506***, nuk ka kryer transferta monetare nëpërmjet rrjetit të AK Invest sha”.
- Vërtetim nga AK Invest nr. 1650 prot., datë 17.11.2023, ku konfirmohet se Eros Shala i datëlindjes 24.04.1992, mbajtës i dokumentit me numër personal identifikimi J204***73J, nuk ka kryer transferta monetare nëpërmjet rrjetit të AK Invest sha”.

QKB, me shkresën nr. ***, prot., datë 15.09.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur nuk figurojnë të jenë pajisur me NUIS (NIPT) si person fizik apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrit tregtar.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. ***, prot., datë 26.09.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), me shkresën nr. *** prot., datë 19.09.2023, konfirmon se Fetah Shala ka përfutuar pension pleqërie me masë mujore 19, 434 lekë, nga muaji maj 1995.

ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. ***, prot., datë 22.09.2023, konfirmon marrëdhëniet e punës për Fetah Shala nga viti 1957 deri në vitin 1991.

Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën ***, prot., datë 20.09.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur.

Regjistri Noterial Shqiptar, Ministria e Drejtësisë, me shkresë nr. ***, prot., datë 27.09.2024, ka përcjellë informacionin për të gjitha veprimet dhe aktet noteriale të regjistruara në sistemin RNSH, për periudhën 01.03.2013 deri në datën 12.09.2023, të kryera nga noterë të ndryshëm për subjektin dhe personat e lidhur me të.

Nga verifikimi i të dhënave të vënë në dispozicion nga institucioni përkatës, konfirmohen të gjitha veprimet dhe aktet noteriale të kryera nga subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, gjatë periudhës 2013 – 2023.

Konkluzion:

- *Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues në lidhje me përgjigjen e ardhur nga AK Invest.*

Në konkluzion për vlerësimin e pasurisë, në përputhje me pikën 6, të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit, arrin në përfundimin se:

- a) **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe se punonjësi nuk gjendet në situatë konflikti interesi;**
- b) **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;**
- c) **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- d) **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- e) **punonjësi nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.**

B. KONTROLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

🚦 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në këto elementë:

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- Procedura verifikuese nga Trupa e Vlerësimit që konsiston në:
 - Verifikimin e informacioneve në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
 - Identifikimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale;
 - Analizimin dhe kryqëzimin e dokumentacionit të administruar me deklaratimet e subjektit të vlerësimit.

Deklarimi i subjektit të vlerësimit

Në deklaratën e kontrollit të figurës subjekti i vlerësimit ka deklaruar se:

- Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.

- Nuk ka qenë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar
- Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
- Nuk ka qenë asnjëherë bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish – shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. Pas diplomimit në Shkollën e Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me Urdhër të Ministrit të Brendshëm nr. 1142, datë 30.06.1984, është emëruar punëtor operativ në Sektorin e Sigurimit, në Degën e Punëve të Brendshme.

Po ashtu, subjekti ka nënshkruar edhe dy vetdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

Procedura verifikuese

Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaratimit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36 dhe 37, të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar

dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet e tjera duke kërkuar të dhëna nga institucionet përgjegjëse, të shprehura në këtë ligj si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, për subjektin e vlerësimit Z. Xhavit Shala, me shkresë nr. ***, prot datë 25.08.2023, bën me dije se nuk ka ndryshim në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresë nr. ***, prot datë 22.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Xhavit Shala, bën me dije se nuk rezulton i dënuar.

Institucioni Ligjzbatues, me shkresë nr. ***, prot., datë 31.08.2023, ka konfirmuar të dhëna referuese në ngarkim të subjektit të vlerësimit Z. Xhavit Shala.

Nga verifikimi ka rezultuar se të dhënat në ngarkim të subjektit të vlerësimit nuk kanë vijueshmëri, nuk janë sqaruar/thelluar dhe vërtetuar më tej dhe nuk rezulton të jenë ndarë me struktura të tjera ligjzbatuese.

Institucioni Ligjzbatues, me shkresë nr. ***, prot., datë 30.05.2023, dhe shkresë nr. ***, datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Xhavit Shala si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se **nuk kanë**:

- Të dhëna për cenimin e figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta.
- Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar
- Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale,
- Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autorit shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale,
- Të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj,
- Të dhëna nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s,
- Të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale,
- Të dhëna nëse subjekti ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet,
- Procedim disiplinor apo masë disiplinore

Institucioni Ligjzbatues, me shkresë nr. ***, prot., datë 25.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Xhavit Shala, bën me dije se nuk disponon të dhëna.

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, me shkresat e datës 09.08.2023, shkresën nr. ***, datë 03.10.2023, dhe shkresën nr. ***, datë 16.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Xhavit Shala dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm
- Nuk ka procedime penale të referuara
- Nuk disponohen ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.

Institucioni Ligjzbatues, me shkresë nr. ***, prot., datë 16.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Xhavit Shala, bën me dije se:

- Nuk është pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) të vlefshme.
- Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së
- Nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

Institucionet Ligjzbatuese, me shkresat nr. ***, prot., datë 28.08.2023 dhe datë 31.10.2023, bëjnë me dije se për subjektin e vlerësimit:

- Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi
- Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal,
- Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale,
- Nuk ka patur regjistrim të njoftimit të veprave penale,
- Nuk ka patur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.

Institucioni Ligjzbatues, me shkresën nr. ***, prot., datë 07.05.2024, bën me dije se për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur me të sipas certifikatës familjare, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

Avokati i Popullit, me shkresë nr. ***, prot., datë 21.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Xhavit Shala, bën me dije se:

- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

Institucioni Ligjzbatues, me shkresë nr. ***, prot., datë 24.11.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Xhavit Shala, bën me dije se:

- Nuk ka qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm,
- Nuk ka qenë bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish – Sigurimi i Shtetit, por ka qenë anëtar i ish – Sigurimit të Shtetit deri në 2 korrik 1991, sipas përcaktimeve të nenit 29, pika 2 e Ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, me detyrën e punëtorit operativ, vërtetuar me dokumentacionin e pasqyruar në pjesën përshkuese të Vendimit nr. 09, prot, datë 20.11.2023.

Lidhur sa më sipër, sipas nenit 38, pika i, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, një ndër rrethanat për vlerësimin e kontrollit të figurës, është nëse subjekti ka qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit për të drejtën e informimit me dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës se është emëruar punëtor operativ në Sektorin e Sigurimit, në Degën e Punëve të Brendshme dhe në këto kushte subjekti nuk ka kryer deklaram të rremë, sipas nenit 42, pika a, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

Trupa e Vlerësimit ka vlerësuar objektivisht figurën e subjektit të vlerësimit Z. Xhavit Shala, me anë të verifikimit të vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklaramëve si dhe identifikimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të përcaktuara në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.

Duke pasur parasysh faktin se për subjektin e vlerësimit nuk ka informacion nga institucioni përgjegjës për cënim të jetës dhe të drejtës së qytetarëve gjatë kohës që ka ushtruar detyrën si punëtor operativ, nuk rezulton me ngarkesë kriminale, si dhe pa ndonjë rrethanë tjetër rënduese, Trupa e Vlerësimit është e mendimit se fakti i mësipërm nuk përbën shkak për të qenë në kushtet e nenit 42, pika 3, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

Institucioni Ligjzbatues, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Z. Xhavit Shala, rezultuan raportime financiare, të cilat u verifikuan nga Trupa e Vlerësimit dhe u konstatua se ishin veprime bankare rutinë dhe jo të dyshimta.

Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore “Për kryerjen e ekspertimeve toksikologjike”, ka kryer ekspertimin toksikologjik të një mostre urine, mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike.

Me shkresë nr. ****, prot datë 14.05.2024, protokolluar me nr. *****, prot., datë 20.05.2024, Instituti i Mjekësisë Ligjore ka dërguar dokumentacionin përkatës, analizuar dhe vlerësuar nga Trupa e Vlerësimit, konkretisht:

- Akt Ekspertimi Toksikologjiko – Ligjor nr. ****, datë 14.05.2024, për subjektin e vlerësimit Xhavit Fetah Shala.
- Deklaratë Eksperti

Në bazë të rezultateve të përfituara nga ekspertiza toksikologjike për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se Subjekti vlerësimit Z. Xhavit Fetah Shala, aktualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.

Denoncimet nga publiku

Nga verifikimet e kryera nga Trupa e Vlerësimit, rezulton se nuk ka informacione të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e subjektit të vlerësimit apo të personave të lidhur.

Konkluzion:

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin Nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” (i ndryshuar), nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, analizimin dhe verifikimin e të dhënave të mblledhura nga institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese, si dhe raportin e sjellë nga struktura përgjegjëse e Agjencisë së

Mbikëqyrjes Policore, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, arriti në konkluzionin se:

- *Lidhur me të dhënat referuese në ngarkim të subjektit të vlerësimit, rezulton se nuk janë ndarë me institucionet e tjera ligjzbatuese dhe nuk është konfirmuar vërtetësia e tyre, nuk ka fakte apo prova që subjekti i vlerësimit është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë që ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*
- *Sa i përket faktit të mos pajisjes me Certifikatë të Sigurisë së Personelit, funksioni që ushtron subjekti i vlerësimit aktualisht, nuk përfshihet në listën e funksioneve organike që mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar.*
- *Lidhur me sa bën me dije Institucioni Ligjzbatues për subjektin e vlerësimit Z. Xhavit Shala, Trupa e Vlerësimit është e mendimit se nuk përbën shkak për të qenë në kushtet e nenit 42, pika 3, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*
- *Informacionet e ardhura nga institucionet përgjegjëse, përputhen me deklarin e subjektit.*
- *Nuk ka informacione të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e subjektit të vlerësimit apo të personave të lidhur,*
- *Nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.*

Në konkluzion për vlerësimin e figurës, në përputhje me pikën 3, të nenit 42, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit, arrin në përfundimin se:

- a) punonjësi nuk ka kryer deklarin të rremë;
- b) nuk ka informacione, të dhëna të vërtetuara nga agjencitë ligjzbatuese që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar;
- c) nuk ka informacion në deklarin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj, që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në këto elemente:

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- Raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Procedura verifikuese nga Trupa e vlerësimit, e cila konsiston në analizimin dhe kryqëzimin e informacioneve të vëna në dispozicion nga institucionet përgjegjëse, me deklarin e subjektit të vlerësimit.

Të dhëna për Arsimimin

Subjekti i Vlerësimit ka filluar studimet pranë Shkollës së Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në vitin 1981 dhe i ka përfunduar në vitin 1984. Në përfundim institucioni arsimor përkatës e ka titulluar “Specialist i lartë policie”, duke u pajisur me diplomën nr. A, datë 30.06.1984.

Në vitin 1990 deri në vitin 1994, ka studiuar degën “Gjuhë Letërsi” në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Fakulteti Histori – Filologji, duke u diplomuar në profilin “mësues”, me Vendim, datë 04.02.1994 të komisionit shtetëror, pajisur me diplomën përkatëse nr. EA-7-491, datë 25.04.1994.

Në vitin 1995 deri në vitin 2005, ka studiuar degën “Drejtësi”, niveli “Bachelor”, në Universitetin e Tiranës, duke u diplomuar me titullin “jurist”, me Vendim të Komisionit datë 28.01.2005, pajisur me diplomën përkatëse nr. 9542, datë 20.02.2005.

Në vitin 2011 ka përfunduar studimet postmaster në UFO University, në profilin “Studime mbi sigurinë”.

Po në këtë vit ka përfunduar studimet postmaster në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Drejtësisë në profilin “Eu Business Laë”.

Në vitin 2013 ka përfunduar studimet doktoraturë në Akademinë e Mbrojtjes, me Vendimin e jurisë nr. 138, datë 28.10.2013, ngritur nga Këshilli i Profesorëve të Akademisë së Forcave të Armatosura, ku ka marrë gradën shkencore “Doktor në Fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes”.

Në vitin 2020, ka përfunduar studimet doktoraturë në fushën e Historisë në Akademinë e Studimeve Albanologjike dhe ka marrë gradë të dytë shkencore “Doktor në fushën e Historisë”, me Vendimin e jurisë nr. 324, datë 28.10.2020, ngritur nga Këshilli i Profesorëve të Akademisë së Studimeve Albanologjike.

Në vitin 2022, ka fituar titullin akademik “Profesor i Asocuar”.

Sipas legjislacionit për Policinë e Shtetit ndër vite dhe Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 750, datë 16.09.2015, “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, Trupa e Vlerësimit arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, që në kohën e emërimit në detyrë për herë të parë në Policinë e Shtetit dhe deri në vijueshmërinë e ecurisë në karrierë të tij, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor dhe kualifikimit përkatës për funksionin që ka ushtruar dhe ushtron aktualisht.

Të dhëna për Punësimin dhe ecuria në karrierë

Në pikat 2 dhe 3, të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, përcaktohet se “Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet.

Neni 45, pika 2, shkronja (dh), e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë edhe ecuria në karrierë dhe procesi i fitimit të gradës, sipas legjislacionit në fuqi.

Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka në dispozicion dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit në të cilën përfshihen akte të ndryshme që i përkasin arsimimit, punësimit, ngritjes në detyrë, gradimeve, kualifikimeve, vlerësimeve etj., të cilat janë marrë në analizë nga Trupa e Vlerësimit me qëllim vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit, konkretisht:

- *Kopje e Urdhrit të emërimit nr. 1634, datë 12.06.2015, për Drejtues Xhavit Fetah Shala, me detyrë Shef Sektori, në Sektorin e Studimeve Prognostike, në Drejtorinë e Studimeve Strategjike, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, për nevoja punë, të transferohet dhe të emërohet në detyrë Drejtor, në Qendrën e Kërkimeve Shkencore, në Akademinë e Sigurisë.*
- *Kopje e Urdhrit të emërimit nr. 4633, datë 22.09.2016, për Drejtues Xhavit Fetah Shala, me detyrë Drejtor, në Qendrën e Kërkimeve Shkencore, në Akademinë e Sigurisë, për ndryshim të strukturës organike, të emërohet në detyrë Drejtor, në Qendrën Kërkimore Shkencore, në Akademinë e Sigurisë.*
- *Kopje e Urdhrit të emërimit nr. 1077/1, datë 12.12.2022, për Drejtuesin e Parë Xhavit Fetah Shala, me detyrë Drejtor, në Qendrën Kërkimore Shkencore, në Akademinë e Sigurisë, për ndryshim të strukturës organike, të emërohet në detyrë Drejtor, në Qendrën e Kërkimore Shkencore dhe Projekteve, në Akademinë e Sigurisë.*
- *Kopje e Urdhrit nr. 1077, datë 05.05.2022 “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, për Drejtues Xhavit Fetah Shala me detyrë Drejtor, në Qendrën Kërkimore Shkencore, në Akademinë e Sigurisë, i shpallur fitues dhe përfunduar trajnimin për fitimin e gradës “Drejtues i Parë”, i jepet grada policore “Drejtues i Parë”.*

Në formularin e aftësive profesionale plotësuar nga subjekti i vlerësimit si dhe nga dosja personale e subjektit, rezulton se 5 vitet e fundit subjekti i vlerësimit ka punuar në funksionet si më poshtë:

Nga data 15.06.2015 deri aktualisht, subjekti i vlerësimit Z. Xhavit Shala ushtron funksionin si Drejtor, në Qendrën Kërkimore Shkencore dhe Projekteve, në Akademinë e Sigurisë, sipas urdhrave respektiv të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, administruar nga Trupa e Vlerësimit.

Sa i përket dhënies së gradës policore nga “Drejtues” në “Drejtues i Parë” me Urdhër nr. 1077, datë 05.05.2022, Trupa e Vlerësimit mori në analizë kuadrin ligjor përkatës në kohën e veprimtimit të tij dhe dokumentacionin e administruar nga dosja personale, e konkretisht:

- *Shkresë nr. 920, datë 04.05.2022 “Dërgojmë procesverbalin e provim certifikimit për fitimin e gradës “Drejtues i Parë” në Akademinë e Sigurisë.*
- *Urdhri nr. 1077, datë 05.05.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ku përmendet se Drejtues Xhavit Fetah Shala, i jepet grada policore “Drejtues i Parë”.*
- *Urdhri nr. 149/5, datë 21.04.2022 “Për miratimin e listës emërore të së drejtës për dhënie grade të aplikantëve fitues për fitimin e gradës policore “Drejtues i Parë”. Sa më sipër rezulton:*

Pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri të Policisë së Shtetit nr. 108/2014, është miratuar VKM nr. 892, datë 21.12.2016 dhe VKM nr. 531, datë 29.07.2022, e cila përcaktonte funksionet korresponduese për çdo gradë si dhe ekuivalentimin e tyre. Po ashtu është miratuar edhe VKM

nr. 750, datë 16.09.2015 që miratonte Rregulloren e Personelit të Policisë së Shtetit. Sipas kësaj rregulloreje e cila zbatonte Ligjin e ri të Policisë së Shtetit si dhe ndër të tjera rregullat e marrëdhënies së punës që nga rekrutimi i punonjësve të policisë së shtetit, trajnimin në shkollën bazë të policisë së shtetit, ecurinë në karrierë, në gradë etj, Trupa e Vlerësimit gjen të bazuar sipas dispozitës ligjore që përcakton kjo rregullore specifikisht se :

“Neni 161/1”, pika 1, “Kriteret për aplikim për gradimin e radhës” i Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015 përcakton se:

Punonjësi i policisë ka të drejtë të aplikojë për fitimin e gradës policore të radhës, kur plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës (të performancës) jo më ulët se 70% të pikëve

të vlerësimit të përgjithshëm, gjatë kohës së qëndrimit në gradë;

b) të jetë parashkruar masa disiplinore për shkelje të rëndë, sipas afatit të përcaktuar në Ligjin “Për Policinë e Shtetit”;

c) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi penal;

ç) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi disiplinor për shkelje të rëndë;

d) të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në gradë sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.

Neni 161/2, pika 1 “Afatet e qëndrimit në gradë” përcakton se: “...Punonjësi i Policisë, për të aplikuar për gradën e radhës, duhet të plotësojë afatet e mëposhtme:

a) nga “Inspektor” deri në “Inspektor i dytë”: 5 vjet;

b) nga “Inspektor i dytë” në “Inspektor i parë”: 10 vjet;

c) nga “Nënkomisar” në “Komisar”: 3 vjet;

ç) nga “Komisar” në “Kryekomisar”: 3 vjet;

d) nga “Kryekomisar” në “Drejtues”: 5 vjet;

dh) nga “Drejtues” në “Drejtues i parë”: 3 vjet.

Në VKM nr. 892, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit” përcaktohen funksionet që i korrespondojnë gradat përkatëse.

Bazuar në këto përcaktime, Trupa e Vlerësimit konstaton se subjekti ka plotësuar kriteret e përcaktuara në nenin 161/1 të VKM nr. 750, datë 16.09.2015, me qëllim aplikimin për gradën na Drejtues në Drejtues i Parë (06.11.2009 – 2022). Subjekti i Vlerësimit Xhavit Shala ka aplikuar për gradën e radhës duke plotësuar afatet e qëndrimit në gradë konkretisht 13 vite, në përputhje me nenin 161/2, pika 1, e VKM nr. 750, datë 16.09.2015.

Grada “Drejtues”, nuk korrespondon me funksionin që subjekti ka ushtruar në Akademinë e Sigurisë, si Drejtor, në Qendrën Kërkimore Shkencore, për periudhën 2017 – 2022, pasi sipas përcaktimeve të VKM nr. 892, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit”, ky funksion duhet ti korrespondojë gradës “Drejtues i Parë”.

Grada “Drejtues i Parë”, korrespondon me funksionin që subjekti ushtron aktualisht si Drejtor në Qendrën e Kërkimeve Shkencore dhe Projekteve, në Akademinë e Sigurisë, sipas

përcaktimeve të VKM nr. 531, datë 29.07.2022, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit të policisë së shtetit dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese e kategorizimin për gradat në Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Konkluzion:

- *Lidhur me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit Z. Xhavit Xhala, arrijmë në konkluzion se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfutuar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.*
- *Grada “Drejtues”, nuk korrespondon me funksionin që subjekti ka ushtruar në Akademinë e Sigurisë, si Drejtor, në Qendrën Kërkimore Shkencore.*
- *Grada “Drejtues i Parë”, korrespondon me funksionin që subjekti ushtron aktualisht si Drejtor në Qendrën e Kërkimeve Shkencore dhe Projekteve, në Akademinë e Sigurisë.*

Vlerësimet e punës

Në aktet e depozituara pranë strukturës përgjegjëse të burimeve njerëzore të DPPSH-së, rezulton se gjatë 5 viteve të fundit 2018 - 2013, janë të administruara 5 vlerësime të aftësive individuale të subjektit të vlerësimit Xhavit Shala, konkretisht:

- Për vitin 2018, është vlerësuar me 28 pikë
- Për vitin 2019, është vlerësuar me 28 pikë
- Për vitin 2020, është vlerësuar me 28 pikë
- Për vitin 2021, është vlerësuar me 28 pikë
- Për vitin 2022, është vlerësuar me 92 pikë

Konkluzion:

- *Nga analizimi i vlerësimeve të mësipërme konstatohet se për periudhën 2018 – 2022, subjekti i vlerësimit është vlerësuar nga eprori i drejtpërdrejtë me pikët maksimale.*

Përmbushja e detyrave të krvera dhe respektimi i rregullave të etikës

Sipas Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, neni 43, objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është dhe përmbushja e detyrave nga punonjësi.

Gjithashtu në nenin 45, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, përcaktohet se aftësitë profesionale të punonjësit vlerësohen duke u bazuar dhe në përshkrimet e punës për çdo funksion.

Nga verifikimi i dosjes së personelit si dhe në sistemin RMIS rezulton se gjatë periudhës 2018 – 2023 subjekti i vlerësimit nuk është ndëshkuar disiplinarisht me masë disiplinore.

Konkluzion:

Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara në dosjen personale të subjektit, konkludojmë se subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, respektuar rregullat e etikës si dhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.

Kualifikimet dhe trajnimet:

Bazuar në nenin 44, pika 2 të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, përcaktohet se periudha e vlerësimit të aftësive profesionale përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet.

Në nenin 45 pika 2, përcaktohet objekti i vlerësimit të aftësive profesionale, ku një ndër to shërbejnë dhe certifikatat e trajnimeve.

Nga verifikimi i dosjes së personelit të subjektit të vlerësimit kalimtar Z. Xhavit Shala, si dhe formularit të aftësive profesionale të plotësuar nga subjekti, rezulton se për periudhën objekt vlerësimi, nuk është pajisur me certifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit (2018-2023), por rezulton se gjatë gjithë karrierës së tij si punonjës policie ka kryer mjaftueshëm trajnime me qëllim kualifikimin për funksionin që mban, gjithashtu i janë dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit certifikata për shërbime të dalluara dhe certifikata të karrierës.

Subjekti i vlerësimit ka marrë pjesë në workshop dhe konferenca jashtë vendit, dhe dokumentacioni justifikues është administruar nga Trupa e Vlerësimit.

Konkluzion përfundimtar:

Në përfundim të verifikimeve të kryera nga Trupa e Vlerësimit lidhur me vlerësimin profesional arrihet në konkluzionin se:

- *Subjekti i vlerësimit, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor dhe kualifikimit përkatës për funksionin që ka ushtruar dhe ushtron aktualisht.*
- *Funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.*
- *Grada “Drejtues”, nuk korrespondon me funksionin që subjekti ka ushtruar në Akademinë e Sigurisë, si Drejtor, në Qendrën Kërkimore Shkencore.*
- *Grada “Drejtues i Parë”, korrespondon me funksionin që subjekti ushtron aktualisht si Drejtor në Qendrën e Kërkimeve Shkencore dhe Projekteve, në Akademinë e Sigurisë.*
- *Për periudhën 2018 – 2022, subjekti i vlerësimit është vlerësuar pozitivisht nga eprori i drejtpërdrejtë.*
- *Subjekti i vlerësimit ka përmbushur detyrat profesionale, respektuar rregullat e etikës si dhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.*

Në konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me pikën 1, të nenit 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit, arrin në përfundimin se:

- a) është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;
- b) ka vlerësime pozitive pune;
- c) ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR:

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha provat dhe shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, në përfundim të procesit të vlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, Xhavit Fetah Shala, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku tre kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollin e figurës;
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale;

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në mbështetje të shkronjës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës “1” dhe “2” të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit Z. Xhavit Fetah Shala, me funksion Drejtor, në Qendrën e Kërkimeve Shkencore dhe Projekteve, në Akademinë e Sigurisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot më datë 17.10.2024, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

KRYESUESE

Bora VRENJO

RELATOR

Henri NAQELLARI

ANËTARE

Loreta HANXHARI

Aneksi 1: Analiza financiare Xhavit Shala dhe personat e lidhur sipas certificates familjare

Burimi/Viti	Pasqyra e Analizes Financiare																	
	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	17.02.2023	
Të ardhura neto nga paga apo shperblime nga marrëdhëniet e punësimit		896,128	1,483,993	1,583,164	1,439,203	1,476,487	1,635,257	1,723,333	2,099,198	2,553,479	3,577,037	4,020,296	3,843,920	3,759,481	3,765,300	3,710,590	487,897	
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme													183,000					
Të ardhura të papërmendura më sipër		110,000		100,000				120,000				308,800	120,000	120,000	120,000	120,000	20,000	
Totali i të Ardhurave neto		1,006,128	1,483,993	1,683,164	1,439,203	1,476,487	1,635,257	1,843,333	2,099,198	2,553,479	3,577,037	4,329,096	4,146,920	3,879,481	3,885,300	3,830,590	507,897	
Detyrime: Te hyra nga huate/kredi/dhurim																		
Shpenzime jetike sipas INSTAT		409,860	639,756	639,756	639,756	418,644	418,644	860,844	822,552	916,740	898,380	953,388	995,868	1,018,968	981,888	1,037,760	172,960	
Shpenzime per Qera																		
Shpenzime për Mjekim																		
Shpenzime për Arsimimin		230,000	265,000	265,000	564,000	203,600	139,800	250,800	70,800									
Shpenzime Udhëtimi jashte vendit												158,000			300,000	250,000		
Detyrime Kredie Bankare Leasing, etj		56,760	56,760	56,760	56,760	56,760	56,760	67,760	67,217	93,342	56,760	72,419	149,185	311,987	208,065	129,499	8,412	
Shpenzime dhe te dala te tjera.					100,000				600,000		242,450	1,166,702	359,904	151,589	87,498	186,620		
Totali i shpenzimeve dhe te dalave		696,620	961,516	961,516	1,360,516	679,004	615,204	1,179,404	1,560,569	1,010,082	1,197,590	2,350,509	1,504,957	1,482,544	1,577,451	1,603,879	181,372	
Investime,pasuri					348000								608,500	4,308,300	1,611,200			
Likuiditete													1,500,000	1,200,000			2,252,673	
Gjendje Cash																	200,000	
Totali Pasuri		-	-	-	348,000	-	-	-	-	-	-	-	2,108,500	5,508,300	1,611,200	-	2,452,673	
Mundësia per Kursime		112,903	422,411	944,888	1,666,536	1,397,223	2,194,706	3,214,759	3,878,688	4,417,317	5,960,714	8,340,161	10,318,748	10,852,211	7,740,848	8,437,497	10,664,208	8,538,060

Analiza financiare e djalit të subjektit të vlerësimit Astrit Xhavit Shala

Burimi/Viti	Pasqyra e Analizes Financiare															
	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	17.02.2023
Të ardhura neto nga paga apo shperblime nga marrëdhëniet e punësimit	331,141	414,433	364,264	397,214	408,900	516,800	630,991	1,033,825	961,912	1,558,545	1,414,001	2,821,702	2,613,326	2,972,474	3,252,905	1,204,579
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme																
Të ardhura të papërmendura më sipër																
Totali i të Ardhurave neto	331,141	414,433	364,264	397,214	408,900	516,800	630,991	1,033,825	961,912	1,558,545	1,414,001	2,821,702	2,613,326	2,972,474	3,252,905	1,204,579
Detyrime: Te hyra nga huate/kredi/dhurim																
Shpenzime jetike sipas INSTAT	136,620	213,252	213,252	213,252	139,548	139,548	434,304	442,512	443,220	469,116	570,348	759,312	768,564	763,524	792,000	132,000
Shpenzime për Qira												96,000	384,000	384,000	384,000	64,000
Shpenzime për Mjekim																275,310
Shpenzime për Arsimimin																
Shpenzime Udhëtimi jashte vendit																
Detyrime Kredie Bankare Leasing, etj											191,414	328,000	342,400	142,500		
Shpenzime dhe te dala te tjera.									432,000				119,900			368,876
Totali i shpenzimeve dhe te dalave	136,620	213,252	213,252	213,252	139,548	139,548	434,304	442,512	875,220	469,116	761,762	1,183,312	1,614,864	1,290,024	1,176,000	840,186
Investime,pasuri																
Likuiditete	42,741	23,774	6,940	26,324			40,997	30,656	20,282	28,289	105,059	95,757	28,772	10,140		1,310,807
Gjendje Cash																
Totali Pasuri	42,741	23,774	6,940	26,324	-	-	40,997	30,656	20,282	28,289	105,059	95,757	28,772	10,140	-	1,310,807
Mundësia per Kursime	151,780	329,187	473,259	630,897	900,249	1,277,501	1,433,191	1,993,848	2,060,258	3,121,398	3,668,578	5,211,211	6,180,901	7,853,211	9,930,116	8,983,702